



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI
“AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË”

BASHKIA SHIJAK

Tiranë 2023

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	5
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	8
II. HYRJA	8
1. Objektivat e auditimit.....	11
2. Qëllimi i auditimit	11
3. Identifikimi i çështjes.....	11
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	12
6. Kriteret e vlerësimit	12
7. Standardet e auditimit	13
8. Metodologjia e auditimit	13
9. Dokumentimi i auditimit	15
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	15
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	15
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	16
2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm	16
2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....	36
2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare të vitit 2022.	51
2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.	71
2.4.1 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.	87
2.5 Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.	94
2.6 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	109
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME	140
V. ANEKSET	168

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me objektivat vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Shijak, për aktivitetin ekonomik dhe financiar, prokurimet publike, investimet publike, planifikimi dhe zhvillimi i territorit, etj. Auditimi mbuloi periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022 për përputhshmërinë dhe 01.01.2022 deri më 31.12.2022 për anën financiare. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi kryesore nga Bashkia Shijak si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore, realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, auditim me zgjedhje të transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore, mbajtjen e evidencës kontabël, zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e procedurave të prokurimit publik, planifikimi dhe zhvillimi i territorit etj.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi rezultoi se:

- Në Bashkinë Shijak mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. U konstatuan mangësi në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm.

- Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e vetë Bashkisë Shijak së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe buxhetit të shtetit, për vitin 2022 kanë diferencë të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2022 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 2,202,808 mijë lekë, ndërsa realizimi vlerën 1,325,130 mijë lekë, ose në masën 60.1%.

- Nga auditimi i taksave të ndërtesës, pastrimit, ndriçimit dhe truallit për debitorët familjar rezultoi vlera totale debitore 210,973,696 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Shijak. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar.

- Mangësi në evidentimin dhe vlerësimin e nivelit të detyrimeve debitore, kontabilizimet dhe procedurat e ndjekjes së borxhit tatimor për subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Shijak.

- U konstatuan parregullsi në procedurat e kryera për menaxhimin e të ardhurave nga taksa e lëshimit të Autorizimeve/Liçencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, Bashkia Shijak.

- Parregullsi dhe mangësi në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2022.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit, u konstatua moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në hartimin e kriterëve dhe vonesa për vlerësimin e ofertave.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve, u konstatuan diferencë në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksion i tubacionit të dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V = 2000 m³ Shijak, rrjet shpërndarës fshati Maminas – Kareç- Bilalas – Karpen - Bodinak”, Bashkia Shijak dhe në objektin “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për qytetin Shijak”, Bashkia Shijak.

- Nga auditimi i planifikimit të territorit, u konstatuan mosrespektim i kondicioneve urbane, në pesë raste nuk janë respektuar kriteret e hartimit të plani të rievimit, projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqëruar.

- Nga auditimi i veprimtarisë së IMTV Bashkia Shijak, u konstatua Niveli i ulët i arkëtimit të gjobave të vendosura nga IMTV për shkeljet e konstatuara.

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Shijak, KLSH ka dhënë “Opinion të modifikuar me rezervë” për pasqyrat financiare dhe “Opinion të modifikuar” për përputhshmërinë.

Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi mbuloi çështjet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë Shijak si: menaxhimi financiar dhe kontrolli, auditi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, të ardhurat, vlerësimi i pasqyrave financiare, planifikimi dhe zhvillimi i procedurave të prokurimit publik, planifikimi dhe zhvillimi i territorit si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm. Për analizimin dhe vlerësimin e aktivitetit të subjektit sipas pikave të planifikuara në programin e auditimit, grupi i auditimit vlerësoi sistemet e kontrollit të brendshëm dhe analizoi të gjitha evidencat e grumbulluara gjatë kryerjes së auditimit në terren sipas çështjeve përkatëse.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit ka mbajtur dhe protokolluar në Bashkinë Shijak 10 akt konstatime dhe 1 akt verifikime. Mbi akt konstatimet dhe akt verifikimet e mbajtura nga grupi i auditimit janë paraqitur observacione nga Bashkia Shijak të cilat janë trajtuar në përputhjeve me përcaktimet e Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH-së.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

<i>NR.</i>	<i>PËRMBLEDHJE E GJETJEVE</i>	<i>RËNDËSI A</i>	<i>REKOMANDIMI</i>
<i>1</i>	<p>Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ngritja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm ka mangësi. - Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin, aktivitetet, planveprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës. - Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Rezulton se, nga 3(tre) njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë. -Nuk është evidentuar puna e anëtarëve GMS, duke u dokumentuar takimet dhe mbledhjet të për hartimin e planit 	E mesme	<p>Nga Kryetari i Bashkisë Shijak, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij; - Për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve; - Hartimin e regjistrit të riskut, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit; - Të aplikojë programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar; - Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin; - Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”;

	<p>strategjik dhe PBA.</p> <p>-Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.</p>		- Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”;
2	<p>Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, në Bashkinë Shijak është organizuar dhe ka funksionuar Njësia e Auditimit të Brendshëm e përbërë nga dy specialistë si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit.</p> <p>- NJAB nuk ka kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, të tilla si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, lejet e ndërimit, etj..</p> <p>-Për rekomandimet e lëna nuk është bërë analiza e tyre, pasi nuk është hartuar program i veçantë për shkallën e zbatimit të tyre, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuara në raportet e auditimit.</p>	E mesme	Nga Bashkia Shijak, të merren masa për mbylljen e çertifikimit dhe trajnimin e audituesve të rinj, për rritjen e aftësisë profesionale të tyre. Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve, përcaktimit të përgjegjësive si dhe formulimit konkret të rekomandimeve.
3	Nga auditimi i llogarisë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Shijak për arkëtim ndaj të tretëve, nuk është pasqyruar saktë, sepse kjo llogari është pasqyruar më pak për vlerën 318,780,035 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta.	E mesme	Drejtoria e Financës Bashkia Shijak, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.
4	Nga auditimi, u konstatua se në datën 31.12.2022, shuma e llogarive 42 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, të 436 “Sigurime shoqërore”, të cilat janë në vlerë 17,490,591 lekë këto llogari nuk kuadrojnë me kundërpartinë llogarinë 4342 “Operacione me shtetin” e cila është rregjistruar në bilanc në vlerën 16,062,853 lekë.	E mesme	Drejtoria e Financës në Bashkinë Shijak, të marrë masat e nevojshme për kontabilizim e plotë dhe të saktë të llogarive 42 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, të 436 “Sigurime shoqërore” me kundërparti llogarinë nr 4342 “Operacione me shtetin”.
5	Nga auditimi i 7 procedurave të prokurimit publik të zhvilluara përgjatë	E lartë	Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e

	periudhës 01.01.2022 – 31.12.2022, në 2 raste për kontrata me vlerë 196,900 mijë lekë, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. Kualifikimi në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta.		kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mos realizimin me sukses të kontratës.
6	Në auditimin e procedurës me objekt “Riforcimi i njësisë të banimit në ndërtesa (pallat), të pabanueshme, të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019”, procedurë e llojit e kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit e cila është kryer me 2 faza, KVO në fazën e dytë rezulton se nuk ka shpallur OE fitues, pavarësisht se kanë kaluar 4 muaj nga paraqitja e ofertave, duke shkaktuar një vonesë të paargumentuar në aktivitetin që kryen ky komision.	E lartë	Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe Komisioni për Vlerësimin e Ofertave, të marrin masa për shmangien dhe mos përsëritjen e vonesave të paargumentuara në fazën e vlerësimit të ofertave, duke tejkaluar afatet ligjore dhe qëllimin mbi të cilin kryhen këto procedura.
7	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në dy raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, sic janë distancat nga trupi i rrugës së propozuar dhe intensitetin maksimal të lejuar, tipologjia e objektit në zhvillim nuk është në përputhje me zërin kadastral	E lartë	Nga DPTSHIP dhe Bashkia Shijak të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, edhe në rastet kur këto kushte ndikohen nga projektet e institucioneve të tjera, të marrë masa të mos miratojë asnjë leje ndërtimi, ku zëri kadastral nuk i pershtatet tipologjisë së zhvillimit.
8	Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV, konstatohet se niveli i arkëtimeve është i ulët, IMTV dhe Bashkia Shijak nuk kanë marrë të gjitha masat për arkëtimin e këtyre gjobave.	E lartë	Nga Bashkia Shijak dhe IMTV të merren masa për kryerjen e të gjitha procedurave që ligji parashikon, për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha masave administrative të vendosura nga IMTV.
9	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksion i tubacionit të dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V = 2000 m3 Shijak, rrjet shpërndarës fshati Maminas – Kareç-Bilalas – Karpen - Bodinak”, Bashkia Shijak dhe në objektin “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për qytetin Shijak”, Bashkia Shijak, në vlerë totale 883,220 lekë.	E ulët	Nga Bashkia Shijak të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 883,220 lekë pa tvsh nga B. “K.K.” Shpk & “K.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me objekt “Rikonstruksion i tubacionit të dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V = 2000 m3 Shijak, rrjet shpërndarës fshati Maminas – Kareç-Bilalas – Karpen - Bodinak” dhe në kontratën me objekt “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për qytetin Shijak”, Bashkia

			Shijak, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
--	--	--	--

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni i auditimit financiar.

Grupi i auditimit të KLSH, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Shijak për periudhën ushtrimore 01.01.2022–31.12.2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese.

Opinion i modifikuar me rezervë:

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, arrijmë në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore e Bashkisë Shijak, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e modifikuar me rezervë”.

Baza për opinion e modifikuar me rezervë:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen “Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 - Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 - Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 - Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare - Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit për shpenzimet e vitit 12,869 mijë lekë, si dhe anomalitë e konstatuar si vijon:

- Nga auditimi, u konstatua se Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” në Bashkinë Shijak në datën 31.12.2022 përbëhet nga 16 studime e projekte në vlerën 61,651,348 lekë, të cilat i përkasin investimeve nga të ardhurat e veta të Bashkisë Shijak.

Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike, u konstatua se disponohen gjithsej 139 projekte dhe studime, të cilat janë të pakontabilizuara. Këto projekte dhe studime janë hartuar në vite edhe përpara periudhës së kryerjes të reformës administrativo-teritoriale Për llogarinë 202 “*Studime dhe kërkime*” nuk është përllogaritur amortizimi.

-Nga auditimi i llogarisë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Shijak për arkëtim ndaj të tretëve, nuk është pasqyruar saktë, sepse kjo llogari është pasqyruar më pak për vlerën 318,780,035 lekë, duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta.

- Nga auditimi, u konstatua se Aktivet Afatgjata Financiare, në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën 3,500,000 lekë kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 242,600 lekë në pasqyrat financiare.

- Nga auditimi i llogarisë nr.215“Mjete transporti”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më shumë për vlerën 8,793,226 lekë, si rrjedhojë e kontabilizimit në këtë llogari të disa makinerive, si 1 eskavator, 2 traktor dhe 1 kamion pastrimi, të cilat janë makineri dhe jo mjete transporti, si dhe duhet të klasifikohen në llogarinë nr.214. Për këto makineri duhet të aplikohet normë amortizimi 5% dhe jo 20% si është aplikuar.

-Nga auditimi u konstatua se gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, në datën 31.12.2022 paraqitet në vlerën 18,948,027 lekë. Nga auditimi i investimeve të vitit 2022 për Bashkinë Shijak janë 9 investime në proces të cilat nuk paraqiten në llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, por këto investime janë kontabilizuar në llogaritë e klasës 2 të aktivitetit.

II. Opinion i auditimit për përputhshmërinë.

Nga auditimi mbi veprimtarinë e subjektit “Bashkia Shijak” (periudha 01.01.2022 – 31.12.2022), audituesit vlerësuan shkallën e zbatimit nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*).

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit u konstatua se, në veprimtarinë e Bashkisë Shijak janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinion”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të **modifikuar/kualifikuar**.

Baza për opinionin:

- Në procedurat e prokurimit,në tre raste janë konstatuar anomali në hartimin e kriterëve të veçanta të DT publik, pasi janë vendosur kriteret të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën dhe madhësinë e kontratës.

- Në procedurat e prokurimit, në 2 raste, për kontrata me vlerë 196,900 mijë lekë, janë konstatuar anomali në kualifikimin e operatorëve ekonomik në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve për kualifikim.

- Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, pasi në datën 31.12.2022 rezultojnë detyrime të pa arkëtuara nga taksapaguesit e kategorisë familjarë dhe privat në vlerën 210,973,696 lekë.

-Parregullsi në procedurat e kryera për menaxhimin e të ardhurave nga taksa e lëshimit të Autorizimeve/Liçencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, Bashkia Shijak.

- Në dy raste janë konstatuar diferenca në volume të pakryera, por të likuiduara në fakt në vlerën 883,220 lekë, në objektin “Rikonstruksion i tubacionit të dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V = 2000 m3 Shijak, rrjet shpërndarës fshati Maminas – Kareç- Bilalas – Karpen - Bodinak” dhe në objektin “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për qytetin Shijak”, Bashkia Shijak.

- Mosrespektimi i kondicioneve urbane, nuk janë respektuar kriteret e hartimit të plani të rilevimit, projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues

- Është konstatuar niveli i ulët i arkëtimin të gjobave të vendosura nga IMTV për shkeljet e konstatuara, në masën 22%.

- Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të likuiduara plotësisht, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës, pavarësisht se nuk janë marrë të gjitha në dorëzim nga Bashkia Shijak, nuk është bërë zhbllkimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuar në degën e Thesarit. Nga Drejtoria e

Financës, nuk janë marrë masa për zhblokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së garancisë sipas objekteve ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Shijak.

Strukturat drejtuese të subjektit Bashkia Shijak, Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator të fushës.

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 430/1 Prot, datë 19.05.2023, nga data 19.05.2023 deri në datën 27.06.2023, në subjektin Bashkia Shijak u krye “Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022”. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

A.Z – Përgjegjës Grupi

E.V – Anëtare

Sh.H – Anëtare

P.Xh – Anëtar

K.H - Anëtar

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Shijak kishte si objektiva kryesore:

Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)¹;

Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;

Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Shijak është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/ shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Shijak dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.

2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.

3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2022.

¹Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2021-31.12.2022.
5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
6. Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV-së.
7. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Shijak, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Shijak është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Shijak. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- “VKM nr. 187, datë 8.3.2017 për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit

Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar.

VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”;

VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;

VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;

Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;

Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e PBA vendor 2022-2024”;

Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;

Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;

UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;

Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ”Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Shijak grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik“;

ISSAI 200 “Parimet themelore të auditimit financiar”.

ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar";

ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Shijak me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale².

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH^{-ja} aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së

² ISSAI 1315

³ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

procese/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe së fundi kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Auditimi në subjektin “Bashkia Shijak”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave.

Bashkia Shijak është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

Zona Gjeografike: Shijaku kufizohet në veri, perëndim dhe jug nga bashkia Durrës dhe në lindje nga bashkitë Vorë dhe Tiranë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Shijakut.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 numëron një popullsi prej 27,861 banorësh, ndërkohë që sipas Regjistrit Civil kjo bashki numëron 44,103 banorë. Me sipërfaqe prej 92.19 km², ajo ka densitet prej 302 banorë/km² sipas censurit dhe 478 banorë/km² sipas regjistrit civil.

Të dhëna të tjera: Bashkia e re Shijak shtrihet në një zonë fushore dhe kodrinore përgjatë lumit Erzen.

Shijaku është një qytet i pasur me burime ujore, ekonomia në vend është e orientuar kryesisht te tregtia, industria fashon dhe ajo përpunuese e prodhuese. Firmat private numërohen 263 subjekte nga të cilat 17 klasifikohen si biznes i madh dhe 246 si biznes i vogël. Këto biznese operojnë kryesisht në fushën e shërbimeve, tregtisë dhe më pak në fushën e prodhimit dhe ndërtimit.



Shijaku është një zonë që ka patur rritje të popullsisë gjatë dekadave të fundit si pasojë e migrimit nga zonat veri-lindore të Shqipërisë. Duke parë ndryshimin e madh midis popullsisë rezidente dhe asaj prezente në regjistrat civilë vihet re se, zona është e prekur ndjeshëm nga emigracioni. Remitancat e emigrantëve kanë luajtur një rol të madh në zhvillimin e zonës, kryesisht në Shijak dhe Xhafzotaj.

Rritja e popullsisë si dhe emigrimi kanë sjellë shumë ndërtime të reja përgjatë 25 viteve të fundit të cilat janë ndërtuar pa një plan të mirëfilltë zhvillimor. Bujqësia është orientuar drejt produkteve me vlerë të lartë të shtuar si kultivimi i perimeve dhe foragjereve, mbarështimi i bagëtive dhe pemëtarisë.⁴

Forma dhe mënyra e organizimit:

Struktura organizative për vitin 2021, është miratuar me VKB nr. 123, datë 24.12.2020, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Shijak” dhe Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 321, me nr. 5971 prot., datë 12.10.2021 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Shijak”, në numrin total 223 punonjës.

Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat

Emri i Njësisë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Shijak	Qyteti Shijak
Maminas	Fshatrat; Maminas, Karreç, Vlashaj, Karpen, Bodinak, Metallë, Bilalas, Rubjek
Xhafzotaj	Fshatrat; Xhafzotaj, Pjezë, Rreth, Sallmone, KoxShijak, Borake, Guzaj, Vllazërim
Gjepalaj	Fshatrat; Gjepalaj, Hardhishtë, Çizmeli, Eminas i Vogël, Likesh, Kënetë, Shtrazë, Shahinaj, Shetël

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejttimeve të auditimit

2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm

Në zbatim të pikës “1” dhe pikës “7” të programit të auditimit: **“Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm. Nën-pika 1.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë.**

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit Nr.10296, Datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe si ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Shijak, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

⁴ Burimi: <https://portavendore.al/bashkia-shijak/pasaporta-e-bashkise-shijak/>

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.

- Bashkia Shijak ka miratuar Rregulloren e Brendshme dhe Kodin e Etikës për parandalimin e Konfliktit të interesit të miratuar me shkresën e Titullarit Nr.8174 Prot., Datë 25.11.2022 dhe me Urdhrin Nr.409, Datë 25.11.2022. Njohjen e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria Juridike.

- Në Kodin e Etikës janë përfshirë IX kapituj me rregulla të etikës për zbatim nga stafi i punonjësve të Bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion. Qëllimi i këtij Kodit Etik është promovimi i rregullave të sjelljes dhe të etikës profesionale për punonjësit e administratës së Bashkisë Shijak dhe Njësive Administrative, gjatë dhe jashtë ushtrimit të kompetencave të tyre funksionale, në pajtueshmëri me aktet ligjore e nënligjore lidhur me rregullat e etikës në administratën publike.

- Në kreun II j anë përcaktuar parimet bazë të Kodit të Etikës, ku nënkuptojnë *vlerat individuale morale dhe parimet e përgjithshme të etikës në ushtrimin e funksioneve publike të gjithë nëpunësit/punonjësit e Bashkisë Shijak, janë të detyruar të respektojnë kushtetutën, ligjet, dhe aktet e tjera nënligjore, si dhe parimet e etikës, të jenë të ndershëm e të paanshëm, të rrisin efektivitetin e punës në të gjithë strukturat e shërbimit civil dhe jo shërbimit civil di dhe të forcojnë besimin e mbështetjen e publikut ndaj tyre.*

- Në nenin 44-45 të Kodit të Etikës janë përcaktuar procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsisë, mashtrimeve, të veprimeve korruptive. Nga testimi rezultoi se nuk ka patur raste të raportuara të shkeljes të kodit etik. Me shkresë Nr.1034 Prot., Dt.24.02.2022 (urdhër Nr.64, Datë 24.02.2022) kemi miratim të planit vjetor të trajnimeve në Bashkinë Shijak.

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (zyrën e informacionit), duke iu adresuar Kryetarit të bashkisë. Kjo procedurë është përcaktuar në nenin 45 të Kodit të Etikës shprehimisht se : - *“Cdo person që beson se është bërë subjekt i ndonjë veprimi të ndaluar, mund të bëjë ankesë konfidenciale në zyrën e personelit. Zyra e personelit duhet që të kryej verifikimin e kësaj ankese. Pas konkluzione ve të verifikimit duhet të ndërrmarrë veprime të përshtatshme sic parashikohet nga ligjet në fuqi”.*

-Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip dhe një herë në 6 muaj. Po ashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”.

- Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të tij.

- Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë për Titullarin (NA). Mungojnë raportet periodike, ndërsa për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

Me shkresë **Nr.977/1 Prot., Dt.24.02.2023** është firmosur Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brëndshëm Bashkia Shijak për vitin 2022 nga kryetar Z.E.A.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësive publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në

sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga 3 njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancë n e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

-Në bazë të ligjit **Nr.10296, Datë 08.07.2010** “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nenin 19 dhe 29, dhe shkresave përkatëse të Ministrisë së Financave nga Bashkia është plotësuar dhe dërguar pranë Njësisë Qëndrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pranë Ministrisë së Financave “Pyetësorin e vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm” për vitin 2022 meshkresën **Nr.977 Prot.,Datë 24.02.2023.**

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit dhe për vitin 2022 nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.

-Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.

- Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA. Bashkia Shijak nuk ka të hartuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Zhvillimit Strategjik, por ka të miratuar Planin Operacional të Zhvillimit Lokal. Në dokumentet e PBA e ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Bashkia Shijak ka hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme për Bashkinë Shijak dhe Njësitë Administrative, ku për vitin 2022 Rregullorja e Brendshme është miratuar nga Titullari me shkresën Nr.8161Prot., Datë 24.11.2022., me Urdhër të Brendshëm Nr.408, Dt.24.11.2022 nga Kryetari i Bashkisë Shijak Z.E.A.

Në nenin 1, neni 2, neni 3 të rregullores së brendshme është përcaktuar mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, që nënkupton metodën shkresore dhe elektronike, dhe ka urdhër të veçantë të Kryetarit të Bashkisë. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet me ndryshimet e strukturave organike.

-Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin aktivitetet, planveprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.

- Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë. Kështu:

- Për vitin 2022 struktura është miratuar me Vendim të Titullarit Nr.3742Prot., Dt.01.06.2022 me Urdhër më Nr.156 Prot., Datë 01.06.2022 “Mbi miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Shijak, njësisive administrative dhe funksioneve të deleguara” ku në total janë:

- 320 (treqindnjëzet) punonjës;
- 3 (tre) nivele drejtuese (Kryetar/ Kabineti/ Sekretari i Përgjithshëm);
- 7 (shtatë) Drejtori;
- 21(njëzetnjë) Sektore/Inspektive/Arsimimi(shkolla, cerdhe, qendra me aftësi të kufizuar);
- 4 (katër) Njësi Administrative/Gjendje Civile.

- Në Rregulloren e Brendshme janë përcaktuar për çdo Drejtori misioni, objektivat, baza ligjore, përbërja e strukturës, detyrat dhe përgjegjësitë për çdo drejtori, sektor dhe specialist. Në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion dhe objektivat për secilin punonjës.

- Bashkia Shijak ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.

- Vlerësimin e punës së strukturës organike, Bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”:

- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune dhe janë rishikuar për çdo vit si dhe janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nëndarjeve dhe fushave përkatëse.

Të dhëna për pozicionet në shërbimin civil për vitin 2022, Bashkia Shijak

Numri i punonjësve për vitin 2022

Plan	Fakt	Vakante
<u>320</u>	<u>302</u>	<u>18</u>

Pozicione në shërbimin civil sipas strukturës në plan 82 nga këto:

Pozicione të kategorisë së lartë drejtuese	1
Pozicione të kategorisë së mesme drejtuese	6
Pozicione të kategorisë së ulët drejtuese	11
Pozicione të kategorisë ekzekutive	64

Pozicione në shërbimin civil sipas strukturës në fakt 70 nga këto:

Pozicione të kategorisë së lartë drejtuese	-
Pozicione të kategorisë së mesme drejtuese	5
Pozicione të kategorisë së ulët drejtuese	10
Pozicione të kategorisë ekzekutive	55

Pozicione në shërbimin civil sipas strukturës të paplotësuara (vakant) 12 nga këto:

Pozicione të kategorisë së lartë drejtuese	1
Pozicione të kategorisë së mesme drejtuese	1
Pozicione të kategorisë së ulët drejtuese	1
Pozicione të kategorisë ekzekutive	9

✓ **Informacioni si më sipër për KLSH, Bashkia Shijak**

- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është dërguar me shkresë Nr.3757/1 Prot, Dt.01.06.2022 Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Vendimi Nr.258, Dt.01.06.2022 mbi “Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 është kryer procedurë nga DBNJ Shijak për publikim vendesh të lira në zbatim me ligjin Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe rekrutuar në përputhje me të. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale sipas nenit 26 të Rregullores së Brendshme, e cila përmban të dhëna të karakterit teknik, profesional, të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: certifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

- Me shkresë Nr.1034 Prot., Dt.24.02.2022 Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka miratuar Urdhrin Nr.64, Dt.24.02.2022 për “Plani Vjetor i Trajnimeve për Bashkinë Shijak”.

- Vërehet se mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Por nga Bashkia Shijak është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve dhe kjo tabelë i është dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Për vitin 2022 realizimi i trajnimeve të stafit në organizime jashtë Bashkisë paraqitet 107 trajnime të punonjës të Bashkisë Shijak nga ASPA, OJF, Ministri etj., por nga vetë institucioni nuk ka asnjë trajnim të brendshëm për nëpunësit e saj.

-Për Bashkinë nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit.

- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:

- Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor Ekonomik.

Në lidhje me parimin 5 “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.

Në Rregulloren e Brendshme në nenin 30 “Delegimi i detyrave” përcaktohet:

30.1. *Delegimi i kompetencave, bëhet në përputhje me aktet ligjore.*

30.2. *Çdo delegim kompetencë duhet të dokumentohet me shkrim, duke përcaktuar llojin e kompetencës, periudhën në të cilën lëshohet, personin të cilit i është deleguar kompetenca.*

30.3. *Delegimi i kompetencave nuk e shkarkon nga përgjegjësia deleguesin.”*

Janë kryer delegime detyrash të cilat janë bërë në bazë të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” Neni 59, Pika 3 me autorizimet dhe Urdhrat përkatës:

-Urdhër i Brendshëm Nr.48, Datë 18.02.2022 “Për delegimin e detyrës së koordinimit të rriskut” (shkresë Nr.872 Prot., Dt.18.02.2022).

-Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit Nr.10296, Datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit të MFE Nr.23, Datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde për përgatitjen e PBA të njësisë të Qeverisjes Vendore”, Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:

Për vitin 2022 me shkresën Nr.873Prot., Datë 18.12.2022 me Urdhër të Titullarit, Nr.49, Datë 18.02.2022 “Për ngritjen GMS dhe ekipeve të menaxhimit të programeve”. Në këtë urdhër është ngritur GMS me 4 anëtarë dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë (NA) dhe 4 ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA për vitin 2022.

Në Bashki ngrihet Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), i cili ndjek problemet që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin:

a) *Vendos rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar*

b) *Harton Buxhetin vjetor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA),*

c) *Ndjek zbatimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut,*

d) *Përgatit raporte në përputhje me rregullat, rregulloret dhe standardet e zbatueshme ose me objektivat e specifikuar të njësisë publike”*

Referuar kësaj nga auditimi rezulton se GMS nuk ka kryer detyrat si:

-Nuk ka vendosur rregulla të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar;

-Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë dhe merr vendime për zbatimin e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut,

-Me shkresën Nr.977 Prot., Datë 24.02.2023 i është dërguar Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave “*Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njesisë Bashkia Shijak dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm*” për vitin 2022.

Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë: *Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore; sistemi i programimit të zbatimit të buxhetit; sistemi i pagesave, sistemi i prokurimeve me vlera të vogla dhe të larta; inventarët e aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese; sistemi i tatim-taksave.*

Në kapitullin “Vlerësimi i sistemit të MFK” janë përshkruar se sa janë arritur objektivat në fushat prioritare për Bashkinë si në sektorin e shërbimeve publike, sektorin e urbanistikës dhe sektorin e tatim-taksave. Si ka ndikuar komponenti i informimit dhe komunikimit me procedurat me rregulloret e hartuara dhe të realizuara nga kjo njësi në arritjen e objektivave në sektorët më të rëndësishëm të veprimtarisë së bashkisë. Si ka funksionuar komponenti i monitorimit të kontrollit të brendshëm në cilësinë e performancës. Si ka ndikuar veprimtaria e AB në monitorimin e Kontrollit të brendshëm.

Gjithashtu janë paraqitur masat e marra për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe plan veprimi për të ardhmen për përmirësimin e performancës organizative dhe financiare të njesisë nga puna për arritjen e synimeve përkatëse të: Drejtorisë Ekonomike, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Pjesë e Deklaratës duhet të jetë edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo duhej realizuar nëpërmjet:

-Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit e të efektivitetit.

-Realizimit të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

-Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit.

-Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: -Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.

Bashkia Shijak në hartimin e PBA ka vendosur objektiva si në planet operationale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat kombëtare e sektoriale

si dhe me vizionin dhe misionin e njësisë. Këto objektiva bëhen të njohura, duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në Këshillin Bashkiak, si dhe dëgjesa me publikun.

- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

Në Bashkinë Shijak nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut. Nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në Bashki në të gjitha nivelet e saj, pra mungon regjistri i riskut. Edhe pse është ngritur grupi i menaxhimit të riskut ka një mungesë të veprimtarisë së tij për rrjedhojë, nuk janë hartuar as planet e veprimit për menaxhimin e riskut.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”.

Duke mos patur një vlerësim të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e Bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

- Në Rregulloren e brendshme nenin 14 “Koordinatori i Riskut” është përcaktuar:

Të dhëna të përgjithshme

Koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i Bashkisë Shijak

1.1. *Koordinatori i riskut mund t'i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut, punonjësve që janë pjesë e strukturës së financës.*

Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut

1.2. *Është përgjegjës për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të Menaxhimit të riskut.*

1.3. *Vlerëson sistemet e risqeve.*

1.4. *Bashkërendon aktivitetet lidhur me menaxhimin e riskut.*

1.5. *Harton dhe ndjek strategjinë e menaxhimit të riskut.*

Referuar kësaj rregulloreje këto detyra dhe përgjegjësi nuk janë realizuar lidhur me këtë komponent të MFK nga NA i cili nuk ia ka deleguar as punonjësve të Drejtorisë së Financës. Këto veprime e mosveprime janë në kundërshtim me ligjin Nr.10296, Datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 9 pika 3, neni 10, neni 11 pika 2.

Në lidhje me parimin 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

Bashkia Shijak në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për t'i paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar apo deleguar e autorizuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

Hartimi i Strategjisë së Riskut është në proces plotësimi, Menaxhimi i Lartë i Institucionit vepron në bazë të:

-Vetëvlerësimin për Kontrollin e Brendshëm.

- Vënien në zbatim të rekomandimeve të AB-së në fushën e MFK-së.
- Planveprimet e AB-së.
- Planveprimet e KLSH-së.

Gjithashtu Koordinator i riskut ka kryer trajnime të herëpashershme në lidhje me ligjin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit duke përcaktuar rolin e secilit Sektor apo Drejtori në funksion të komponentëve të MFK.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës.

Me shkresë Nr.874 Prot., Dt.18.02.2022 është miratuar Urdhri Nr.50 Datë 18.02.2022 “*Mbi zbatimin e ligjit Nr.10296, Datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, në Bashkinë Shijak*”. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj).

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës (NZ).

-Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i financës/Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA).

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit të komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimi të mallit.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh.

- Në Rregulloren e Brendshme në Kreun I neni 2 “Komunikimi ndër-Sektorial lëvizja e Dokumentacionit”, përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ***ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.***

- Për menaxhimin e aktiveve rregullat janë identifikuar në rregulloren e brendshme në detyrat e drejtorisë Ekonomike, por për menaxhimin e tyre veprohet në bazë të Udhëzimit Nr.30, Datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhërdorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit materiale. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve. Aktivitet Afatgjatë nuk janë regjistruara ne SIFQ, pasi kjo Bashki akoma nuk është pilot për aplikimin direkt në programin e Qeverisë SIFQ.

Në lidhje me parimin 11:“Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

- Bashkia Shijak nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Sistemet nuk kanë procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara dhe nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Në rregulloren e brendshme në nenin 14 pika 3 përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe ka vetëm detyra:

- për mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik dhe menaxhimin e programeve;
- të merret me instalimin e programeve;
- menaxhon Serverin kryesor duke garantuar sigurinë e sistemit të IT në lidhje me ndryshimet e fjalëkalimeve, fireëall-et, kufizimin e ndërhyrjeve në të dhënat e IT.

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, përgjegjësi këto të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë,por mungojnë plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

-Drejtuesit në Bashkinë Shijak kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacional, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur. Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit.

-Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe paraqiten pranë Këshillit Bashkiak si dhe në Degën e Thesarit ndërsa raportet për detyrimet e konstatuara por të papaguara hartohen çdo muaj dhe paraqiten në degën e thesarit.

-Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Shijak për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Microsoft Excel dhe nuk ka një program specifik të vetin të kontabilitetit. Në bazë të këtij programi kontabiliteti me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria Ekonomike, gjithashtu edhe monitorimi i të ardhurave kryhet me program Microsoft Excel i cili menaxhohet nga Sektori i Tatim-Taksave dhe i financave.

Në lidhje me parimin 14 dhe 15: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm dhe komunikimin e jashtëm.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenin 14 p/2:

-Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit për çdo muaj, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar. Informacioni prej drejtuesve dhe përgjegjësve të sektorëve dërgohen çdo muaj dhe nëpërmjet analizave të herëpashershme sigurohet informacion për arritjen e objektivave dhe dëmeve të mundshme.

-Përdorimin e emailit zyrtar e kanë vetëm Drejtorët dhe Përgjegjësit e Sektorëve, ndërsa komunikimi zyrtar mes punonjësve të Bashkisë realizohet përveç komunikimit verbal e shkresor kryhet nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale.

-Nga Bashkia Shijak kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të dokumentuara ne procesverbale si dhe te ngarkuara në faqen zyrtare të Bashkisë Shijak.

V. Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e Bashkisë, *por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.*

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

- *Në Bashkinë Shijak mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.*

- Një nga drejtuesit e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm i cili në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe ka dhënë vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm, vetëm për vitin 2022.

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

➤ KONKLUZIONE:

Titullari i këtij institucioni për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH. Vërehet se ka një përmirësim të pjesshëm në lidhje me zbatimin e komponentëve por përsëri akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

-“Mjedisi i kontrollit”

i)Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin, aktivitetet, planveprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.

ii)Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësive publike, për pasojë nuk ka plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Rezulton se, nga 3(tre) njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

iii)Nuk është evidentuar puna e anëtarëve GMS, duke u dokumentuar takimet dhe mbledhjet të për hartimin e planit strategjik dhe PBA. Në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme në pikën 6 të nenit 45 GMS nuk ka kryer detyrat si:

-Mungesa e vendosjes së rregullavë të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar.

-Mungesa e një programi strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit.

-Mos garantimi i ruajtjes dhe zhvillimit profesional të stafit dhe mungesa e programeve të trajnimit për punonjësit, për të ngritur në vazhdimësi nivelin e tyre profesional nga politikat dhe praktika e dobëta të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Bashkia Shijak.

-“Menaxhimi i Riskut”

i)Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

ii)Në Bashkinë Shijak nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut.

iii)Nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në Bashki në të gjitha nivelet e saj, pra mungon regjistri i riskut. Është ngritur grupi i menaxhimit të riskut dhe i mungesës së veprimtarisë së tij por nuk janë hartuar as planet e veprimit për menaxhimin e riskut. Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.

iiii)Nuk është bërë vlerësimi i riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e Bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

“Aktivitetet e Kontrollit”

i)Në Rregulloren e Brendshme në Kreun IX “Administrimi, Komunikimi dhe Ruajtja e dokumentacionit” në nenin 25“Të dhëna të përgjithshme” pika 5 “Ruajtja e dokumentacionit” përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

ii)Bashkia Shijak nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Sistemi nuk ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara dhe gjithashtu nuk ka rregulla të shkruara për ruajtjen e aktiveve.

“Informimi dhe komunikimi”

i)Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj.

“Monitorimi”

i)Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e Bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

ii)Në Bashkinë Shijak mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

iii)Aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit.

Titulli i gjetjes: KLSH ka konstatuar se në Bashkinë Shijak ngritja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm ka mangësi.

Situata: Nuk janë kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

-“Mjedisi i kontrollit”

i)Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin, aktivitetet, planveprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.

ii)Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Rezulton se, nga 3(tre) njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

iii)Nuk është evidentuar puna e anëtarëve GMS, duke u dokumentuar takimet dhe mbledhjet të për hartimin e planit strategjik dhe PBA. Në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme në pikën 6 të nenit 45 GMS nuk ka kryer detyrat si:

-Mungesa e vendosjes së rregullavë të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar.

-Mungesa e një programi strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit.

-Mos garantimi i ruajtjes dhe zhvillimit profesional të stafit dhe mungesa e programeve të trajnimit për punonjësit, për të ngritur në vazhdimësi nivelin e tyre profesional nga politikat dhe praktika e dobëta të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Bashkia Shijak.

“Menaxhimi i Riskut”

i)Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

ii)Në Bashkinë Shijak nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut.

iii)Nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në Bashki në të gjitha nivelet e saj, pra mungon regjistri i riskut. Është ngritur grupi i menaxhimit të riskut dhe i mungesës së veprimtarisë së tij por nuk janë hartuar as planet e veprimit për menaxhimin e riskut. Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.

iiii)Nuk është bërë vlerësimi i riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e Bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

“Aktivitetet e Kontrollit”

i)Në Rregulloren e Brendshme në Kreun IX“Administrimi, Komunikimi dhe Ruajtja e dokumentacionit” në nenin 25“Të dhëna të përgjithshme” pika 5 “Ruajtja e dokumentacionit” përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

ii)Bashkia Shijak nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Sistemi nuk ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara dhe gjithashtu nuk ka rregulla të shkruara për ruajtjen e aktiveve.

“Informimi dhe komunikimi”

i)Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj.

“Monitorimi”

i)Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e Bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

ii)Në Bashkinë Shijak mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

iii)Aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit.

Kriteri: -Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenet 8, 16, 22, 23 dhe 24. -Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë Shijak.

Ndikimi/Efekti: Mosevidentimi i aktiviteteve me risk të lartë, mosmarrja e masave të nevojshme për zvogëlimin e riskut, me qëllim mirëmenaxhimin e fondeve publike, përbëjnë risk për institucionin dhe ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave të institucionit.

Shkaku: Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit Nr.10296, Datë 08.07.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Shijak, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon:

- Për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij;
- Për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve;
- Hartimin e regjistrit të riskut, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit;
- Të aplikojë programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar;
- Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”;
- Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”;
- Të hartohen programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit nga Bashkia Shijak.
- Të organizojë trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;

Për sa më sipër, për mangësitë e konstatuara në fushën e MFK, ngarkohen me përgjegjësi Z.E.A me detyrë Kryetar i Bashkisë Shijak në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, Znj.B.O, me detyrë Koordinatorë Risku, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe Znj.E.Sh në cilësinë e Drejtorit të DBNJ-së.

2. Vlerësim mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm.

1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

1.3 Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm, të auditim Nr.430/1Prot., Datë 19.05.2022“Mbi auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2022–31.12.2022”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njësisë AB të Bashkisë Shijak;
2. Planet Strategjik dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Planifikimi vjetor për vitin 2022 dhe pasqyrat shoqëruese;
4. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2022;

5. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
6. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
7. Dosjet koherente të subjekteve të audituara;
8. Projektraportet dhe raportet përfundimtare të auditimit të brendshëm të njësive publike;
9. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre;

I-Vlerësimi dhe aktiviteti i Auditit të brendshëm në sektorin publik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Bazuar në planin strategjik e vjetor të miratuar nga Titullari i Bashkisë Shijak me Nr. 5361/3 Prot., Datë 21.02.2022 i rishikuar dhe Planit vjetor të rishikuar me Nr.5691Prot., Datë 09.09.2022 Sektori i Auditimit të Brendshëm ka zhvilluar veprimtarinë e tij për periudhën Janar- Dhjetor 2022 në zbatim të programit.

Sektori i Auditit të Brendshëm, në nivel sektori është i përbërë me strukturën prej 3(tre) nëpunësa, 1(një)përgjegjës, 2(dy) specialistë auditimi. Sektori i Auditit të Brendshëm ushtron veprimtarinë e saj bazuar në Ligjin Nr.114 Datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, Urdhërin e Ministrit të Financave Nr.100, Datë 25.10.2016 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik” dhe ka si funksion kryesor mbështetjen e menaxhimit të lartë në zbatimin e objektivave, për Bashkinë e Shijak, në zbatim të kërkesave të ligjit Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, germa “c” si dhe neni 64, germa “a” të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

-Varësia organizative e NJAB në organigramën e Bashkisë Shijak është drejtpërdrejtë nga titullari i institucionit (Kryetari Bashkisë Shijak).

Konstatohet se me shkresë Nr.977Prot., Dt.24.02.2023 nga Bashkia Shijak është dërguar informacioni, Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm Tiranë mbi raportin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për vitin 2022, si dhe pasqyrat si më poshtë.

Me shkresë **Nr.977Prot.,Dt.24.02.2022** është dërguar nga Bashkia Shijak raporti vjetor i veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, ku vërehet se gjatë vitit 2022 sektori i auditimit ka vazhduar të ketë probleme me plotësimin e strukturës organizative për arsye të mospërbushjes së kriterëve të vendit të punës.

Konstatohet se, në auditimet e kryera ka mangësi ka funksionimin e kontrollit të brendshëm, në njohjen e komponenteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në vlerësimin e detyrimeve tatimore të taksapaguesve, në hartimin e dokumentacionit dhe evidentimin e saktë të vlerësimit dhe pagesës së taksave dhe tarifave vendore.

I/a. Situata e strukturës së NJAB në Bashkinë e Shijak nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022 paraqitet në tabelën si vijon:

Struktura e kësaj njësie auditimi, në formë tabelore për periudhën e audituar viti 2022, paraqitet si më poshtë:

Pasqyra 1.

TE DHENA PER AUDITUESIT E BRENDSEHEM			
	<table border="1"> <tr> <td style="width: 50%;">Eksperienca e Punës</td> <td style="width: 50%;">Zhvillimi Profesional</td> </tr> </table>	Eksperienca e Punës	Zhvillimi Profesional
Eksperienca e Punës	Zhvillimi Profesional		

N R	EMER MBIE MER	Pozicioni	Arsimi Baze	Niveli i Diplomes	Vite t e Pun es Gjithsej	Vite t e Pun es ne AB	Çertifikimi			Trajtime ne Fushen e AB	
							I pa çertifikuar	Ne proces çertifikimi	I çertifikuar ne vitin	Nga Inst. Kombetare ose Nderkombetare	Publikime ne fushen e AB
a.	b.	1	2	3	4	5	6.1	6.2	6.3	7.1	7.2
1	S.B	Pergjegjese	I lart e	Diplo me e nivelit dyte(DND)	7	2		1		1 trajnim profesional si auditues i brendshëm IEF	
2	A.R	Speciale	I lart e	Diplo me e nivelit dyte(DND)	2	2		1			
3	R.H	Speciale	I lart e	Diplo me e nivelit dyte(DND)	5	4		1			

Burimi i të dhënave: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Shijak

Nga auditimi u konstatua se struktura organizative e Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 është përcaktuar që NJAB të ketë në përbërjen e saj **3(tre)** punonjës, por që për periudhen nën auditim rezulton se kjo njësi ka funksionuar me 2(dy) punonjës, 1(një) përgjegjës i njësia të pa çertifikuar, **për rrjedhojë të 3(tre) specialistët e auditit si më sipër përshkruar janë në proces çertifikimi**, në kundërshtim me ligjin Nr.114/2015 “Manualit të Auditimit të Brendshëm” miratuar nga Ministër i Financave Nr.100/ 2016 dhe VKM Nr.83/2016, përcaktohet qartë që në strukturën e [AB] mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pa çertifikuar si auditues të brendshëm dhe gjatë afatit 2 vjeçar zhvillon trajnimet e mjaftueshme për t’u çertifikuar [NJAB].

- **Në zbatim të planit strategjik është hartuar plani vjetor për vitin 2022** ku bashkangjitur janë pasqyrat të cilat pasqyrojnë në detaje aktivitetin e punës së Njësia të Auditimit të Brendshëm për vitin 2022, si dhe planifikimin strategjik për vitet 2022-2024 si më poshtë:

Pasqyra Nr.1: Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet nga NJAB për Bashkinë Shijak nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022 paraqitet në aneksin 2.1/2 bashkëlidhur.

Pasqyra Nr.2: Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar nga NJAB, Bashkia Shijak nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022 paraqitet në aneksin 2.1/2 bashkëlidhur.

Pasqyra Nr.3: Plani i angazhimeve të NJAB për Bashkinë Shijak nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022 paraqitet në aneksin 2.1/3 bashkëlidhur.

Planifikimi Vjetor i nevojave për Trajnim të NJAB për vitin 2022

Nr	Tematika e identifikuar për Trajnim	Pjesemarres ne Trajnim (nr.personave)	Periudha (gjate vitit)	Kohezgjatja e trajnimit (ne dite)
a.	1	2	3	4
1	Menaxhimi i riskut	3	Mars	1
2	Teknika të vlerësimit të investimit	3	Prill	1
3	Analizë e performacës financiare dhe raportim financiar	3	Maj	1
4	Audit dhe kontrolli financiar	3	Qershor	1
5	Kontrulli financiar (përmirësimi i efektivitetit dhe transparenca e menaxhimit financiar lokal - Kriteri i Aftesisë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësisë, kapitulli 32)	3	Gusht	1
6	Antikorrupsioni	2	Shtator	1
	Shuma			6

Pasqyra Nr.4: Parregullsitë e identifikuar nga NJAB Bashkia Shijak për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 paraqitet në aneksin 2.1/4 bashkëlidhur.

➤ **Analiza e misioneve të auditimit, objektivave të auditimeve, fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre sipas pasqyrave më lart.**

Tek të 5 (pesë) auditimet janë hartuar planet e veprimit nga ana e Audituesve dhe nga subjekti i audituar. Vërehët që ka vend për përmirësime pasi struktura është e re dhe jo e trajnuar si dhe mungesa e suportit të vazhdueshëm nga ana e Drejtorisë Harmonizimit dhe Kontrollit të Brendshëm në mënyrë që të përmirësohet puna audituese dhe kontrollit të AB të Bashkisë Shijak. Sipas planifikimit vërehet se ishte programuar një angazhim auditimi në sektorin e taksave dhe tarifave vendore (aktualisht me ndryshimin e strukturës Drejtorinë e Taksave, Tarifave vendore dhe kadastrës fiskale) por në kohën e kryerjes ka ndeshur mbivendosje planesh me KLSH dhe plani është rishikuar përsëri duke u miratuar tek titullari. Auditimet e realizuara nga NJAB janë auditimi i klubit shumësportësh Erzeni, Drejtoria e Bujqësisë dhe Njësitë Administrative Xhafzotaj, Gjepalaj dhe Sektori i Emergjencave Civile.

-Nga Angazhimet e auditimit për vitin 2022 u vlerësuan me risk të lartë Sektori i emergjencave, për shkak të shmangieve të planeve të mëparshme dhe nga sektori auditimit dhe situatës pandemisë e tërmetit më vonë ishin shkaqet pse u vlerësua me risk të lartë ky sektor.

-Klubi shumësportësh Erzeni si shkak i një Auditimi të papërfunduar pa raport përfundimtar për shkak të largimit të punonjësës nga sektori auditimit, sektori mbeti i vetëm me një punonjës.

Drejtoria e Bujqësisë gjithashtu është klasifikuar me risk të lartë për shkak të mos auditimit për 3 vite rradhazi.

-Njësitë administrative Xhafzotaj janë vendosur në plan duke arsyetuar shkakun kohor si faktor mos auditimi dhe mungesa e eksperiencës profesionale të specialistëve(audituesve).

-Gjetje me efekte financiare nuk ka dhe parregullsitë e evidentuara përmbledhen sipas pasqyrës mbi gjetjet e parregullsive bashkëlidhur këtij raporti.

➤ **Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm**

Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm është bërë vlerësimi i kontrollit të brendshëm si një nga detyrat themelore të auditimit të brendshëm. Miratimi i strategjisë së riskut mbetet një nga synimet kryesore për 2023 për institucionin por vërehet që janë bërë hapa gjatë 2022 për hartimin e strategjive në nivel sektori e drejtorie për arritjen e këtij synimi. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm bëhet nga vet drejtuesi i njësisë auditimit dhe vetkontrolli i veprimeve duke qënë se nuk kanë një komitet auditimi (mungesë fondi për krijimin e një strukture të tillë) për të pasur një vlerësim më të saktë e profesional.

➤ **Trajnimet e [NJAB] dhe certifikimet**

Referuar ligjit Nr.10296/2010, Manualit të MFK miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr.8980, Dt.15.07.2010, Manuali i Ri me Urdhrin e Ministrit të FE Nr.108/2016 të MFK, Ligjit Nr.114/2015 “Mbi Auditimin e Brendshëm” dhe “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, rëndësi i është kushtuar trajnimeve të audituesve të [NJAB] sipas planit të trajnimeve, përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Aktualisht NJAB është në proces certifikimi te audituesve në organiken e saj me shkresë Nr.13881/1 Prot., Dt.19.07.2022 nga Drejtoria e Harmonizimit dhe Kontrollit të Brendshëm, Ministria e Financave.

Për vitin 2022 trajnimet e audituesve të NJAB për Bashkinë Shijak pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Konstatohet se [NJAB] në Bashkisë Shijak, nuk ka respektuar të gjitha trajnimet e detyrueshme vjetore planifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me Ligjin Nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm të Sektorit Publik”.

Mungesa e trajnimeve cdo vit në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka ndikim negative për njësinë pasi stafit i mungojnë njohuritë mbi mënyrën e funksionimit të këtij sistemi, përgjegjësitë, shkallën hierarkike etj. Mungesa e transparencës për publikun lidhur me njohjen dhe veprimtarinë e këtij institucioni, shkak për këtë është mosveprimi i titullarit të institucionit mbi hartimin e një program trajnimi mbi menaxhimin e riskut si dhe krijimin e ebsite të institucionit me qëllim rritjen e transparencës.

Bazuar si më sipër Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbeshtetëse të marrë masë për punonjësit të kryejnë trajnimet mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një insitucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

1/c. Hartimi dhe zbatimi i planeve të Auditit të Brendshëm

Cilësia dhe përmisimi i vazhdueshëm janë integruar në procesin e kontrollit të brendshëm.

Nga Sektori i Auditit të Brendshëm janë hartuar dhe miratuar për çdo vit në zbatim të ligjit Nr. 114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin Publike”, planet strategjike dhe vjetore sipas formateve të dërguar në Njësinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (Ministria e Financave) dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë.

Nga auditimi rezultoi se, bazuar në planin strategjik e vjetor të miratuar nga Titullari i Bashkisë Shijak me Nr 5361/3 prot. datë 21.02.2022 i rishikuar dhe Planit vjetor të rishikuar me Nr.5691Prot., Datë 09.09.2022 Sektori i Auditimit të Brendshëm ka zhvilluar veprimtarinë e tij për periudhën Janar- Dhjetor 2022 në zbatim të programit.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer 5(pesë) angazhime Auditimi nga të cilat: 2(dy) të kombinuar, 2(dy) përputhshmërie 1(një) auditim performance. Auditime të konfirmuara me shkresën Nr.977 Prot, Datë 24.02.2022 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave ku është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së Strukturës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 në përputhje me kërkesat e nenit 14, të Ligjit Nr.114/2015, Datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Janë dhënë 23(njëzetetre) rekomandime për përmirësimin e punës dhe ndreqjen e parregullsive, si dhe për funksionimin e kontrolleve të brendshme për 5(pesë) angazhimet e auditimit. ***Përgjithësisht Drejtoritë dhe sektorët kanë filluar të zbatojnë rekomandimet e lëna dhe janë në proces të ndjekjes së tyre.***

Në mënyrë të përmbledhur auditimet e planifikuara dhe të realizuara paraqiten si vijon:

Nr	Periudha	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financiar	Kombinuar	Performa	Tjera
1	Viti 2022	5	5	2	0	2	1	-

Burimi i të dhënave: Njësia e Auditimit të Brendshëm

➤ ***Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së auditimit të brendshëm***

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve u konstatua se:

- Përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, ”Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB).

- Sektori i A.B në zbatim të planit vjetor nuk ka përfshirë në grup pune specialist të sektorëve të ndryshëm, për kryerjen e auditimit sipas programeve të miratuara nga Titullari i Bashkisë. ***Sektori i Auditimit të brendshëm edhe gjatë vitit 2022 ka vazhduar të ketë mangësi në certifikimin e specialistëve të auditimit të brendshëm.***

Subjektet e audituara edhe pse i kanë pranuar rekomandimet e dhëna nga AB dhe kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimit, rezulton që nuk është kryer auditimi i detyrave dhe rekomandimeve të lëna, në përputhje me ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB.

-Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, (Kapitulli VI, “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”), në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me rrisqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimit që do të ndiqen dhe grupin e auditimit. Vend të vecantë në program zënë edhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme. Në përgjithësi referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjorë në fuqi.

➤ ***Sigurimi i cilësisë në auditimet e kryera dhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna.***

Për veprimtarinë e Sektorit të AB për periudhën nga data 01.01.2022 deri në 31.12.2022 është raportuar në mënyrë sistematike Kryetarit të Bashkisë Shijak. Nga auditimi i raportimit vjetor për vitin 2022, janë dhënë 23(njëzetetre) rekomandime për përmirësimin e punës dhe ndreqjen e parregullsive, si dhe për funksionimin e kontrolleve të brendshme për 5(pesë) angazhimet e auditimit. Nga Drejtoritë dhe sektorët e audituar janë hartuar planveprimet me afatet konkrete dhe personat përgjegjës mbi rekomandimet e lëna nga auditimi i fundit. ***Përgjithësisht Drejtoritë dhe sektorët kanë filluar të zbatojnë rekomandimet e lëna dhe janë në proces të ndjekjes së tyre.***

Auditimet e realizuar dhe rekomandimet e realizuara për vitin 2022 paraqiten në tabelën si vijon:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT							
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej numër	në Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej Leke	në Zbatuar	Ne proces	Pa zbatuar
1	Viti 2022	23	-	23	0	-	-	-	-
TOTALI		23	-	23	0	-	-	-	-

Burimi i të dhënave: Njësia e Auditimit të Brendshëm

Konstatohet se: -Nga sa më lart grupi i auditimit thekson se NJAB në të gjitha angazhimet të kryera gjatë periudhës objekt auditimi në punën e tyre pavarësisht dhënies së rekomandimeve nuk janë treguar këmgulës në auditimin e zbatimit të rekomandimeve dhe nuk është bërë në afatin e përcaktuar në manualin e auditimit pas 6-muajsh.

Konstatohet se:- NJAB për periudhën objekt auditimi ka të miratuar një program auditimi në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna në subjektet e audituara, por ende nuk është realizuar veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin Nr.114/2015, Datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

-Struktura e Njësia së Auditimit të Brendshëm, nuk është në përputhje me pikat 3 dhe 6 të, VKM Nr.83, Datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”,

KONKLUZIONE:

➤ Komiteti i Auditimit të Brendshëm: Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin Nr.114/2015“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”, i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësia publike, si dhe mbështetës për njësia e auditimit të brendshëm”:

- Duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;*
- Duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;*
- Duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;*
- Duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;*
- Duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna;*
- Duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.*

➤ NJAB nuk ka kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, të tilla si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, lejet e ndërtimit, etj.. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM Nr.83, Datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, nenin Nr.5 dhe Nr.6 të ligjit Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

➤ Miratimi i strategjisë së riskut mbetet një nga pikat me sensitive në lidhje me mungesën e hartimit të strategjive në nivel sektori e drejtorie për arritjen e këtij synimi.

➤ Nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim).

- Nga ana e Njesisë së Auditimit Bashkia Shijak për periudhën e auditimit nuk është kryer verifikimi i zbatimit të rekomandimeve me program tematik të veçantë, por është bërë verifikimi i rekomandimeve në auditimin e radhës, gjë që vjen në kundërshtim me Manualin e auditimit të miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave Nr.100, Datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, pikën 4.1.13.2, Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve, ku përcaktohet se: *“Kur nuk është planifikuar angazhim auditimi në vitin në vazhdim, audituesit duhet t’i mundësojnë një raport të shkurtër titullarit të njesisë, për progresin e bërë në zbatimin e rekomandimeve të rëna dakord më parë. Në këto raste rishikimi i zbatimit të rekomandimeve mund të realizohet në auditimin e radhës në subjektin publik si pikë e veçantë e programit të auditimit”*.
- Audituesit e brendshëm në punën e tyre pavarësisht dhënies se rekomandimeve nuk janë treguar këmbëgulës në auditimin e zbatimit të rekomandimeve dhe nuk është bërë në afatin e përcaktuar në Konkluzione mbi problematikat e punës si auditues.
- Problem mbetet mosçertifikimi si “Auditues të Brendshëm në sektorin publik” i punonjësve i cili do të ishte i dobishëm në efektivitetin e shërbimit të auditimit të brendshëm dhe do të ndikonte në rritjen e efikasitetit në kryerjen e angazhimeve të auditimit sipas planit vjetor. Audituesit janë të rinj dhe mungesa eksperiencës ndikon në kohën e nevojshme për kryerjen e auditimeve.

Titulli i gjetjes: Mangësi në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm. Mungesa e trajnimit dhe certifikimit të audituesve në sektorin e AB.

Situata: Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, në Bashkinë Shijak është organizuar dhe ka funksionuar Njësia e Auditimit të Brendshëm e përbërë nga dy specialistë si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit. Nga këta asnjë nga punonjësit nuk janë të pajisur me çertifikatën e auditimit të brendshëm, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, neni 11 dhe të VKM Nr.83, Datë 03/02/2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 3., por u konstatua që janë në proces certifikimi.

-Në të gjitha dosjet e auditimit mungon memo e planifikimit, pra projekt-drafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit. Në procesin e planifikimit nuk është vlerësuar si duhet risku, përlllogaritja e tij si dhe përcaktimi i materialitetit.

-Në fund të procesit të auditimit mungojnë letrat e punës për secilin auditues, të cilat duhet të përfshijnë regjistrimin e punës së audituesit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemit, dokumentet e punës audituese. Mungon vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë NJAB, i cili kryhet nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik.

-Audituesit e brendshëm në punën e tyre pavarësisht dhënies se rekomandimeve nuk janë treguar këmbëgulës në auditimin e zbatimit të rekomandimeve dhe nuk është bërë në afatin e përcaktuar në Konkluzione mbi problematikat e punës si auditues

- NJAB nuk ka kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, të tilla si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, lejet e ndërtimit, etj..

-Për rekomandimet e lëna nuk është bërë analiza e tyre, pasi nuk është hartuar program i veçantë për shkallën e zbatimit të tyre, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuara në raportet e auditimit.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 11, “Punësimi i audituesit të brendshëm”, neni 19 “Çertifikimi i audituesve të brendshëm” dhe neni 20, “Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm”, me MAB të miratuar me Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” pika 2.6, “Roli dhe përgjegjësitë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm” nënpika (c) dhe pika 3.5

“Rishikimi i planeve strategjike dhe planit vjetor të AB”, kapitulli III, “Drejtimet e auditimit”, kapitulli IV pikat 4.1.7-4.1.12, kapitulli IV, pika 4.1.1 “Planifikimi i një angazhimi auditimi”, kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” pika 6.1 “Niveli i dokumentimit”, Kapitulli VII “Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm”, pika 7.1.1. “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë Njësia e Auditimit të Brendshëm”, Pika 3 e VKM Nr.83, Datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, nenin Nr.5 dhe Nr.6 të ligjit Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Ndikimi/Efekti: Mosrealizimi i objektivave dhe moskryerja e auditimit të brendshëm në njësi, shkakton mangësi në njohjen e problemeve nga menaxhimi i njësisë dhe pengon marrjen e masave në kohën e duhur për zgjidhjen e problemeve dhe parandalimin e fenomeneve negative, si mitmarrja, mashtrimi dhe korrupsioni.

Shkaku: Mosekzistenca e një stafi profesional të NJAB dhe realizimi i auditimeve jo në shkallën dhe nivelin e duhur në mospërputhje me kriteret e pranuar.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, të merren masa për mbylljen e çertifikimit dhe trajnimin e audituesve të rinj, për rritjen e aftësisë profesionale të tyre. Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve, përcaktimit të përgjegjësive si dhe formulimit konkret të rekomandimeve. NJAB të kryejë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik. Të planifikohet dhe realizohet program angazhimi për ndjekjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1.Z.E.A,** me detyrë kryetar i Bashkisë Shijak;
- 2.Znj.S.B,** Përgjegjëse në Njësinë e Auditit të Brendshëm;
- 3.Znj.A.R,** Specialiste në Njësinë e Auditimit të Brendshëm;
- 4.Z.R.H,** Specialist në Njësinë e Auditit të Brendshëm.

2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

2.2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallra e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i taveve të shpenzimeve sipas programeve, etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

PBA 2022-2024 është miratuar me VKB nr. 82, datë 24.12.2021, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës me shkresën nr 09/3 datë 12.01.2022, PBA është miratuar brenda

afateve që përcakton pika 2 e nenit 39 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (brenda datës 25 dhjetor).

Në VKB e mësipërme për miratimin e PBA 2022-2024 të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2022 kanë vlerën 319,731,000 lekë, transferta e pakushtëzuar ka vlerën 141,939,000 lekë, transferta specifike ka vlerën 94,022,000 lekë. Të ardhura të trashëguara nga viti i mëparshëm 256,249,000 lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën 1,945,693,000 lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 1,945,693,000 lekë.

Të dhënat për PBA për vitin 2022 sipas tabelave në vijim:

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2021	Faza e I PBA 2022	Faza e II PBA 2022	Projekt Buxhet 2022
600	Paga	159,208	172,109	185,503	185,503
601	Sigurime Shoqërore	26,553	30,372	30,554	30,554
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	118,154	130,250	198,547	198,547
604	Transferta Korente			800	800
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,256,348	191,300	15,917	15,917
609	Rezervat	400	9,057	6,093	6,093
I	Shpenzime Korrente	1,560,663	533,088	437,414	437,414
230	Kapitale të Patrupëzuara				
231	Kapitale të Trupëzuara	371,577	576,217	1,328,279	1,328,279
	Shp. Kapitale me financim te brendshëm	371,577	576,217	1,328,279	1,328,279
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0		
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0			
II	Shpenzime Kapitale	371,577	576,217	1,328,279	1,328,279
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti				
	I+II +III Totali I Shpenzimeve	1,932,240	1,109,305	1,945,693	1,945,693

Gjatë vitit 2022, është marrë një vendim i këshillit bashkiak i cili ka bërë që të ndryshojnë vlerat e PBA bazë (miratuar në dhjetor 2021). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me VKB nr.12, datë 11.03.2021 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Shijak për miratimin e buxhetit shtese për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2021, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 256,249,000 lekë. Gjithashtu ka ardhur dhe një transfertë specifike për pagat e arsimit në vlerën 866,000 lekë. Shtesa në buxhet ka qenë në vlerën 257,115 lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për investime për vitin 2022 ka vlerën 1,328,279 lekë, por realizimi i këtij plani është shumë i ulët, në vlerën 292,172,218 lekë. Si rezultat i mos realizimit të investimeve të planifikuara kanë ngelur pa u realizuar disa investime të rëndësishme për komunitetin, të miratuara në buxhet, si: Rehabilitim i lumit Erzen/NjA Shijak, Rivilatizim i Lumit Erzen, Rehabilitim Diga e Liqenit Rrubjeke NjA Ad Maminas etj.

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga pushteti qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli

është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë periudhës së audituar, janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit, këto lëvizje janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me VKB.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit.

Përgjatë vitit 2022 janë marrë disa vendime të tjera nga Këshilli Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë të miratuar në muajin dhjetor të vitit 2021, si më poshtë:

Me VKB nr. 12, datë 11.03.2022, është kryer shtesë për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2021, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 257,115,000 lekë. Të dhënat mbi ndryshimet e buxhetit për vitin 2022 shtesa dhe pakësime paraqiten si më poshtë:

Tabela e ndryshimeve te buxheteve viti 2022

000/lekë

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr/ datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artikull (me emër)/ shtuar artikull (me emër)			
					SHTESA art.	shuma	PAKSIM E art.	shuma
Viti 2022	Nr.82, dt.24/12/2021	1,945,693	Nr.12,dt 11.03.2021	257,115	600+601,Pag a dhe sigurime.	7,866		
					602 Shp. te tjera	42,965		
					230+231, Investime	79,554		
					606, Transferime te buxhetit familjar dhe individë	126,729		
					Shuma shtese fonde	257,115		

Burimi: Bashkia Shijak

Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të EMP për buxhetin afatmesëm 2022-2024, ku kërkesat janë hartuar duke iu referuar kryesisht realizimit të artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

Nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, në Bashkinë Shijak konstatohet se për vitin 2022, gjendja fillestare e planit të çelur së bashku me fondet e trashëguara është 1,945,693 mijë lekë. Me VKB e sipërpërmendura ka pasur shtesë buxheti në vlerën 257,115 mijë lekë.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nën artikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të hartimit dhe zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Durrës dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuar sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitin 2022, u konstatua se është realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit 2022, buxheti i Bashkisë Shijak ka pësuar ndryshime nëpërmjet VKB, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Durrës.

U verifikuan situacionet mujore të rakorduar me Degën e Thesarit Durrës dhe u gjetën të rakorduara me shpenzimet e kontabilizuara për pjesën e të ardhurave dhe tarifave të Bashkisë dhe të granteve. Të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, për llogari të Bashkisë Shijak janë kryer në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë të dokumentuara dhe të rregullta, edhe në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit Durrës, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve. Gjatë auditimit, rezulton se Kryetari i Bashkisë ka raportuar normalisht në Këshillin Bashkiak për gjendjen ekonomiko-financiare në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

2.2.3. Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha 01.01.2022 deri datën 31.12.2022, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi I shpenzimeve	Art	Plani	Fakti
Paga	600	191,745	165,112
Sigurime Shoqërore	601	32,178	27,753
Shpenzime operative	602	241,512	153,297
Transferime korrente tek nivele te tjera te Qeverise	604	800	5,100
Transferta ne buxhetet familjare (Ndihme ekonomike dhe PAK)	606	322,646	191,270
Rindertimi	606	0	490,425
Fondi rezerve	609	6,093	0
Investime	230	0	0
Investime	231	1,407,834	292,172
Shuma nga plani i bashkisë			
Totali i Buxhetit të Bashkisë		2,202,808	1,325,130

Burimi: Bashkia Shijak

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se plani i buxhetit i gjeneruar nga thesari ka vlerën 1,563,495,700 lekë e cila nuk përputhet me vlerën e planit të buxhetit të miratuar nga këshilli bashkiak që ka vlerën 2,202,808,000 lekë, ose 639,312,300 lekë më shumë se plani buxheti i gjeneruar nga thesari.

Planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transferta e pa kushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën **596.596,000** lekë, ndërsa realizimi **474,585,000** lekë, ose në masën 79.5%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën 191,745,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 165,112,000 lekë, ose në masën 91%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 86%. Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën 241,512,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 158,398,000 lekë, ose në masën 65 %. Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 1,407,834 lekë dhe është realizuar në vlerën 292,172 lekë, ose në masën 20 %. Bashkia Shijak për vitin 2022 nuk ka përfituar subvencione nga Pushteti Qendror. Bashkia Shijak për vitin 2022 nuk ka aplikuar për kredi.

Titulli i gjetjes: Diferenca të dukshme midis vlerës së planifikuar të shpenzimeve buxhetore dhe vlerës së realizuar, për zërat të cilët mbulohen nga të ardhurat e veta transfertat dhe buxheti I shtetit.

Situata: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e vetë Bashkisë Shijak së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe buxhetit të shtetit, për vitin 2022 kanë diferencë të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2022 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 2,202,808 mijë lekë, ndërsa realizimi vlerën 1,325,130 mijë lekë, ose në masën 60.1%. Në mos realizimin e buxhetit ka ndikuar niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Për vitin 2022 investimet janë planifikuar në vlerën 1,407,834 mijë lekë, realizuar 292,172 mijë lekë, ose në masën 20.7%. Gjithashtu edhe shpenzimet operative të cilat janë planifikuar në vlerën 241,512 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 153,297 mijë lekë ose në masën 63.4%.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Shijak në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012, datë 07.12.2012, dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar me Ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 gërma “c” dhe “ç”, Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”; UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe VKB përkatëse.

Ndikimi/Efekti: Planifikimi joreal i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve e investimeve dhe mos realizimi i tyre kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njëjësive vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

Shkaku: Planifikim i të ardhurave dhe më pas i procedurave të prokurimeve për mallra/shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke u mbështetur në planifikim dhe jo në realizimin faktik. Mungesa e një analize financiare në programimin e buxheteve, mos nxjerrja e konkluzioneve të sakta për mosrealizimet e buxheteve në periudhat e mëparshme, si dhe mos respektimi i kërkesave ligjore për programimin e buxheteve.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Shijak, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z.E.A me detyrë Kryetar e Bashkisë Shijak dhe Znj. P.A me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit të MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrisë e linjës etj.,).

Vlera e raportuar nga Bashkia Shijak në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2022 është 33,198,431 lekë, ndërsa vlera e detyrimeve të prapambetura të rakorduar me degën e thesarit dhe pasqyruar në pasqyrat financiare të bashkisë është 35,076,771 lekë.

Diferenca midis vlerës së detyrimeve të prapambetura të raportuar në MFE me vlerën e rakorduar me degën e thesarit është 1,878,340 lekë më pak në MFE, e pa raportuar në këtë të fundit dhe përbëhet nga: Detyrime të prapambetura për mallra që mbulohen nga të ardhurat e veta. Nga këto detyrime 4 fatura në vlerën 383,354 lekë janë fatura të palikuiduara të viteve të mëparshme ndërsa për 12 fatura në vlerën 1,494,986 lekë janë fatura të palikuiduara për periudhën Nëntor- Dhjetor 2022 për të cilat nuk ka kaluar afati 60 ditor.

Bashkia Shijak në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 7,114,213 lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Nga kjo vlerë nuk është parashikuar në planin e buxhetit vjetor 2022 për likuidim gjatë këtij viti, gjatë vitit 2022 nga kjo vlerë është likuiduar vetëm vlera 2,326,412 lekë.

Por gjatë vitit 2022 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 28,410,631 lekë, duke e çuar në 31.12.2022 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 33,198,431 lekë.

Peshën kryesore të detyrimeve e zënë ato për investime në vlerën 27,935,303 lekë, ose në masën 84% të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta.

Pra, në datën 31.12.2022 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, Shijak ka krijuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022), është rritur me 26,804,219 lekë, ose në masën prej 476%.

Të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më 31.12.2022 jepen në tabelën në vijim: Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhës në buxhetet respektive:

Detyrime e NJQV për 2022	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2021	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2022	Total detyrime	Shlyerja gjatë 3 mujorit të parë 2022	Mbetja në fund të vitit 202
A	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministritë e linjës					
b. Investime nga Bashkia		149,841,311	149,841,311	121,906,008	27,935,303
Investime	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	0	475,328	475,328	0	475,328
Vendime gjyqësore	7,114,212	0	7,114,212	2,326,412	4,787,800
Të tjera ...	0	0	0	0	0
Totali	7,114,212	150,316,639	157,430,851	124,22,420	33,198,431

Burimi: Bashkia Shijak

Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për investimet:

Nr.	Emërtimi i Objektivit të Prokurimit	Emërtimi i Subjektit Kreditor	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Vlera e faturës	Shlyerjet para vitit 2022	Shlyerjet gjatë vitit 2022	Vlera e detyrimit me 31.12.2022
1	Rehabilitimi i Rrugës Lagjia Rrubjeke Nj.Ad Maminas	AL-A. shpk.	01.06.2021	Nr 88 date 04.10.2021	59,043,360	11,108,057	20,000,000	27,935,303
	Totali i detyrimit				59,043,360	11,108,057	20,000,000	27,935,303

Burimi: Bashkia Shijak

Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për mallra dhe shërbime

Nr.	Emërtimi i i Objektivit të Prokurimit	Emërtimi i Subjektit Kreditor	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Vlera e faturës	Shlyerjet para vitit 2022	Shlyerjet gjatë vitit 2022	Vlera e detyrimit me 31.12.2022
1	Tvsh per UNDP	S.C shpk	Nr 2112 date 14.04.2022.	38 Date 20.4.2022	338,679	0	0	338,679
2	Blerje Ushqime	M.K	Nr 1317/2 date 07.03.2022	Nr 107 date 28.12.2022	99,492	0	0	99,492

3	Blerje Ushqime	M.K	Nr 1317/2 date 07.03.2022	Nr 108 date 28.12.2022	97,002	0	59,845	37,157
	Totali i detyrimit				535,173		59,845	475,328

Burimi: Bashkia Shijak

Lista e vendimeve gjyqësore për pagesat e kryera për zbatimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna për vitin 2022:

Nr.	Emër mbiemër i paditësit	Objekti padisë	Nr. dhe data vendimit të Gj. Apelit	Vlera në lekë e dëmshpërblimit, sipas vendimit të Gjykatës së Apelit	Vlera e detyrimit në 31.12.2021	Shtesat gjatë vitit 2022	Shlyerjet gjatë vitit 2022	Vlera e detyrimit me 31.12.2022
1	M.D	Largim nga puna	Apel nr 3235 dt 17/12/2019		3,282,948		895,148	2,387,800
2	F.Sh	Largim nga puna	Apel nr 1668 date 30.05.2019		514,648		514,648	0
3	P.C	Largim nga puna	Apel nr 1374 dt 20/05/2019		3,316,616		916,616	2,400,000
	Shuma totale				7,114,212		2,326,412	4,787,800

Burimi: Bashkia Shijak

Titulli i gjetjes: Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Situata: Nga auditimi u konstatohet se Bashkia Shijak në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 7,114,213 lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Por gjatë vitit 2022 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 28,410,631 lekë, duke e çuar në datë 31.12.2022 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 33,198,431 lekë. Peshën kryesore të detyrimeve e zënë ato për investime në vlerën 27,935,303 lekë, ose në masën 84% të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta.

Pra, në datën 31.12.2022 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, Shijaku ka krijuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022), është rritur me 26,804,219 lekë, ose në masën prej 476%.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012, datë 07.12.2012, dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 gërma “c” dhe “ç”, Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 153-162 “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve

publike”.

Ndikimi/Efekti: Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura përkeqson situatën financiare të institucionit dhe ndikon në fondet të cilat janë parashikuar sipas PBA për investimet e reja.

Shkaku: Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Në mënyrë që Bashkia Shijak mos të përballet me probleme financiare duhet të ketë menaxhim sa më efektiv të investimeve dhe duhet të ketë gjithmonë në konsideratë likuiditetin për mos të marrë angazhime buxhetore të reja pa shlyer detyrimet e prapambetura.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z.E.A me detyrë Kryetar e Bashkisë Shijak dhe Znj.P.A me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike.

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZSHH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Tabela e parashikimit të projekteve sipas projekt buxhetit të vitit 2022

Në mijë lekë

PBA	Nr i Projekteve nga të AV	Vlera	Nr i Projekteve nga QQ/FZHR	Vlera	Totali
2022-2024	13	131,878	5	1,196,401	1,328,279

Punoi: Grupi i auditimit

- Nga FZHR për vitin 2022 janë investuar 7,282,000 lekë;
- Nga AKUM për vitin janë investuar 123,356,000 lekë.
- Nga të ardhurat e veta Bashkia ka përdorur vetëm vlerën 48,187,000 lekë në krahasim me vlerën e parashikuar 131,878,000 lekë në buxhet kjo pjesëmarrje në këtë nivel të ulët vjen nga mos realizmi i të ardhurave nga taksat/tarifat vendore.

Burimi i krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor dhe përdorimi i tyre:

- Për vitin 2022 të ardhurat nga 337,539,000 mijë lekë janë arkëtuar 193,628,000 mijë lekë ose 69%.

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Totali	Burimi i financimit			Fonde të deleguara	FZHR	AKUM
			Transferta pakushtëzuar	Transferta Specifike	Të Ardhura te veta			
2022	Investimet	292,172	73,719		48,187	39,876	7,282	123,108

Burimi: Bashkia Shijak

- Me të ardhurat e veta, për vitin 2022 bashkia ka mbuluar 16.4% të totalit të investimeve;
- Për vitin 2022 bashkia ka mbuluar 54% të totalit të shpenzimeve.

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Totali	Burimi i financimit			Fonde të deleguara	FZHR	AKUM
			Transferta pakushtëzuar	Transferta Specifike	Të Ardhura te veta			
2022	Shpenzime Operative	158,398	42,13	30,011	86,274			

Burimi: Bashkia Shijak

2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Në zbatim të pikës së mësipërme të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë

- Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022.
- Rregjistri i taksapaguesve privat dhe familjar.
- Rakordimet me agjentët tatimor.
- Evidenca e planifikimit të të ardhurave.
- Aktet e rakordimit me degën e thesarit për të ardhurat.
- Regjistrat e subjekteve debitorë në 31.12.2022.
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, në lidhje me çështjen e të ardhurave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

➤ **Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

Në Bashkinë Shijak, për vitin 2022 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.156, datë 01.06.2022 ku përfshihet edhe struktura e Sektori i taksave dhe tarifave vendore. Ky sektor përbëhet nga 7 punonjës, konkretisht: 1 përgjegjës, 1 specialist dhe 5 inspektorë. Struktura e Drejtorisë të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022 është paraqitur në **Pasqyrat A1** në Aneksat bashkëlidhur.

➤ **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve**

Titulli i gjetjes: Performancë e dobët në planifikimin dhe realizimin e disa zërave të të ardhurave për periudhën objekt auditimi.

Situata:

Referuar planit vjetor të miratuar dhe akt akordimeve me Degën e Thesarit Durrës, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitin 2022 paraqitet i detajuar në **Pasqyrën A4** në Aneksat bashkëlidhur.

Nga të dhënat e **Pasqyrës A4**, konstatohet se për vitin 2022, të ardhurat nga 319,731,000 lekë të planifikuara janë realizuar në shumën 193,627,000 lekë ose 61%, pra me një mosrealizim në shumën prej 126,104,000 lekë. Kryesisht, ky mosrealizim përbëhet nga deficit i krijuar nga:

Taksa e ndërtesës:	- 2,100,000 lekë
Taksa e tokës bujqësore:	- 10,069,000 lekë
Taksa e ndikimit në infrastrukturë:	- 75,474,000 lekë
Tarifa e pastrimit:	- 23,443,000 lekë

Totali i mosrealizimit për vitin 2022 është 126,104,000 lekë.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Shijak, që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalmimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale, për të mos shkaktuar deficit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve, etj., në dëm të interesave të publikut.

Për sa më sipër përgjegjësia është e Z.E.A Kryetar i Bashkisë Shijak, e Znj. S.B, përgjegjëse e sektorit të të ardhurave si dhe e Znj.E.T, specialiste e sektorit të të ardhurave.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë”; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 42, “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, “Raportimi financiar” nënpika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos planifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave shkakton mangësi dhe probleme në likuidimin e shpenzimeve të kryera nga institucioni, si dhe është shkak kryesor për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Shkaku: Mosnjohja e situatës nga strukturat përgjegjëse, neglizhenca dhe mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Shijak, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit të për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm ,për mos të pasur nivel të ulët të realizimit të të ardhurave.

Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2022

Titulli i gjetjes: Nga auditimi i të dhënave,rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve progresive për periudhën 2011-2022 për familjar dhe 2016-2022 për subjektet juridike janë krijuar debitorë në vlerën 439,000,047 lekë.

Situata: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Shijak nuk ka lidhur kontratë me Ndërmarrjen e Ujësjetës Kanalizimeve Shijak për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësitë e mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime.

Me VKB nr. 121 datë 24.12.2021, bashkia Shijak ka miratuar pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura të taksave dhe tarifave vendore. Ky vendim ka pasur si qëllim ndihmën për familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare për pagesën e menjëhershme të këtyre detyrimeve.

Nga grupi i auditimit sipas regjistrave të vendosur në dispozicion nga Bashkia Shijak u nxorën

shumat debitore për taksat dhe tarifata vendore për familjarët dhe biznesin sipas llojit të tyre. Vlera prej **96,188,924 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës deri në datën 31.12.2022. Vetëm për vitin 2022 vlera e detyrimeve të pa arkëtuara për taksën e ndërtesës është 16,182,770 lekë (**Pasqyra A11**, në anekset bashkëlidhur).

Vlera prej **106,950,267 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i tarifës së pastrimit deri në datën 31.12.2022. Vetëm për vitin 2022 vlera e detyrimeve të pa arkëtuara për taksën e pastrimit është 23,984,000 lekë (**Pasqyra A11**, në anekset bashkëlidhur).

Vlera prej **7,025,445 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i tarifës së ndriçimit deri në datën 31.12.2022. Vetëm për vitin 2022 vlera e detyrimeve të pa arkëtuara për taksën e ndriçimit është 472,800 lekë (**Pasqyra A11**, në anekset bashkëlidhur).

Vlera prej **809,060 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i tarifës së truallit deri në datën 31.12.2022. Vetëm për vitin 2022 vlera e detyrimeve të pa arkëtuara për taksën e truallit është 235,775 lekë (**Pasqyra A11**, në anekset bashkëlidhur).

Nga auditimi, u konstatua se me ligjin 7501 “Për tokën”, janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 5,171 familje për sipërfaqen toke prej 5,452 hektarë, për të cilat është planifikuar pagesa e taksës së tokës. Sipërfaqja e tokës dhe numri i familjeve të trajtuara me tokë nga ligji 7501, etj., sipas njësive administrative, në hektarë është paraqitur në (**Pasqyrën A9** në anekset bashkëlidhur).

Vlera prej **134,251,162 lekë** lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i taksës së tokës bujqësore (**Pasqyra A12**, në anekset bashkëlidhur).

Nga verifikimi i regjistrit të taksave nga grupi i auditimit u analizua se vlera e debitorëve biznes për periudhën 2016-2022 është në vlerën **93,775,189 lekë** e cila përfaqëson taksat dhe tarifata vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Shijak. Vetëm për vitin 2022 vlera e detyrimeve të pa arkëtuara për taksat e biznesit është 27,241,731 lekë. Vlera e debitorëve e ndarë sipas viteve dhe sipas llojit të taksës gjendje në fund të vitit ushtrimor është paraqitur në (**Pasqyrën A8**, në anekset bashkëlidhur).

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 70 dhe 117, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, etj.

Ndikimi/Efekti: Kanë ndikuar në nivelin e të ardhurave në vlerën debitore prej **439,000,047 lekë**, nga mos pagesa e taksave dhe tarifave vendore për debitorët familjar dhe biznes, të cilat sjellin të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Shijak.

Shkaku: Ka munguar përditësimi i të dhënave të regjistrave përkatës, niveli ekonomik i familjeve, mungesa e strategjive për vjeljen e detyrimeve nga administrata, mungesa e kontratës me UK sha si agjent tatimor, etj.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Shijak, Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifata vendore deri më datën 31.12.2022, në vlerën totale

439,000,047 lekë, e cila përbëhet nga:

-**96,188,924** lekë detyrime për taksën e ndërtesës

-**106,950,267** lekë detyrime për taksën e pastrimit

-**7,025,445** lekë detyrime për tarifën e ndriçimit

- **809,060** lekë detyrime për tarifën e truallit

-**134,251,162** lekë detyrime për taksën e tokës bujqësore

-**93,775,189** lekë detyrime nga taksat e biznesit

a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. Drejtoria e të Ardhurave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Shijak, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarrë për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Rekomandimi: Bashkia Shijak, të marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Shijak Sh.A., për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak sipas legjislacionit në fuqi, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

Titulli i gjetjes: Të ardhura të munguara nga pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara.

Situata: Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, Bashkia Shijak për vitin 2022 nuk ka korrespondencë shkresore me ish-ALUIZNI-in, Drejtoria Durrës dhe të dhënat për lejet e legalizimit të përfituara nga individë dhe subjekte private, të disponueshme në Bashkinë Shijak.

Për vitin 2020 shuma 1,643,000 lekë është e pa u faturuar dhe arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Shijak sipas **Pasqyrës A6**, në Anekset bashkëlidhur.

Për vitin 2021 shuma 518,000 lekë është e pa u faturuar dhe arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Shijak sipas **Pasqyrës A6**, në Anekset bashkëlidhur.

Kriteri: Ligji nr. 9482 datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 4, 5, 9 dhe 27; VKB Shijak “Për miratimin e taksave dhe tarifave

vendore në territorin e Bashkisë Shijak”, etj.

Ndikimi/Efekti: Ndikim negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, në vlerën **2,161,311 lekë**, nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit nga përfituesit lejes së legalizimit.

Shkaku: Mos bashkëpunimi i fortë me ASHK-në dhe mos marrja e masave të duhura për parandalimin e dhënies së lejeve të legalizimit pa paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë pranë Bashkisë Shijak nga subjektet private dhe individët për objektet në proces legalizimi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Shijak, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në **vlerën 2,161,311 lekë**.

Rekomandimi: Bashkia Shijak, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban për personat të cilët nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje, t'i kërkojë Drejtorisë Rajonale ASHK Durrës vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë deri në kryerjen e pagesës së kësaj takse.

Rekomandimi: Bashkia Shijak, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të vazhdojë korrespondencën zyrtare me ASHK Durrës në lidhje me situatën debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për vitin 2022.

➤ **Pajisja me NUIS sekondare e Operatorëve Ekonomikë të cilët kryejnë veprimtari biznesi në Bashkinë Shijak:**

Titulli i Gjetjes: Parregullsi në procedurat e kryera për menaxhimin e të ardhurave nga taksa e lëshimit të lejeve me NUIS /sekondare e Operatorëve Ekonomikë.

Situata: Bazuar në dokumentet e paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit Shërbimeve dhe infrastrukturës Publike, konstatohet se për vitin 2022 kanë zhvilluar aktivitetet në fushën e ndërtimit dhe janë pajisur me Leje Ndërtimi nga Bashkia Shijak 27 subjekte.

Nga DTTV Bashkia Shijak është vepruar për ngarkimin në bazën e të dhënave, faturimin apo nxjerrjen e njoftim detyrimit për tarifën vendore (pastrim, gjelbërim, ndriçim, etj.) për 16 subjekte ndërtimi që janë pajisur me “Leje Ndërtimi” mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet të veprimtarive të objekteve, etj.

Për periudhën 2022 në 11 raste subjektsh me aktivitet ndërtimi të pajisura me “Leje ndërtimi”, mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet e veprimtarive të objekteve, nuk janë ngarkuar dhe nuk janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit dhe *nuk janë arkëtuar, te ardhurat për 11 raste në vlerën 957,000 lekë duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Shijak.*

Operatorët ekonomikë të cilët kanë kryer veprimtari biznesi në Bashkinë Shijak, pa hapur NUIS-e sekondare dhe shuma e debisë së tyre (për investime të Bashkisë Shijak), janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën A9**, në Aneksët bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Për periudhën 2022, bazuar në dokumentet dhe evidencat e paraqitura nga Drejtoria Ekonomike, Sektori i Buxhetit dhe Financës, rezulton se janë kryer investime, ku operatorët ekonomikë fitues të procedurave të prokurimit janë subjekte me aktivitet ndërtimi, të cilat kanë kryer punime ndërtimi me fondet e buxhetit të shtetit, me fonde të zhvillimit të rajoneve dhe me fonde nga të ardhurat e veta të Bashkisë dhe për 2 subjekte nuk janë ngarkuar dhe nuk janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastri-gjelbërim-ndriçimit dhe *nuk janë arkëtuar, te ardhurat për 2 raste ne vlerën 174,000 lekë duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Shijak.*

Operatorët ekonomikë të cilët kryejnë veprimtari biznesi në Bashkinë Shijak, për investime të Bashkisë Shijak dhe pagesat e kryera prej tyre janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën A10**, në Anekset bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Kriteri: Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” neni 40, “Regjistrimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jo tregtare”, pika 1, ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, ligji nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, neni 22 “Detyrimi për regjistrim”, pika 4, neni 43 “Përditësimi i të dhënave të regjistrimit” pika 1/1.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, në vlerën **1,131,000 lekë** nga moskryerja e njoftimeve për detyrimet përkatëse.

Shkaku: Sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka bashkëpunuar mjaftueshëm me sektorët e tjerë, ose private, të cilët nuk kanë hapur adresa/nipete sekondare në territorin e Bashkisë Shijakut, nuk ka kryer njoftimet për detyrimet përkatëse të këtyre subjekteve, duke shkaktuar mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Shijak në vlerën **1,131,000 lekë**.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Shijak të saktësojë listat e bizneseve të ndërtimit që kanë qenë zbatuese të lejeve të ndërtimit dhe të projekteve të investimeve të prokurara për vitin 2022, pavarësisht nëse kanë selinë kryesore jashtë territorit të Bashkisë Shijak dhe që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, të nxjerrin njoftim detyrimet për taksat dhe tarifave vendore për subjektet e listuara në Anekset bashkëlidhur, si dhe të ndjekin të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës totale **1,131,000 lekë** nga këto detyrime vendore.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Titulli i gjetjes: Parregullsi në procedurat e kryera për menaxhimin e të ardhurave nga taksa e lëshimit të Autorizimeve/Liçencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, Bashkia Shijak.

Situata: Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Shijak ushtrojnë aktivitetin 26 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Subjekte të liçencuar për tregtimin e lëndëve djegëse janë dy, “K. Shpk” dhe “I. Shpk”.

Sa më sipër bazuar në Ligjin nr. 8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM-në nr. 970 datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, subjektet që kanë paraqitur kërkesat për marrjen e liçencave, i është kërkuar nga ana e komisionit për shqyrtimin e liçencave, pranë Bashkisë Shijak, plotësimi i dokumentacionit të plotë dhe të noterizuar brenda afatit 45 (dyzet e pesë) ditor, sipas VKM-së të sipërpërmendur.

Gjithashtu nga Bashkia Shijak është bërë me dije nga zyra juridike Shijak se: “Në rast se personi

juridik nuk ri paraqet dokumentacionin e kërkuar, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, autoriteti liçencues në përputhje me parashikimet ligjore ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për bllokimin e aktivitetit tregtar, deri në ri paraqitjen e dokumentacionit të plotë nga ana e personit juridik, për pajisjen e tij me liçencë për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë”, pika 6.1 Kreu II i VKM-së nr. 970 datë 02.12.2015.

Duke qenë se asnjë nga subjektet që kanë paraqitur kërkesë nuk ka plotësuar brenda afatit, dokumentacionin e nevojshëm, asnjë nga këto subjekte nuk është liçencuar, nga ana e Bashkisë Shijak, për mungesë dokumentacioni nga ana e tyre. Për periudhën e auditimit janë dhënë 2 liçenca.

Vlera prej 24,000,000 lekë, e cila nuk është paguar nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Shijak, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak.

Të dhënat për shoqëritë që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën A11**, në Aneksët bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Kriteri: Kjo procedurë është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa “b”, pikat 9, 15.1 dhe 15.2.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, në vlerën 24,000,000 lekë nga mospagesa e tarifës së plotë apo të një pjese të tarifës së liçencës/autorizimit nga subjektet që ushtrojnë aktivitetin e shitjes me pakicë të hidrokarbureve pa rinovuar liçencën e tregtimit.

Shkaku: Mos ndjekja e procedurave në bashkëpunim me institucionet përkatëse për mbylljen e aktivitetit të subjekteve që nuk rinovojnë liçencën.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Shijak, nëpërmjet Drejtorisë së Ardhurave Vendore dhe komisionit të ngritur për liçensimin e subjekteve të karburanteve të marrë masa që për 24 subjekte debitorë të arkëtojnë tarifën e plota, për diferencën debitorë prej 24,000,000 lekë, detyrim ky për paisjen me autorizim/liçensa për tregtimin me pakicë të karburanteve dhe gazit të lëngshëm vajrave lubrifikante për automjetet. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për pagesën e tarifës së liçencës/autorizimit, Bashkia Shijak në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik Industrial të ndërmarrin veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare të vitit 2022.

➤ Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare 2022

Në fund të periudhës ushtrimore, bilanci është plotësuar sipas formateve standard të miratuara me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Bilanci i vitit 2022 është përgatitur nga Znj.P.A, me detyrë drejtor i drejtorisë ekonomike dhe Nëpunës Zbatues, është konfirmuar nga Kryetari i Bashkisë Shijak, Z.E.A, në cilësinë e Nëpunësit

Autorizues, si dhe është depozituar dhe miratuar nga dega e thesarit Durrës në datën 28.03.2022 dhe numër protokollit 1708, brenda limiteve të përcaktuara me ligj.

Veprimet kontabile janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh, dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur rregullisht ditarët e arkës, bankës, magazinës dhe veprimeve të ndryshme.

Janë mbajtur dhe përditësuar rregullisht ditarët analitikë të të gjitha llogarive, përfshirë llogaritë inventariale të magazinës, për të cilat është bërë rakordimi llogari-magazinë.

Janë përgatitur formatet e mëposhtëm:

- Format 1: Pasqyra e pozicionit financiar;
- Format 2: Pasqyra e performancës financiare;
- Format 3: Pasqyra e flukseve monetare;
- Format 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Format 5: Pyetësor me shënimet shpjeguese;

Pasqyrat statistikore:

- Format 6: Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre;
- Format 7, a dhe b: - Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b);
- Format 8: Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Oasja dhe metodologjia e auditimit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruar nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2022 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit **10,424,000 lekë** për shpenzimet dhe **30,784,521 lekë** për të ardhurat, sipas sipas **Aneksit PF1**, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

➤ Mbi vlerësimin e riskut:

Nga grupi i auditimit janë ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.

Më poshtë po citojmë disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:

- Kontrolli i brendshëm:

Kontrolli i brendshëm në Bashkinë Shijak nuk ka funksionuar i plotë, nuk përfshin gjithë veprimtarinë e njësisë ekonomike, si rrjedhim nuk ndihmon në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësisë ekonomike nuk mund ta dijë ku mund të ndodhin parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për ti siguruar menaxherët se pasuria e njësisë është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.

- Konfirmimet nga të tretët:

Subjekti që auditohet ka të konfirmuara (rakorduara) me të tretët (me degën e thesarit) informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

- Transaksionet:

Janë kryer transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhën e fundit të vitit ushtrimor.

Nisur nga ky fakt, bazuar në vlerën e materialitetit të përllogaritur (10,424,000) u filtruan të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës mbi këtë vlerë për muajin dhjetor 2022, në vlerën 291,169,414.

Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; Dokumentet autorizues, Dokumentet vërtetues, Dokumentet e kontabilitetit, etj.

➤ **Teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:**

1. Kontrolli aritmetik:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmimi nga të tretët:

Subjekti që auditohet i ka të konfirmuara (rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabile. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, etj.*

➤ **Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2022:**

Mbajtja e kontabilitetit:

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

Hartimi i pasqyrave financiare është bazuar në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 “*Paraqitja e Pasqyrave Financiare*”), të përcaktuara në ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, si dhe në UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme*”; nenit 3 dhe 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “*Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, etj.

Nuk ka patur komunikim me MFE për aspekte të trajtimeve kontabile, apo mbyllje vjetore.

Bilanci kontabël:

Bilanci i hartuar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të Bashkisë Shijak në fund të periudhës kontabël, për vitin ushtrimor 2022.

Bilanci kontabël është ndërtuar nga tre pjesë: Aktivët, Detyrimet dhe Kapitali.

Klasifikimi i elementeve të mësipërm në nëngrupe dhe paraqitja e bilancit është bërë bazuar në parimin e materialitetit për të siguruar pamjen e vërtetë dhe të sinqertë të situatës financiare.

Kjo situatë financiare në bilancin kontabël paraqitet e krahasuar me atë të periudhës paraardhëse dhe përmban kolonat me shumat për periudhat përkatëse.

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit.

Në Bashkinë Shijak nuk ka njësi varësie, të cilat të funksionojnë si njësi shpenzuese të pavarura, pra, nuk ka pasqyra financiare të konsoliduara.

Në Bashkinë Shijak, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, në programin kompjuterik Exel, gjë e cila paraqet risk të lartë përse i përket sigurisë dhe saktësisë së informacionit të paraqitur nëpërmjet pasqyrave financiare.

Nga auditimi, u konstatua se në bilanc, totali i Aktivit është i barabartë me totalin e Pasivit, në vlerën 3,972,609,583 lekë.

Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Shijak në 31.12.2022, sipas formatit F1, është paraqitur në Aneksin PF2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit. Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2021, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivit dhe të pasivit.

➤ **AKTIVET**

Nga auditimi, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF të Bashkisë Shijak, vlera është 3,972,609,583 lekë, e cila përbëhet nga Aktivët Qarkulluese/Afatshkurtra, në vlerën 526,228,417 lekë dhe Aktivët Afatgjata në vlerën 3,446,381,166 lekë.

I. Aktivët Afatshkurtra

Nga auditimi, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF të Bashkisë Shijak, vlera është 3,972,609,583 lekë. Në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra, vlera është 526,228,417 lekë. Llogaria 520 “*Disponibilitete në Thesar*”, ka vlerën 297,101,032 lekë.

1. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre:

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre janë detajuar në Aneksin PF3, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga Aneksi PF3, konstatohet se kjo llogari ka pësuar një rritje me 1,218,238 lekë. Nga verifikimi i zërave të bilancit, u konstatua se kjo llogari kuadraton me shumën e llogarive përkatëse 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, 85 “Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit” dhe 12 “Rezultatet e mbartura”, ndërsa llogaria 12 “Rezultatet e mbartura”, e cila rezulton e rregjistruar në bilanc me vlerën (3,500,000) lekë është rregjistruar në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kap 3 “Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njërive të vetë qeverisjes vendore”, pika 44.

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”, në datën 31.12.2022 ka qenë 297,101,032 lekë, me një rritje prej 10,580,875 lekë nga viti ushtrimor paraardhës. Kjo vlerë sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, është e analizuar në Aneksin PF4, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Llogaritë e Klasës 5 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Nga auditimi i ditarit të bankës, u konstatua se në debi të llogarisë 520 janë paraqitur gjithsej 826 transaksione, për vlerën totale **1,596,596,798 lekë**, ndërkohë që planifikimi ka qenë për vlerën totale **1,563,495,700 lekë** sipas sipas Aneksit PF5, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga auditimi, u konstatua se është realizuar 102% e planit vjetor të shpenzimeve.

2. Gjendje Inventari qarkullues:

Llogaritë e inventareve paraqiten në vlerën totale 55,907,689 lekë, me një rritje prej 5,908,964 lekë nga viti ushtrimor paraardhës, të cilat janë analizuar në vijim.

Llogaria 31 “Materiale”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën 8,324,323 lekë, me një rritje prej 3,862,853 lekë nga viti ushtrimor paraardhës, ndërsa llogaria 32 “Inventar i imët”, paraqitet në vlerën 47,583,366 lekë, me një rritje prej 2,046,111 lekë nga viti ushtrimor paraardhës. Këto rritje janë si rezultat i shtesave të materialeve gjatë vitit. Nga rakordimi i listave bashkëlidhur urdhërit përkatës për inventarizimet, me kontabilitetin dhe Pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të Aktiveve të Qëndrueshme, nuk rezultuan diferenca përse i përket llogarisë 32 “Inventar i imët” dhe llogarisë 31 “Materiale”.

3. Llogaritë e arkëtueshme:

Llogaritë e arkëtueshme paraqiten në vlerën totale 136,282,865 lekë, me një zbritje prej 6,103,118 lekë nga viti ushtrimor paraardhës, të cilat janë analizuar në vijim.

Vlerat e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat e paraqitura në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën debitore 124,850,012 lekë. Nga analiza, rezultoi se për vitin 2022 kjo llogari është ulur në vlerën 120,220,012 lekë, me një ulje neto në vlerën 4,630,000 lekë, shumë e konstatuar nga debitorët për pagesat e tarifave të popullatës dhe biznesit.

Kjo llogari përbëhet nga detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore, detyrime për pagesën e tarifave të popullatës dhe detyrime të lëna nga aktet e kontrolleve të ndryshme të paguara deri në 31.12.2022.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” kjo llogari nuk paraqit gjendjen reale të debitorëve në Bashkinë Shijak. Nga grupi i auditimit për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 u konstatua se gjendja e debitorëve sipas rregjistrave të debitorëve është në vlerën 439,000,047 lekë.

Në mënyrë analitike kjo llogari vetëm për debitorët biznes të raportur në bilanc është paraqitur e detajuar në **Aneksin PF6**, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Për vlerën e pa arkëtuar, Bashkia Shijak është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115 të Kodit Civil në R.SH dhe nenit 203 të Kodit Punës në R.SH (prej 3 vjetësh) apo të parashkrimit të vendimeve (vlerave) të gjobave përcaktuar në nenin 46 të ligjit “Për kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 vjetësh), sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.

Nga auditimi i të ardhurave dhe debitorëve nga taksat dhe tatimet, u konstatua se vlerat debitore të familjarëve, bizneseve, janë kontabilizuar nuk janë kontabilizuar sipas rregjistrave të debitorëve për bizneset dhe individët.

Titulli i gjetjes: Parregullsi dhe mangësi në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2022.

Situata: Nga auditimi i llogarisë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Shijak për arkëtim ndaj të tretëve, nuk është pasqyruar saktë, sepse kjo llogari është pasqyruar më pak për vlerën 318,780,035 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, për vlerën prej:

Popullata:

- Taksë ndërtese në vlerën 96,188,924 lekë
- Taksë pastrimi në vlerën 106,950,267 lekë
- Taksë ndriçimi në vlerën 7,025,445 lekë
- Taksë toke në vlerën 134,251,162 lekë
- Taksë trualli në vlerën 809,060 lekë

Biznes:

- Taksë ndërtese në vlerën 51,466,534 lekë
- Taksë trualli në vlerën 7,481,373 lekë
- Taksë tabele në vlerën 2,870,548 lekë
- Taksë pastrimi në vlerën 31,254,192 lekë
- Taksë ndriçimi në vlerën 702,542 lekë

Kriteri: Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12 pika 3 shkronjën “ë”, i ndryshuar; rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c” në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitet e qeverisjes së përgjithshme”.

Ndikimi/Efekt: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me llogarinë e debitorëve 468.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Shijak, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në

llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 475 “Të ardhura për t’u rregjistrua në vitet paraardhëse”.

Llogaria 4342 “**Operacione me shtetin (të drejta)**”, në fund të vitit ushtrimor 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 16,062,853 lekë, e cila përbëhet nga shuma e llogarive 42 “Detyrimet ndaj personelit” në vlerën 12,322,033 lekë, llog. 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 973,736 lekë, llog. 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 4,194,822 lekë. Nga auditimi u konstatuan diferenca midis vlerave të pasqyruara në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruar në llogaritë e pasivit në vlerën 1,427,738 lekë. Pra, vlera e kësaj llogarie në bilanc nuk është pasqyruar në mënyrë të drejtë në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar. Gjithashtu në fund të periudhës në momentin e mbylljes së pasqyrave financiare sipas udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 “Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” llogaria 4342 “Operacione me Shtetin (të drejta) për vlerën 1,427,738 lekë nuk rakordojë më llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga Buxheti”. Llogaria 4342 është rregjistrua në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap.3 “Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njëjësive të vetë qeverisjes vendore”, pika 59.

4. Të tjera aktive afatshkurtra

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën 33,198,431 lekë. Nga analiza, rezultoi se kjo llogari është rritur për vlerën 26,084,219 lekë.

Detyrimet e Bashkisë Shijak, sipas natyrës janë paraqitur në **Aneksin PF7**, bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Analiza e detajuar e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, është paraqitur në **Pasqyrën PF8**, në Aneksin bashkëlidhur.

Përsa i përket detyrimeve të prapambetura, nga pasqyra e mësipërme vërehet se Bashkia Shijak nuk është e angazhuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Sipas udhëzimit nr 5 datë 21.02.2022 kjo është llogari rregulluese dhe nuk duhet të paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar. Detyrimet e prapambetura duhet të paraqiten tek llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta”.

Titulli i gjetjes: Parregullsi dhe mangësi në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2022.

Situata: Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën 33,198,431 lekë.

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” sipas udhëzimit nr 5 datë 21.02.2022 citon: “Rregjistrimet e thesarit në llogarinë 486 nuk janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar që prodhohet nga SIQF në nivel njësie shpenzuese, ose njësie publike qendrore ose vendore për efekt rakordimi me këto të fundit”. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përpara mbylljes së llogarive vjetore të vitit, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë 4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura” në debi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këto llogari.

Kriteri: UMF nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e ministrit të financave dhe ekonomisë nr.8 datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes ,paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 15.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare të Bashkisë Shijak.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Shijak, të marrë masa që detyrimet e prapambetura përkatësisht llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe llogaritë 401-408 “Furnitor dhe llogari të lidhura me to” të rregjistrohen me kundërpartit llogarinë 4342 “Operacione me shtetin të drejta”.

II. Aktivet Afatgjata

1. Aktivet afatgjata jomateriale:

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive jo materiale afatgjata sipas UMF nr. 8, datë 9.03.2018 përfshin prime të emisionit dhe rimbursimit të huave, studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca dhe të ngjashme.

Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar. Përfshirja e tepricave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit në **Aneksin PF9**, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga auditimi, u konstatua se Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” në Bashkinë Shijak në datën 31.12.2022 përbëhet nga 16 studime e projekte në vlerën 61,651,348 lekë, të cilat i përkasin investimeve nga të ardhurat e veta të Bashkisë Shijak.

Për vitin 2022 Bashkia Shijak nuk ka realizuar investime për blerje projektesh.

Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike, u konstatua se disponohen gjithsej 139 projekte dhe studime, të cilat janë të pakontabilizuara, sipas **Listës Nr. 1**, në Anekset bashkëlidhur. Këto projekte dhe studime janë hartuar në vite, edhe përpara periudhës së konsolidimit të pushtetit vendor.

Për sa më sipër, llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*”, nuk paraqet gjendjen e vërtetë.

Titulli i gjetjes: Mangësi në kontabilizimin e aktiveve afatgjata jomateriale në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për periudhën e audituar.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” në Bashkinë Shijak në datën 31.12.2022 përbëhet nga 16 studime e projekte në vlerën 61,651,348 lekë, të cilat i përkasin investimeve nga të ardhurat e veta të Bashkisë Shijak.

Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike, u konstatua se disponohen gjithsej 139 projekte dhe studime, të cilat janë të pakontabilizuara, sipas **Listës Nr. 1**, në Anekset bashkëlidhur. Këto projekte dhe studime janë hartuar në vite, edhe përpara periudhës së konsolidimit të pushtetit vendor.

Për sa më sipër, llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*”, nuk paraqet gjendjen e vërtetë.

Kriteri: UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Standarti Kombëtar Kontabël nr.5 “Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale” pikat 47-56.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve të Bashkisë Shijak.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Shijak, të marrë masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet të llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime AAJM*” për investimet të cilat kanë mbaruar dhe janë kontabilizuar atëhere dhe vlera e projekteve duhet ti shtohen vlerës së aktivitetit.

2. Aktivët afatgjatë materiale:

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive materiale afatgjatë sipas SKK 5, i përmirësuar.

Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar. Përfshirja e tepërcave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit:

Vlera e kësaj nënrubrike është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

Shtesat në këtë nënrubrikë përfaqësojnë vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstruksione dhe shtesat gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit.

Shtesat në këtë nënrubrikë përfaqësojnë vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstruksione dhe shtesat gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit.

Nga auditimi i dokumentacionit të disponueshëm në Bashkinë Shijak, u konstatua se nuk janë zbatuar dispozitat e VKM-së nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*”. Në Bashkinë Shijak nuk disponohet asnjë dokument në lidhje me pasuritë publike të transferuara në vite me VKM të posaçme në komunat të cilat sot janë pjesë e Bashkisë Shijak dhe nuk është bërë asnjë regjistrim i pasurive publike të cilat tashmë i përkasin Bashkisë Shijak.

Detajet e nënrubrikës Aktive Materiale Afatgjatë janë paraqitur në **Aneksin PF11**, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

1. Gjendja e llogarisë 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 24,806,885 lekë dhe në datën 31.12.2022 paraqitet në vlerën 24,806,885. Kjo llogari nuk ka pasur ndryshime për vitin 2022.

Nga auditimi ka rezultuar se, nga këto objekte, asnjë prej tyre nuk është pajisur me titull pronësie dhe asnjë prej tyre nuk është në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme*”, Kreu VI “*Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme*”.

Detajet e kësaj llogarie janë paraqitur në **Aneksin PF12**, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

2. Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 për 4,830,000 lekë. Edhe sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 4,830,000 lekë. Kjo vlerë përfshin vetëm një pasuri në NJA Xhafzotaj.

Nga auditimi ka rezultuar se, nga këto objekte, asnjë prej tyre nuk është pajisur me titull pronësie dhe asnjë prej tyre nuk është në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”.

3. Gjendja e llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione” në datën 31.12.2021, e cila pasqyron gjendjen e 55 aseteve për Bashkinë Shijak, ka qenë në vlerën 602,126,501 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 1,075,041,000 lekë, me një rritje neto në vlerën 472,914,699 lekë. Kjo diferencë vjen si rrjedhojë e shtesave dhe pakësimeve të vitit, konkretisht: Shtesa të vitit 503,021,024 lekë; Pakësime të vitit: 0 lekë; Pakësim i amortizimit të vitit: 30,106,325 lekë. Kosto historike ka qenë 794,510,597 lekë dhe amortizimi i akumuluar ka qenë 192,384,096 lekë.

Nga auditimi ka rezultuar se, nga këto objekte, asnjë prej tyre nuk është pajisur me titull pronësie dhe asnjë prej tyre nuk është në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”.

Detajet e kësaj llogarie janë paraqitur në **Aneksin PF13**, ndërsa analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Aneksin PF18**, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

4. Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 2,059,475,669 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 2,193,002,964 lekë, me një rritje në vlerën 133,527,295 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit. Detajet e kësaj llogarie janë paraqitur në Aneksin PF15, ndërsa analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Aneksin PF14**, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Për këto zëra të aktivitetit nuk është mbajtur regjistër aktivesh ku të specifikohen datat e hyrjes së aktivitetit, vlera e tyre në hyrje, shpenzimet kapitale, personat që i kanë në dorëzim. Gjithashtu identifikohet problematika e mosbërjes së inventarizimit vjetor të tyre, në kundërshtim me pikat 31 dhe 74 të udhëzimit 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Nga verifikimi i regjistrave, u konstatua se për llogaritë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 215 “Mjete transporti”, paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëparshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kryesisht, këto

probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

5. Gjendja e llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 38,238,077 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 32,658,032 lekë, me ulje në vlerën 5,580,045 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera për instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë për vlerën e amortizimit dhe nxjerrje jashtë përdorimi. Shtesa të vitit: 3,335,662 lekë; Pakësime të vitit: 8,915,707 lekë; Pakësim nga amortizimi i vitit: 7,647,616 lekë. Analiza e llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*” është paraqitur në **Aneksin PF15**, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

6. Gjendja e llogarisë 215 “*Mjete transporti*” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 25,551,222 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 24,273,661 lekë, me ulje në vlerën 1,277,561 lekë. Pakësimet në këtë llogari janë për vlerën e amortizimit dhe nxjerrje jashtë përdorimi ndërsa rritjet janë për blerjet e automjeteve të reja. Shtesa të vitit: 0 lekë; Pakësime të vitit: 0 lekë; Pakësim nga amortizimi i vitit: 1,268,091 lekë. Detajet e kësaj llogarie janë paraqitur në **Aneksin PF16**, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit. Nga auditimi i zërave të veçantë të kësaj llogarie, u konstatua se automjetet në vlerën 8,793,226 lekë, sipas **Aneksit PF17** bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit, nuk janë mjete transporti, por makineri, të cilat duhet të regjistrohen në llogarinë përkatëse, 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”. Rrjedhimisht, llogaritë 215 “*Mjete transporti*” dhe 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”, nuk paraqesin vlerën reale në bilanc. Analiza e llogarisë 215 “*Mjete transporti*” është paraqitur në **Aneksin PF16**, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

7. Gjendja e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 9,974,016 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 7,669,046 lekë, me ulje në vlerën 2,304,970 lekë. Shtesa të vitit: 2,073,151 lekë; Pakësim nga amortizimi i vitit: 2,493,504 lekë. Analiza e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” është paraqitur në **Aneksin PF17**, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Në Bashkinë Shijak inventarizimi është kryer në bazë të urdhërave përkatës të titullarit, sipas të cilëve janë ngritur komisionet për inventarizimin fizik të aktiveve inventarizimi fizik është kryer vetëm për llogaritë 214 (Instalime teknike, makineri e pajisje), 218 (Inventar ekonomik) 31 (Materiale) dhe 32 (Inventar i imët), në zbatim të pikave 73, 74 dhe pika 81 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Këto llogari janë mbajtur në bilancin kontabël pa pasur një analizë të detajuar, ku të përcaktohet origjina e vlerës së aseteve. Nga ana e Drejtorisë së Financës disponohet informacion vetëm për shtesat vjetore të llogarive 210, 211, 212, 213, 214 dhe 215. Gjithashtu, fakti që nuk ka një regjistër kontabël për AAM, e vështirëson më tej njohjen dhe verifikimin e saktësisë së vlerave kontabël të këtyre llogarive.

8. Nga auditimi dhe testimi i Aktiveve Afatgjata Materiale, u konstatua se në regjistrat/librat e kontabilitetit të këtyre llogarive, për një pjesë të konsiderueshme të zërave nuk është pasqyruar vlera fillestare e aktiveve, por vetëm vlera e shpenzimeve të mëparshme, për rikonstruksione ose përmirësimin e gjendjes së këtyre aktiveve. Kryesisht, kjo ka ndodhur për shkak se shumica e këtyre AAM nuk është pajisur me titull pronësie dhe ende nuk janë në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që regjistrimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Gjithashtu, paraqiten

problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëparshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar e amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia, etj. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

9. Për llogaritë 210 “Toka, Troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”, nga Bashkia Shijak nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër tokat, trojet dhe terrenet të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike.

Këto llogari janë mbajtur në bilancin kontabël pa pasur një analizë të detajuar, ku të përcaktohet origjina e vlerës së aseteve. Nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës disponohet informacion vetëm për shtesat vjetore të llogarive 210, 211, 212, 213, 214 dhe 215. Fakti që nuk ka një regjistër kontabël për të gjitha AAM, e vështirëson më tej njohjen dhe verifikimin e saktësisë së vlerave kontabël të këtyre llogarive.

Në kontabilizimin e këtyre aktiveve, nuk është marrë në konsideratë “Njohja fillestare”, por vetëm “Vlerësimi i mëparshëm”, duke mos njohur origjinën e tyre. Mosnjohja e origjinës së aktiveve është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 2, Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, etj.

Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar”; SKK nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35, etj.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve të Bashkisë Shijak.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëparshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Rekomandimi: Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e Urdhërave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “*Toka, troje terrene*”; 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*”; 212 “*Ndërtime e konstruksione*”; 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”; dhe 215 “*Mjete transporti*”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëparshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës.

Situata:

Nga auditimi ka rezultuar se, nga objektet inventari të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 1,104,678,085 lekë, objektet nuk janë pajisur plotësisht me titull pronësie, konkretisht sipas llogarive paraqiten si më poshtë:

-llog 210 “*Toka troje terrene*”, elementë në vlerën neto 24,806,885 lekë

-llog. 211 “*Pyje plantacione*”, elementë në vlerën neto 4,830,000 lekë

-llog. 212 “*Ndërtesa e konstruksione*”, 55 objekte me vlerën neto 1,075,041,200 lekë

-Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor).

Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë.

Kriteri:

- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, ku cilësohet:

“1. Bashkia është subjekti juridik që trashëgon të drejtat e pronësisë, të luajtshme dhe të paluajtshme të Njësive që Shkrihen (NJSH). Nga momenti i konstituimit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive ajo ushtron të drejtën e pronësisë si dhe të drejta të tjera sipas mënyrës të përcaktuar me ligj.

2. NJSH-të duhet të plotësojnë dhe depozitojnë pranë bashkisë inventarin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi. Për pronat e paluajtshme inventari duhet të përmbajë edhe informacionin për fazën e regjistrimit në të cilën ndodhen”.

Ndikimi/Efekti:

Mungesa e titullit të pronësisë:

- është pengesë për kryerjen e transaksioneve të ndryshme me pasuritë e paluajtshme;

- është pengesë për menaxhimin e risqeve dhe mbrojtjen ndaj tyre, pasi mungesa e titullit të pronësisë pengon sigurimin e tyre.

- ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Titull i cili vërteton pronësisë dhe ushtrimin e të drejtave mbi një pasuri të paluajtshme.

Shkaku:

Nga ballafaqimi i problematikës, gjatë auditimit në terren, ka rezultuar se shkaqe të kësaj gjendjeje edhe pas 5 vitesh nga kryerja e këtij procesi janë:

-dokumentacioni i paplotë i trashëguar nga ish-Komunat;

-vështirësia e hasur në plotësimin e dosjeve sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore për regjistrimin e titujve të pronësisë;

-kostoja e kryerjes së këtyre veprimeve në Zyrat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, e cila është e konsiderueshme referuar numrit të objekteve të cilët duhet të regjistrohen.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi: Bashkia Shijak duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të përlllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Titulli i gjetjes: Parregullsi dhe mangësi në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2022.

Situata: Nga auditimi i llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më shumë për vlerën 8,793,226 lekë, si rrjedhojë e kontabilizimit në këtë llogari të disa makinerive, si 1 eskavator, 2 traktor dhe 1 kamion pastrimi, të cilat janë makineri dhe jo mjete transporti, si dhe duhet të klasifikohen në llogarinë nr.214. Për këto makineri duhet të aplikohet normë tjetër amortizimi (5%) dhe jo (20%). Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nomenklaturan e llogarive të planit kontabël publik-instalime teknike, paisje, instrumente dhe vegla pune – llogaria 7-shifrore 2140240-Paisje dhe makineri për konstruksione (ndërtime); 2140260-Paisje pastrimi për rrugët; 2140320-Mjete dhe paisje te tjera teknike.

Kriteri: Nomenklatura e llogarive të planit kontabël publik-instalime teknike, paisje, instrumente dhe vegla pune – llogaria 7-shifrore 2140240-Paisje dhe makineri për konstruksione (ndërtime); 2140260-Paisje pastrimi për rrugët; 2140320-Mjete dhe paisje te tjera teknike.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve të Bashkisë Shijak.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Shijak, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”.

Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Formati nr. 7/b) Viti 2022.

Për vitin 2020, amortizimi i AQT-ve (Llogaria 219 “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”), nuk pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar në bilanc, pasi AQT-të paraqiten me vlerën neto të tyre, por vlerat historike dhe vlerat neto janë paraqitur në formatin 7/a dhe 7/b (gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerë historike dhe vlerë neto). Llogaritja e amortizimit është bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të

ardhurat”, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 3.7 “Amortizimi”, si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2019 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

Nga auditimi i Bilancit, Formati 7, a dhe b: “Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b)”, u konstatua se Amortizimi i Akumuluar në Bashkinë Shijak për Aktivet Afatgjata Materiale në fund të vitit 2021 paraqitet për vlerën 639,580,446 lekë.

Nga PF të disponueshme në sistemin e thesarit, vlera e llogarisë 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”, është 0 lekë.

Amortizimi i aktiveve është llogaritur duke përdorur metodën e vlerës kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhë ushtrimore, shtesën e kostos së blerjes dhe zbritjen e vlerë kontabile neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit për kategoritë përkatëse të aktivitetit.

Normat e amortizimit të përdorura për vitin 2022 janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

Për aktivet në proces nuk është llogaritur amortizim, në përputhje me përcaktimet ligjore.

Formati 7/a i bilancit, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” është paraqitur në **Pasqyrën PF18**, në Anekset bashkëlidhur.

Formati 7/b i bilancit, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” është paraqitur në **Pasqyrën PF19**, në Anekset bashkëlidhur.

3. Aktivet Afatgjata Financiare:

Nga auditimi, u konstatua se Aktivet Afatgjata Financiare, të cilat në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën 3,500,000 lekë.

Titulli i gjetjes: Mangësi në kontabilizimin e aktiveve afatgjata financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për periudhën e audituar.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se Aktivet Afatgjata Financiare, në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën 3,500,000 lekë. Kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 242,600 lekë në pasqyrat financiare. Nga auditimi i dokumenteve financiare dhe verifikimi në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit, u konstatua se Bashkia Shijak, në 31.12.2022 paraqitet aksionere edhe në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime Durrës” Sh.a, me NUIS M.....M dhe objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm...”, për të cilën nuk ka depozituar kuotat e pjesëmarrjes, si Aksionare me 2.43% të aksioneve. Numri total i aksioneve është 100,000 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 10,000,000 lekë. Kjo shoqëri është themeluar në datën 31.08.2022. Bashkia Shijak zotëron 2,426 aksione me të drejtë vote, në vlerën totale **242,600 lekë**.

Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar”; SKK nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale” pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35, etj.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve financiare të Bashkisë Shijak.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e aktiveve financiare.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të regjistruar dhe sistemuar në kontabilitet, në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, për vlerën totale 242,600 lekë.

Titulli i gjetjes: Parregullsi dhe mangësi në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2022.

Situata: Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2020 paraqitet në vlerën 18,948,027 lekë dhe po aq paraqitet në datën 31.12.2021. Në PF të disponueshme në sistemin e thesarit, vlera totale e investimeve është 18,948,027 lekë, përkatësisht 0 lekë në llogarinë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 18,948,027 lekë në llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”. Nga auditimi i investimeve të vitit 2022 për Bashkinë Shijak janë 9 investime në proces të cilat nuk paraqiten në llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” por këto investime janë kontabilizuar në llogaritë e klasës 2 të aktivitetit.

Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar”; SKK nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale” pikat 55, 56, 57.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve financiare të Bashkisë Shijak.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Shijak për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerën e plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.

➤ **PASIVET**

Titulli i gjetjes: Parregullsi dhe mangësi në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2022.

Situata:

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme: Në këtë grup llogarish paraqiten të gjitha detyrimet e njësisë ekonomike ndaj të tretëve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve me pagesë të mëvonshme.

Në datën 31.12.2022, shuma e llogarive 42 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, të 436 “Sigurime shoqërore”, të cilat janë në vlerë 17,490,591 lekë e cila nuk kuadron me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” në vlerën 16,062,853 lekë. Analiza e grupit të llogarive të pagueshme për vitin 2022 është paraqitur në Aneksin PF26, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2022 për Llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në bilanc paraqiten në vlerën 1,878,340 lekë.

Kriteri: Udhëzim nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare të klasës 4 (pasivit) në Bashkinë Shijak.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Shijak, të marrë masat e nevojshme për kontabilizim e plotë dhe të saktë të llogarive 42 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, të 436 “Sigurime shoqërore” me kundërparti llogarinë nr 4342 “Operacione me shtetin”.

Detyrime të tjera afatshkurtra:

Në këtë grup të detyrimeve afatshkurtra paraqiten shpenzimet e kryera nga njësia ekonomike, dhe që në zbatim të parimit të përputhjes së të ardhurave me shpenzimet, ende nuk janë njohur si shpenzime nga njësia ekonomike.

Po kështu, njësia ekonomike përfshin në këtë grup edhe të gjitha detyrimet e llogaritura për të paguar interesat e maturuara ekonomikisht.

Llogaritë për detyrime të tjera afatshkurtra janë paraqitur në **Aneksin PF23** bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Titulli i gjetjes: Mosmarrja në dorëzim e kontratave të investimeve të mbyllura, mbajtja e garancisë përtej limiteve kohore.

Situata: Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 30,270,542 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë

46,268,922 lekë ose me rritje në vlerën 15,998,380 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme.

Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të likuiduara plotësisht, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës, pavarësisht se nuk janë marrë të gjitha në dorëzim nga Bashkia Shijak, nuk është bërë zhblllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit. Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së garancisë sipas objekteve ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kap II “Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të VKM nr. 3, datë 15.2.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2001 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publike” i ndryshuar pikat 42 – 50 të tij, UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Ndikimi/Efekti: Mosmarrja në dorëzim e objekteve janë veprime të cilat nuk garantojnë nëse objekti është zbatuar sipas kushteve teknike të projekt/preventivave, si është realizuar dhe nëse është realizuar brenda kushteve teknike. Gjithashtu, moskryerja e këtij veprimi bën që nga Bashkia Shijak të mos bëhet vlerësimi i subjekteve mbi cilësinë e punimeve dhe nëse këto subjekte janë shoqëri të besueshme për kryerjen e punimeve me cilësi dhe në afatet të caktuar, si dhe vënia në vështirësi ekonomike e OE, të cilëve iu nevojiten fondet e ngurtësuara për të vazhduar veprimtarinë e tyre ekonomike.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor nga personat përgjegjës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuara.

➤ **KAPITALI**

Sipas përcaktimit të bërë në SKK, kapitali rezulton si diferencë e aktiveve me detyrimet e njësisë ekonomike. Në zbatim të SKK 2 (shtojca 4), njësia ekonomike duhet të pasqyrojë, bazuar në parimin e materialitetit, elementët përbërës të kapitaleve të veta.

Gjendja e llogarisë 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar*” (Kapitali i nënshkruar) në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 2,186,756,382 lekë.

Gjendja e llogarisë 85 “*Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore*” (*Humbja/fitimi i ushtrimit*) në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 254,332,010 lekë, Në këtë zë paraqitet rezultati i periudhës rrjedhëse ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Llogaritë 105 “*Teprica e Granteve kapitale të brendshme*” rezulton e rregjistruar në vlerën 1,315,532,474 lekë. dhe 106 “*Teprica e Granteve kapitale të huaja*”, si për periudhën ushtrimore paraardhëse, ashtu edhe për periudhën ushtrimore të mbyllur, janë me vlerën 0 (zero).

Grantet kapitale të brendshme mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarra në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.

Llogaritë 105 “*Teprica e Granteve kapitale të brendshme*” nuk paraqet rezultat real në pasqyrat financiare në kundërshtim me udhëzimin nr 8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, Kap. III, pikat 47.

Pasqyra e performances financiare në fund të vitit 2022 është paraqitur në **Aneksin PF26** bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

➤ **TË ARDHURAT**

1. Të ardhura nga taksat dhe tatimet:

Llogaria 70 “*Të ardhurat nga taksat e tatimet*”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 141,559,934 lekë.

Të ardhurat nga taksat e tatimet janë paraqitur të detajuara në **Aneksin PF27** bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Llogaria 71 “*Të ardhura jotatimore*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 24,062,937 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 33,533,712 lekë ose me rritje në vlerën 9,470,775 lekë.

Të ardhurat jotatimore janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën PF28**, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

2. Të ardhura të tjera:

Llogaria 72 “*Grante korente*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 1,216,194,288 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 1,026,970,918 lekë ose me ulje në vlerën 189,223,370 lekë. Në zërin “*Të Ardhura të tjera*”, në llogarinë 787 “*Tërheqje nga seksioni i investimeve*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 542,378,071 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 256,249,615 lekë ose me ulje në vlerën 286,128,456 lekë. Në llogarinë 73 “*Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 2,080,765 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 5,908,964 lekë ose me rritje në vlerën 3,828,199 lekë.

Grantet korente, të ardhurat e tjera dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve janë paraqitur të detajuara në **Aneksin PF29** bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

➤ **SHPENZIMET**

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

Llogaria 600 “*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 159,208,477 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 165,112,253 lekë ose me rritje në vlerën 5,903,776 lekë.

Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 26,553,137 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 27,752,803 lekë ose me rritje në vlerën 1,199,666 lekë.

Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Durrës me të njëjtën vlerë.

Shpenzimet për pagat dhe kontributet shoqërore e shëndetësore janë paraqitur në **Aneksin PF30** bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Hartimi i listëpagesave për vitin 2022:

Me përzgjedhje u audituan listëpagesat e muajve prill 2022 dhe dhjetor 2022, nga ku u konstatua se janë plotësuar konform rregullave të përcaktuara. Listëpagesat janë plotësuar mbi bazën e listëprezencave mujore të nënshkruara nga znj. E. Sh.Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Shijak, janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 118,154,279 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 153,297,500 lekë ose me rritje në vlerën 35,143,221 lekë.

Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Durrës me të njëjtën vlerë.

Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime janë paraqitur në **Aneksin PF32** bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

➤ Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës, në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues, të konfirmuara nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dyja palët.

Urdhër-shpenzimet janë përpiluar në bazë të dokumenteve vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit, si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesat, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzime përputhen me vlerat e dokumenteve financiare që mbështesin shpenzimin përkatës.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadron me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas

destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

➤ **Transaksionet financiare nëpërmjet arkës:**

Nga auditimi i dokumentacionit të veprimeve nëpërmjet arkës rezultoi se:

Me arkë janë kryer transaksione financiare të ndryshme, si arkëtim të ardhurash për detyrime nga taksa e tokës bujqësore, taksat e tarifave familjare dhe gjoha të policisë bashkiake, për të cilat janë prerë mandate arkëtimi të plotësuar me të gjitha elementet, sipas faturës për arkëtim të lëshuar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore. Në vitin 2022, nga arka janë kryer transaksione pagese për kthime të parapagimeve të tarifës për kopshtet dhe çerdhen Shijak. Për veprimet me arkën është mbajtur libri i arkës, i cili është mbyllur për çdo muaj dhe është nënshkruar nga personi përgjegjës për arkën dhe specialiste e financës e ngarkuar për mbajtjen e ditarit të arkës.

Nga auditimi i librit të arkës dhe ditarit të arkës konstatohet se të ardhurat nga arkëtimet e kryera për vitin 2022 janë derdhur totalisht në mënyrë periodike në bankë dhe gjendja e arkës në fund të çdo muaji dhe në fund të çdo viti është 0(zero) lekë. Gjithashtu, është mbajtur ditari i arkës në formën klasike kontabël, i cili rezulton i kuadruar. Përfshirja e shumës së të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël dhe në përputhje me VKM-në nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, si dhe të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 63,64. Nga Drejtoria e Financës janë kryer akt-rakordimet mujore dhe vjetore me Degën e Thesarit Shijak për të ardhurat.

3. Subvencionet:Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Shijak nuk ka pasur subvencione.

4. Transferimet korente:

Përfshihen transferimet për nivele të ndryshme të qeverisë për institucione të ndryshme qeveritare. Transferime korente, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 1,338,032,773 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 851,910,649 lekë ose me ulje në vlerën 486,122,124 lekë.

5. Shpenzimet financiare:

Përfshihen transferimet për nivele të ndryshme të qeverisë për institucione të ndryshme qeveritare. Kjo llogari për Bashkinë Shijak është për vlerat zero.

2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave që ka njësi vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB sipas viteve përkatëse bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon*:

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Shijak (*regjistrat e parashikimit dhe realizmit*), për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Procedura 01/01/2022 - 31/12/2022	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHESEJ	7	242,443,669	209,528,552
-Të kufizuara	3	221,954,981	190,717,554
- E Hapur e Thjeshtuar	4	20,488,688	18,810,998
Sipas objekteve	7	242,443,669	209,528,552
-Objekte në fushën e investimeve	2	219,834,543	189,000,000
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	5	22,609,126	20,528,552

Burimi: Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Shijak

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2022– 31.12.2022, janë iniciuar gjithsej **7** procedura me vlera të larta me fond limit 242,443 mijë lekë pa TVSH, janë realizuar 6 procedura me fond limit 213,210 mijë lek dhe vlerë kontrate 209,528 mijë lekë pa TVSH, me një diferencë për vlerën 3,682 mijë lekë ose 2%.

Sipas llojit të aktivitetit, konstatohet se në fushën e ndërtimit (investime), janë **2** procedura me fond limit 219,834 mijë lekë ose 90.6% e kontratave të lidhura dhe në të tjera janë **5** procedura me fond limit 22,609 mijë lekë.

Procedura të llojit “E Kufizuar” janë 3 procedura me fond limit 221,954 mijë lekë, ose 91.5% e fondit të prokuruar.

Kanë marrë pjesë në procedura **28** OE/BOE dhe janë s’kualifikuar **9** OE/BOE ose 32%.

Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **2** procedura ose 28% e procedurave të zhvilluara.

Mbi bazën e materialitetit dhe riskut të bërë nga Grupi i KLSH, nga **7** procedura me vlera të larta me fond limit 242,443 mije lekë janë vlerësuar për auditim **7** procedura me fond limit 242,443 mijë lekë ose 100% e fondit limit, ku shkeljet sipas procedurave dhe problematikave paraqitet si më poshtë vijon:

Titulli i gjetjes: KLSH-ja, konstatohet se në procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2022 - 30.04.2023, janë konstatuar kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST, të miratuar nga AK-ja.

Situata: Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, janë iniciuar gjithsej **7** procedura me vlera të larta me fond limit 242,443 mijë lekë pa TVSH, janë realizuar 6 procedura me fond limit 213,210 mijë lek dhe vlerë kontrate 209,528 mijë lekë pa TVSH, me një diferencë për vlerën 3,682 mijë lekë ose 2%.

Grupi i KLSH-së, referuar vlerësimin të dhënave të materialitetit dhe riskut nga **7** procedura me fond limit 242,443 mijë lekë, ka vlerësuar për auditim **7** procedura me fond limit 242,443 mijë lekë ose 100% e fondit limit.

Nga auditimi i **7** procedurave me fond limit **242,443** mijë lekë, janë konstatuar në **3** raste kritere jo në përputhje me kuadrin rregullator, në **2** procedura OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimin të kriterëve të DST të miratuara nga AK, në vlerën **196,900 mijë lekë** pa TVSH, në **1** rast KVO nuk ka kryer vlerësimin e ofertës për fazën e dytë në mënyrë të paargumentuar dhe në **1** rast kontrata duhej ndarë në lote veprime në kundërshtim me ligji nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenet 2, 36, 39, 77, 82, 92, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 26, 39, 40, 42, 82, 88,” konkretisht sipas periudhave:

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: Neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”; Neni 36, “Specifikimet teknike”, Neni 39, “Ndarja e kontratave në lote”, Neni 77, “Kërkesat për kualifikim”, Neni 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”: VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 26, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, Neni 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, Neni 42 “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote”, Neni 82, pika 5 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, Neni 88, pika 3, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”.

Shkaku: Mos vlerësimi i drejtë i kriterëve dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe aplikimi i kriterëve jo në përputhje me kuadrin rregullator.

Ndikimi: Aplikimi i kriterëve jo në përputhje me kuadrin rregullator, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST për vlerën **196,900 mijë lekë**.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen fitues të OE të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike.

-Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).

1. Tenderi me objekt: “Rindërtim i objektit social – kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak”, me këto të dhëna:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rindërtim i objektit social – kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 49 datë 14.12.2021	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 7066 Prot., datë 10.12.2021 E.O - juriste J.G - ing. ndërtimi/Ekspert i fushës F.Gj, anëtar, Arkitekt/ Ekspert i fushës	3. Komisioni i Vlerësimin të Ofertave: Nr. 378 datë 14.12.2021 dhe Nr. 405 datë 30.12.2021 N.K., kryetar G.J. Ç, anëtar A.M, anëtar
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Kufizuar” në kuadër të procesit të rindërtimit		

5.Fondi Limit (pa Tvsh) 190,601,138 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: O.E "Sh." shpk me ofertë 189,000,000 lekë me lidhje kontrate datë 03.06.2022, me afat deri ne përfundimin e punimeve	7.Diferenca me fondin limit: 1,601,138 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Faza 1- Data e zhvillimit: 05.01.2022 Faza 2- 07.03.2022	9.Burimi Financimit: Buxheti Shtetit	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b)Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 3 OE
11.Ankimime AK, Nuk Ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i krierve: 1.Kërkesa e pikës **2.3 e DST** e cila kërkon kategorinë NP-2C të licencës (ndërtime civile dhe industriale), nuk është në përputhje me vlerën e investimit. Në kushtet kur vlera totale e këtij investimi është 190,601,138 lekë, kjo vlerë përcaktohet sipas licencës së shoqërisë në kategorinë **D** e cila është për punime nga 100 milion deri në 200 milion. Për shkak të vlerës dhe rëndësisë së objektit, AK do duhej të kërkonte kategorinë NP-2D të licencës.

2.Kërkesa e pikës **2.3 e DST**, e cila kërkon ndër të tjera 2 teknik ndërtimit, 1 hidraulik, 2 bojaxhinj, 1 hidroizolues, 5 muratorë, 3 specialistë për punimet në lartësi, 6 karpentierë, 9 hekurkthyes, të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike", pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkojnë me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik. Gjithashtu, sqarohet se dëshmitë e sigurimit teknik, nuk mund të konsiderohen dëshmi kualifikimi për proceset e punës që merren përsipër nga stafi i mësipërm, pasi objekti i këtyre dëshmimeve është garantimi i sigurisë së punës të pajisjeve elektrike dhe jo certifikimi për profilin apo kualifikimin e punonjësve.

3.Kërkesa e pikës **2.3 e DST** e cila kërkon nga OE disponimin e 3 ekskavatoristëve, 2 buldozeristë dhe 1 automakinist, është kërkesë jo në përputhje me numrin dhe llojin e mjeteve të kërkuara. Konkretisht kërkohen 4 mjete për të cilat është e nevojshme disponimi i manovratorëve, nga të cilat është vetëm 1 ekskavator ndërkohë kërkohen 3 ekskavatoristë. Kërkohet vetëm 1 rrul ndërkohë janë kërkuar 2 buldozeristë. Këto kërkesa janë kufizuese dhe nuk i shërbejnë procedurës.

4.Kërkesa e pikës **2.3 e DST**, e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk mund t'u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin që prokurohet. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s'kualifikim të padrejtë për OE.

Vlerësimi i ofertave: 1.Ky OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2 (Kapaciteti ekonomik dhe financiar) të DST** e cila kërkon nga OE të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021. Nga dokumentacioni që disponohet nëpërmjet faqes se Agjencisë së

Prokurimit Publik, rezulton se ky OE përgjatë vitit 2021 ka lidhur kontrata dhe kryer punimeve ndërtimi në disa Njësi të Vetëqeverisjes Vendore, ku ka njëkohësisht detyrimin për likuidimin e detyrimeve pranë këtyre njërive.

-Në Bashkinë Kavajë, ka lidhur kontratën me objekt “Ndërtim muri fshati Kryemëdhenj” në Tetor të vitit 2021, ndërkohë nuk ka paraqitur vërtetimin për likuidimin e detyrimeve pranë kësaj njërive.

-Ka lidhur kontratën me UK Lushnje Sh.A me objekt “Rikonstruksion i linjës kryesore të furnizimit me ujë nga stacioni i pompimit Gajde në stacionin e pompimit Toshkiz” në Prill të vitit 2021, ndërkohë nuk ka paraqitur vërtetimin për likuidimin e detyrimeve pranë Bashkisë Lushnjë.

-Ka lidhur kontratën me Bashkinë Prrenjas me objekt “Rikonstruksion i rrugës Qukës – Skënderbe” në Tetor të vitit 2021, ndërkohë nuk ka paraqitur vërtetimin për likuidimin e detyrimeve vendore pranë kësaj bashkie.

-Ka lidhur kontratën me Bashkinë Elbasan me objekt “Rikualifikim i sheshit Urban në lindje të rrugës “Iljaz Kosova” tek xhamia në Fushë Mbret” në Korrik të vitit 2021, ndërkohë nuk ka paraqitur vërtetimin për likuidimin e detyrimeve vendore pranë kësaj bashkie.

-Ka lidhur kontratën me Bashkinë Vlorë me objekt “Rikualifikim urban në Njësinë Administrative Qendër (Nertë + Sherishtë) në Maj të vitit 2021, ndërkohë nuk ka paraqitur vërtetimin për likuidimin e detyrimeve vendore pranë kësaj bashkie.

-Ka lidhur kontratën me Drejtorinë e Shërbimit Memaliaj me objekt “Mirëmbajtja e rrugëve të Njërive Administrative” në Mars të vitit 2021, ndërkohë nuk ka paraqitur vërtetimin për likuidimin e detyrimeve vendore pranë kësaj bashkie.

-Ka lidhur kontratën me Bashkinë Këlcyrë me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës Ura e Mbrezhanit – Malshovë” në muajin Shtator 2021, ndërkohë nuk ka paraqitur vërtetimin për likuidimin e detyrimeve vendore pranë kësaj bashkie.

-Ka lidhur kontratën me Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Durrës me objekt “Rehabilitim Argjinatura Perlat” në Gusht të vitit 2021, ndërkohë nuk ka paraqitur vërtetimin për likuidimin e detyrimeve vendore pranë kësaj bashkie.

Veprimet e mësipërme të këtij OE, janë në kundërshtim me nenin 43, pika 1/1 “përditësimi i të dhënave të regjistrimit” të ligjit nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili përcakton se:

1/1. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia.

-Ky OE, duke shmangur regjistrimin pranë këtyre njërive, njëkohësisht ka shmangur detyrimet vendore pranë bashkive në të cilat kanë kryer punime ndërtimore.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në hartimin e kritereve të veçanta, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NjP dhe KVO.**

Ndikimi: Prokurim të fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **189,000 mijë lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NjP, është paraqitur observacioni i administruara në KLSH me nr. 430/5 prot., datë 31.08.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: 1. Në lidhje me pikën 1 për kategorinë e licencës, sqarohet se është kërkuar për zërat e preventivit A-2, A-3, A-5, A-9, A-10, B-1, B-2, C-2, dhe C-3 të cilat arrijnë vlerën 70,807,685 lekë. Bazuar në vlerën e lartpërmendur është përcaktuar edhe niveli minimal i klasifikimit për këtë kategori të licencës (C) duke mbajtur në konsideratë parashikimet e lidhjes nr. 4, të Vendimit nr. 42, datë 16.01.2008 të KM. Kërkesa për disponimin e kësaj licence rrit mundësinë e pjesëmarrjes së OE dhe rrit nivelin e konkurrencës. Përpos kësaj, procedura është monitoruar edhe nga APP, dhe nuk i janë referuar kategorive të licencës.

2. Lidhur me pikën 2 për stafin e certifikuar me dëshmi të sigurimit teknik, sqarohet se subjektet e akredituara pajisin me dëshmi jo vetëm punonjësit që punojnë me pajisje, impiante dhe instalime elektrike, por edhe punonjës të profileve të tjera.

3. Lidhur me pikën 3 për kërkesën për 3 ekskavatoristë dhe 2 buldozeristë, sqarohet se është vendosur si kriter sipas urdhrin nr. 200 të MIE, datë 16.05.2019 duke mbajtur në konsideratë faktin që kërkohet realizimi i punimeve komplekse në një kohë sa më të shkurtër, duke prezumuar edhe punën e stafit me orarë të zgjatur.

4. Lidhur me pikën 5, Bashkia Shijak ka kërkuar një kontratë sipas legjislacionit në fuqi referuar Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Për të garantuar sigurinë për realizimin me sukses të zbatimit të kontratës, pasi kjo është kontratë me vlerë të konsiderueshme dhe me një afat zbatimi relativisht të shkurtër në raport me kompleksitetin e punimeve, është kërkuar që kontratat për mjetet me qira të kenë të specifikuar objektin e prokurimit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Pretendimet e paraqitura nga ana juaj nuk pranohen. Ato janë të njëjta me ato të paraqitura për Akt Konstatimin nr. 4, dhe janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit. Nuk ka prova apo argumente të reja për trajtim.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO, është paraqitur observacioni i administruara në KLSH me nr. 430/5 prot., datë 31.08.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: Komisioni për Vlerësimin e Ofertave, nuk është dakord me qëndrimin e audituesve sa i përket objektit të prokurimit “Rindërtim i objektit social – kulturor, Pallati i Kulturës Shijak” për të cilën jeni shprehur se observacioni i dhënë nga ana jonë nuk është i mbështetur ligjërisht, theksojmë se KVO për shqyrtimin e ofertave për objektet e prokurimit i referohet VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 75, pika 1, 2, 3 dhe 4 të kërkesave në DST.

Në këtë rast, KVO për OE “Sh. 07” shpk nuk është në kundërshtim me kërkesat e DST sipas kritereve të veçanta të kualifikimit, vlerësim i cili është bërë dhe nga ju. Sipas kërkesës në DST, pika 2.2 kërkohet “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2021, në të gjitha adresat ku OE ushtron aktivitetin e tij sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKR-së”.

1. Për konstatimin e pikës 1, OE Sh - 07 ka vënë në dispozicion vërtetime për pagesat e detyrimeve tatimore nga DPT dhe nga Bashkitë Tiranë, Mallakastër dhe Fier ku konstatohet se ka ushtruar veprimtari i regjistruar në organet tatimore vendore;

Sqarojmë se :

Vërtetimi nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM, gjenerohet nëpërmjet një procedure automatike, nga sistemi elektronik i DTM, nëpërmjet të cilit garanton likuidimin e detyrimeve tatimore, përfshirë tatimin, kamatvonesat si dhe gjobat, parashikuar nga dispozita 6 pika 3 dhe dispozita 29 e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.



VËRTETIM

TAKSA PAGUESI NR.	87333
SUBJEKTI FIZIK/JURIDIK	SHKELQIMI 07
ADMINISTRATORI	Shkëlqim Kapllanaj
FORMA JURIDIKE	Shpk
NIPTI	K68121808W
ADRESA	Kruga Bardhok Biba" Njësia Bashkiake nr. 9 godinë tre katëshe, mbrapa shkollës "Sami Frasheri"

Vërtetojmë se, subjekti ka likuiduar detyrimet vendore për në vitin 2021, të parashikuara sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" me ndryshimet përkatëse, si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.158, datë datë 26.12.2019 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës" me ndryshimet përkatëse.

Ky vërtetim lëshohet për efekt dokumentacioni për tender.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Ky vërtetim nuk duhet i vlefshëm për QKB.

Adri R. Kavajë, SH.Uitona Mëkanike, Hyrja 203, Tiranë, Tel./Fax: +355 4 2419752; takstat@tirana.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
DREJTORIA OPERACIONALE DHE TEKNIKE

Nr. 54-4855 / prot.

Tiranë, më 26.05, 2021

VËRTETIM

TAKSA PAGUESI NR. 87333
SUBJEKTI FIZIK/JURIDIK SHKELQIMI 07
ADMINISTRATORI Shkëlqim Kapllanaj
FORMA JURIDIKE Shpk
NIPTI K68121808W
ADRESA Rruga Bardhok Biba" Njësia Bashkiake nr. 9 godinë
tre katëshe, mbrapa shkollës "Sami Frasheri"

Vërtetojmë se, subjekti ka likujtuar detyrimet vendore për në vitin 2021, të parashikuara sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" me ndryshimet përkatëse, si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.158, datë datë 26.12.2019 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës" me ndryshimet përkatëse.

Ky vërtetim lëshohet për efekt dokumentacioni për tender.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Ky vërtetim nuk është i vlefshëm për QKB.

Adr: Brr. Kavajës, Ish Ullina Mekanike, Hyrja 203, Tiranë, Tel./Fax +355 4 2419752, taksat@tirana.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA EKONOMIKE DHE ÇËSHTJE SOCIALE
SEKTORI TATIM TAKSAVE

Nr. DTS / regj.

Datë 14.05.2021

VËRTETIM

Vërtetojmë se subjekti **SHKELQIMI 07** Shpk. me NIPT **K68121808W** me administrator **Z. Shkëlqim Kapllanaj** aktivitet sipas (QKB) Qendra Kombëtare e Biznesit, ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për periudhën vjetore 2021 ndaj Bashkisë Mallakastër

E lëshojmë këtë vërtetim sipas kërkesës së interesuarit.

KRYETARI

Qerim Ismailaj



Ndër të tjera ju jeni shprehur se OE ka shmangur detyrimin që rrjedh nga ligji nr. 9920 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1. Ky detyrim rrjedh dhe zbatohet për OE dhe kontrollohet nga administrata tatimore, pasi nëse sipas jush për informacionin e nevojshëm KVO mund t’i referohet buletineve të publikuara nga APP, KVO nuk mund të tejkalojë kompetencat e veta duke jashtë jashtë kritereve të DST.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

-Observacioni juaj nuk pranohet, pasi nuk mbështetet ligjërisht. Audituesit sqarojnë se OE kanë për detyrim sipas nenit 43, pika 1/1 “përditësimi i të dhënave të regjistrimit” të ligjit nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar që përpara nisjes së punimeve, të hapin niptet sekondare

në çdo vend. Ky OE, rezulton në mënyrë të përhapur se përgjatë vitit 2021 ka kryer punime në disa Njësi të Vetëqeverisjes Vendore, ndërkohë nuk ka hapur nipt-et sekondare, dhe njëkohësisht ka shmangur detyrimet vendore pranë këtyre njërive. AK Bashkia Shijak, rezulton se është vetë njëra ndër njësitë e cila pasi ka lidhur kontratën për procedurën të cilën po e trajtojmë, dhe pavarësisht se ka mbi 1 vit që ka lidhur kontratë me këtë subjekt, ai nuk rezulton i regjistruar për hapjen e nipt-it sekondar pranë kësaj bashkie, duke shmangur njëkohësisht detyrimet vendore. Audituesit, sqarojnë se OE, pikërisht për shmangien e këtyre detyrimeve, shmangin hapjen e nipt-eve sekondare. Lidhur me informacionin e nevojshëm, buletinet e APP dhe ekstraktimi i të dhënave që jepet pranë faqes së Agjencisë së Prokurimit Publik, në të cilin paraqiten të gjitha kontratat e lidhura nga OE/BOE përgjatë viteve konkrete, AK ka pasur dhe ka të gjithë informacionin e nevojshëm për të evidentuar aktivitetin e OE, për të krijuar garanci se kemi të bëjmë me OE që respektojnë detyrimet ligjore edhe për likuidimin e detyrimeve vendore. Vlen të theksohet, se rasti konkret kemi të bëjmë me një OE i cili nuk ka shmangie në 1 AK, por plot 8 AK, çka nuk mund të konsiderohet devijim i vogël, por mangësi e përhapur e kësaj shkeljeje.

2. Tenderi me objekt: “Blerje materialesh për riparim rrugësh”, me këto të dhëna:

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materialesh për riparim rrugësh”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 16 Prot., datë 24.05.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 16 Prot., datë 20.05.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 150 Prot., datë 24.05.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar – Mallra”	E.O - juriste H.K - jurist Gj.Ç - ing.ndërtimi	Sh.D - kryetar E.Z - anëtare Xh.K - anëtare
5. Fondi Limit (pa tvsh) 2,498,790 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE “G. sh.p.k”, me ofertë 2,037,500 lekë, me lidhje kontrate datë 22.11.2022, me afat 6 muaj	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 461,290 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 12.09.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender - OE b) Skualifikuar 0 OE c) Kualifikuar 3 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1. Kërkesa e pikës 2.3 e DST (Kapaciteti teknik), e cila kërkon nga OE të disponojnë minimalisht 1 punonjës mbështetës shofer për transportimin dhe shkarkimin e mallrave objekt prokurimi, shoqëruar me kontratë individuale të punës dhe leje drejtimi të mjetit të kategorisë (B), është kërkesë e cila nuk është në përputhje me kuadrin rregullator që normon kategoritë e lejeve të drejtimit. Në kërkesën që vijon pas kësaj, është kërkuar njëkohësisht një mjet kamion me kapacitet mbajtës mbi 18 Ton. Sipas kodit rrugor të RSH, miratuar me ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, neni 115 “Kategoritë e leje drejtimit për drejtimin e motomjeteve dhe automjeteve” pika 3, germa (b) përcakton se:

Kategoria B: mjet motorik me masë maksimale të autorizuar jo më të madhe se 3500 kg dhe me jo më shumë se 8 ndenjëse, përjashtuar ndenjësën e drejtuesit të mjetit. Mjetet e kësaj kategorie mund të tërheqin rimorkio të lehtë ose një gjysmë rimorkio që nuk e kalon masën maksimale të autorizuar 750 kg, duke u siguruar që masa maksimale e autorizuar kombinimi të mos kalojë

4250 kg. Në rast se kombinimi i kalon 3500 kg, drejtuesi duhet t'i nënshtrohet një trajnimi dhe provimi të posaçëm.

-Sa më sipër, konstatohet se nga AK është kërkuar kamion me kapacitet mbajtës mbi 18 Ton, kapacitet i cili nuk mbulohet me kategorinë (B) të lejes së drejtimit të kërkuar nga NjP, duke mos dhënë garanci për një kërkesë të përshtatshme në raport me mjetin e kërkuar.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NjP.*

Ndikimi: Kriter i papërshtatshëm.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

3. Tenderi me objekt: “Mbikëqyrje punimesh në objektin “Rindërtim i objektit social – kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak”, me këto të dhëna:

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mbikëqyrje punimesh në objektin “Rindërtim i objektit social – kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 3997 Prot., datë 16.06.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 7066 Prot., datë 10.12.2021 E.O- juriste	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 3998 Prot., datë 16.06.2022 N.K - kryetar Gj.Ç - anëtar Xh.K - anëtare
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Kufizuar” në kuadër të procesit të rindërtimit	J.G - ing. ndërtimi/Ekspert i fushës R.K - ekonomiste	
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 2,120,437 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: O.E “H. – E. C. sh.p.k & I. sh.p.k”, me ofertë 1,717,554 lekë, me lidhje kontrate datë 05.08.2022, me afat deri në përfundimin e punimeve në objektin “Rindërtimi i objektit social-kulturor “Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak”.	7.Diferenca me fondin limit: 402,883 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Faza 1- Data e zhvillimit: 07.07.2022	9.Burimi Financimit: Buxheti Shtetit	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 11 OE b)Skualifikuar 5 OE, c) Kualifikuar 6 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka

Procedura nuk ka mangësi.

4. Tenderi me objekt: “Blerje pjesë këmbimi për mjetet e bashkisë”, me këto të dhëna:

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje pjesë këmbimi për mjetet e bashkisë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr.4942 Prot., datë 18.08.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 3565 Prot., datë 20.05.2022 E.O - juriste	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 4943 Prot., datë 18.05.2022 Sh.D - kryetar E.Z - anëtare F.F - anëtare
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar – Mallra”	H.K - jurist A.Ç - ing.mekanik	

5. Fondi Limit (pa tvsh) 7,492,900 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) “B M” p.f, me ofertë 6,728,250 lekë, me lidhje marrëveshje kuadër datë 27.10.2022	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 764,650 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 26.09.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender – 1 OE b) Skualifikuar 0 OE c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka

Procedura nuk ka mangësi.

5. Tenderi me objekt: “Blerje karburant”, me këto të dhëna:

5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburant”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 52 datë 24.12.2021	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 7185 Prot., datë 16.12.2021 E. O - juriste H.K -(jurist) A.Ç - ing.mekanik	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 7352 Prot., datë 24.12.2021 I.Gj, kryetar Xh.K, anëtare E.Z, anëtare
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar – Mallra”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 8,000,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE “K. sh.p.k”, me ofertë 7,900,513 lekë, me lidhje kontrate datë 15.02.2022, me afat deri në ezaurimin e mallit, objekt i kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 99,487 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 17.01.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka

Titulli i gjetjes: Procedura duhet ndarë në lote, mangësi që lidhen me vlerësimin e ofertës së OE fitues.

Situata: Për ndarjen në lote: -Lidhur me procedurën e ndjekur, audituesit sqarojnë se AK ka bërë kërkesë për 2 lloje produktesh që janë naftë dhe benzinë. Duke qenë se secili nga këto produkte është i ndryshëm, AK do duhej që ta mundësonte procedurën të ndarë me lote, ku secili prej OE të interesuar të mund të paraqiste ofertë për secilin lot, kjo për të krijuar mundësinë e OE të cilat mund të paraqesin oferta vetëm për njërin nga mallrat (karburantin) objekt prokurimi, pasi forma e ndjekur nga AK është në kundërshtim me parimet dhe qëllimin e rregullave të prokurimit publik, konkretisht me nenin 42 “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Vlerësimi i ofertave: 1.Ky OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.2 (**Kapaciteti ekonomik dhe financiar**) të DST e cila kërkon nga OE të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 në të gjitha adresat ky operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij sipas të

dhënave përkatëse të ekstraktit të QKB, kërkesë e cila konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësisimit të formularit të vetëdeklarimit.

-Sipas shtojcës nr. 8, formulari i vetëdeklarimit, rezulton se ky OE nuk ka deklaruar likuidimin e detyrimeve vendore në të gjitha adresat sipas ekstraktit të QKR, në kundërshtim me kërkesën në DST.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, rezulton se ky OE nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për likuidimin e detyrimeve vendore, ndërkohë që rezulton se ka adresa sekondare në thuajse gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për ndarjen e procedurës me lote si dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi: anëtarët e NjP dhe KVO.***

Ndikimi: Prokurim të fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **7,900 mijë lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP, është paraqitur observacioni i administruara në KLSH me nr. 430/5 prot., datë 31.08.2023 si më poshtë:

1.Lidhur me mungesën e kërkesave nga sektorët për përlllogaritjen e fondit limit, sqarohet se kërkesat e sektorëve të bashkisë në lidhje me nevojën për karburant, i janë përcjellë Drejtorisë Ekonomike, e cila ka bërë planifikimin e fondit dhe miratimin nëpërmjet VKB nr.82, datë 24.12.2022 “Për miratimin e buxhetit afatmesëm 2022-2024”. Zërat buxhetorë të miratuar me VKB pasqyrohen në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimit Publik. që hartohet në çdo fillim viti.

2.Lidhur me mos ndarjen e procedurës në lote, sqarohet se APP në rekomandimin e saj nr. 6732 prot., datë 21.10.2020, rekomandon AK që të ndajnë në lote objektin e kontratës, në rastin kur ky objekt përbëhet nga mallra ose shërbime të natyrave, të cilat nuk janë të lidhura ngushtësisht me njëra – tjetrën dhe që i përkasin veprimtarive tregtare të ndryshme, e cila mund të sjellë kufizim të numrit të OE pjesëmarrës.

Mbështetur në nenin 63, pika 2 të VKM-së.. ku parashikohet se “...OE duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative”, si dhe në vijim të njoftimit të APP me nr. 5332 prot., datë 17.05.2018, rekomandojmë që AK të përcaktojë në dokumentet e tenderit se OE duhet të ofertojnë vetëm me marzh fitimi për të dy llojet e karburantit, ose në të kundërt nëse AK vlerëson se procedura duhet zhvilluar me marzhe fitimi të ndryshme, duhet të zhvillojë një procedurë prokurimi të ndarë në lote.

Duke qenë se objekti i kontratës janë 2 mallra (gazoil dhe benzinë) që janë të së njëjtën natyrë, i përkasin të njëjtës natyre tregtare, dhe duke marrë në konsideratë sasinë e vogël të njërit prej mallrave (500 litra benzinë), dhe shmangien e dështimit të procedurës, AK Bashkia Shijak vendosi të zhvillojë një procedurë prokurimi të pa ndarë në lote.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Pretendimet e paraqitura nga ana juaj nuk pranohen. Ato janë të njëjta me ato të paraqitura për Akt Konstatimin nr.4 dhe janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit. Nuk ka prova apo argumente të reja për trajtim.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO, është paraqitur observacioni i administruara në KLSH me nr. 430/5 prot., datë 31.08.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *1 Lidhur me konstatimin se “Ky operator nuk përmbush kriterin e pikës 2.2 (kapaciteti ekonomik dhe financiar) e cila kërkon nga OE të paraqesin Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021, në të gjitha adresat ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKR-së. (Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë vërtetimin).*

Sqarojmë se OE K. sh.p.k në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 Pjesa II Shkaqet e përjashtimit

Germa A:*Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, ka deklaruar se Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP;*

Dokument ky i cili është nënshkruar dhe firmosur nga administrator i shoqërisë. Lloji I dokumentit vërtetim dhe organi lëshues D.P.Tatimeve .

Bashkëlidhur kopje e formularit të vetëdeklarimit.

proces fillimentimi (statusi aktiv).	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: qkb.gov.al Autoritetin ose organin lëshues: OKB Lloji i dokumentit: EKSTRAKT
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: e-albania.gov.al Autoritetin ose organin lëshues: D.P. TATIMEVE Lloji i dokumentit: VERTETIM
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: oshee.gov.al Autoritetin ose organin lëshues: OSHEE Lloji i dokumentit: VERTETIM DEBIE
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfishirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: akori.gov.al, inspektoriatipunesa.gov.al, shendetesia.gov.al Autoritetin ose organin lëshues: AGJENCIA KOMBETARE E MËDESHIT, INSPEKTORIA TI I PUNES, M SHENDETESIJE DHE CESHTIJEVE SOCIALE Lloji i dokumentit: VERTETIM
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësimin e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i asnjë aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në listë cilësimi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: app.gov.al Autoritetin ose organin lëshues: AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK Lloji i dokumentit: BULETIN

Sa më sipër, sqarojmë gjithashtu se:

OE K. sh.p.k ka lidhur kontrata shërbimi edhe më parë me bashkinë Shijak, dhe rezulton si një operator ekonomik dhe taksapagues i rregullt, me të cilin nuk janë shikuar problematika.

Gjithashtu të ndodhur në kushtet e domosdoshmërisë së marrjes së shërbimit dhe furnizimit me karburant për nevojat e institucionit ka ndodhur një pakujdesi vlerësimi për efekt shpejtësie nga ana e KVO e cila nuk është reflektuar në raportin përmbledhës .

Ju bëjmë me dije se OE K. sh.p.k ka qenë konkurrent i vetëm në këtë procedurë tenderi, dhe në lidhje me zhvillimin e kësaj procedure nuk ka pasur ankesa.

Referuar komenteve të lëna na ana juaj, KVO i është drejtuar zyrtarisht OE K. shpk me nr..prot..., datë..2023, në të cilën kemi kërkuar të na vendosi në dispozicion kopje të noterizuar të vërtetimeve për shlyerje të detyrimeve vendore për vitin 2021 në të gjitha adresat ku OE ushtron aktivitetin e tij sipas të dhënave përkatëse të QKR, të cilat u vendosën në dispozicion nga OE dhe i janë bashkëlidhur materialit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

-Lidhur me observacionin e paraqitur nga ana juaj, ai nuk pranohet. Konkretisht audituesit sqarojnë, se pavarësisht se OE i është përgjigjur kërkesës suaj për vënie në dispozicion të vërtetimeve për likuidimin e

detyrimeve vendore për vitin 2021, ky moment referuar LPP, konkretizohet pas kualifikimit paraprak të OE, dhe vlerësohet i gjithë dokumentacioni i kërkuar bashkë me dokumentet sipas formularit të vetëdeklarimit, përpara shpalljes fitues të OE. Audituesit, vënë në dukje mangësinë që ka OE për të provuar gjatë dorëzimit të dokumenteve se plotëson të gjitha kriteret e kërkuara.

6. Tenderi me objekt: “Blerje ushqimesh për çerdhen dhe kopshtin me drekë”, me këto të dhëna:

6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje ushqimesh për çerdhen dhe kopshtin me drekë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 551 Prot., datë 02.02.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 7401 Prot., datë 30.12.2021	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 552 Prot., datë 02.02.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar – Mallra”	E.O - juriste B.O- ekonomiste R.K- ekonomiste	Sh.D, kryetare S.B, anëtare Xh.K, anëtare
5. Fondi Limit (pa tvsh) 2,496,998 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE “M.C.C.sh.p.k” me ofertë 2,144,735 lekë, me lidhje kontrate datë 07.03.2022, me afat deri në ezaurimin e mallrave objekt i kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 352,263 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 18.02.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka

Procedura nuk ka mangësi.

7. Tenderi me objekt: “Riforcimi i njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të pabanueshme, të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019”, me këto të dhëna:

7. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Riforcimi i njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të pabanueshme, të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 32 datë 26.09.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 32 Prot., datë 26.09.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 346 datë 26.09.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Kufizuar” në kuadër të procesit të rindërtimit	E.O - Gj.Ç - H.K -	Sh. D. - kryetar J.G - anëtar A.M- anëtar
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 29,233,405 - lekë pa tvsh	6. Oferta fituese: -	7. Diferenca me fondin limit: - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Faza 1 - Data e zhvillimit: 25.10.2022 Faza 2 - 24.02.2023	9. Burimi Financimit: Buxheti Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës - 5 OE b) Skualifikuar - 2 OE, c) Kualifikuar - 3 OE

11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka
----------------------------	---	---

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në hartimi e kritereve dhe vonesa për vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kritereve: 1. Kërkesa e pikës **2.3 e DST**, e cila kërkon ndër të tjera 1 teknik ndërtimit, 1 hidraulik, 2 hidroizolues, 2 hekurkthyes, 6 karpentierë, 1 specialist për punime në lartësi, të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkojnë me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik. Gjithashtu, sqarohet se dëshmitë e sigurimit teknik, nuk mund të konsiderohen dëshmi kualifikimi për proceset e punës që merren përsipër nga stafi i mësipërm, pasi objekti i këtyre dëshmimeve është garantimi i sigurisë së punës të pajisjeve elektrike dhe jo certifikimi për profilin apo kualifikimin e punonjësve.

2. Kërkesa e pikës **2.3 e DST**, e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk mund t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin që prokurohet. Këto kërkesë janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikim të padrejtë për OE.

Vlerësimi i ofertave: Lidhur me shqyrtimin e fazës së dytë të procedurës, rezulton se paraqitja e ofertave nga OE të kualifikuar në fazën e parë mban datën 24.02.2023. Janë paraqitur 2 oferta nga 2 OE të kualifikuar, ofertat e të cilëve rezulton se në muajin Qershor 2023, pra me shumë se 3 muaj pas paraqitjes së tyre, nuk është përfunduar procesi i vlerësimit dhe shpalljes fitues të OE. Nga audituesit, vlen të theksohet se për shkak të situatës së krijuar nga Tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, Këshilli i Ministrave vendosi nëpërmjet Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” që për projektet e Rindërtimit të aplikohet procedura e përshpejtuar, pra ajo e KUFIZUAR, pikërisht për efekt të përshpejtimit të procesit. KVO rezulton se nuk e ka përfunduar procesin e vlerësimit të kësaj faze, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e KVO.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NjP dhe KVO.**

Ndikimi: Ndikon në faktin se kemi të bëjmë me objekte të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 për të cilat është e nevojshme ndërhyrja për të garantuar rrezikun që mund të vij nga këto objekte.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NjP, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 430/5 prot., datë 31.08.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: I. *Pretendimet e paraqitura për punonjësit e certifikuar me dëshmi të sigurimit teknik dhe pretendimet për mjetet e marra me qira për të cilat kërkohet të kenë të përcaktuar në kontratë objektin e prokurimit, janë të njëjta me ato të paraqitur më sipër në procedurën me objekt “Rindërtimi i pallatit të kulturës” të cilat janë trajtuar nga audituesit edhe në fazën e Projekt Raportit të Auditimit, qëndrimi i të cilëve është i njëjtë me trajtimin e mësipërm.*

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 430/5 prot., datë 31.08.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: I. *Referuar vlerësimit të ofertave në fazën e dytë ju jeni shprehur se KVO nuk e ka përfunduar procesin e vlerësimit të kësaj faze, në kundërshtim me pikën 15 nenit 82 të VKM-së nr 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO-së.*

Bëjmë me dije se nga ana e KVO nuk u vijua me vlerësimin e fazës së dytë pasi, nga Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve u njohëm me vendimin nr 9 datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapacitet shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, Kreu II neni 3 pika 4.

Vendim i cili ndalonte për të kryer procedura të cilat mund të ndikonin në rezultatin e zgjedhjeve, arsye e cila coi komisionin e vlerësimit të ofertave për të mos vijuar me vlerësimin e fazës së dytë.

Vlerësim i cili u krye pas datës së zhvillimit të zgjedhjeve dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga dy operatorët ofertues.

Vlerësimi u krye pas datës së zhvillimit të zgjedhjeve dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga do OE ofertues. Theksojmë se procedura është përfunduar duke u bërë e mundur dhe lidhja e kontratës me OE.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Lidhur me pretendimet e paraqitura, ato nuk pranohen pasi nuk janë të mbështetura në kritere ligjore. Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, neni 3 pika 4 përcakton se *Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ndalohet dhënia e kontratave publike të koncesionit/partneritetit publik privat (PPP), për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncesionare të identifikuar dhe nisur, apo nuk janë parashikuar për t’u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor.*

Sa më sipër, rezulton se procedura objekt shqyrtimi është shpallur me datë 25.10.2022, datë e cila përkon më shumë se 4 muaj nga data e zhvillimit të zgjedhjeve, për të cilën AK nuk pengohet nga Vendimi Nr. 9 i KQZ-së dhe duhej të përfundonte vlerësimin e procedurës edhe për fazën e dytë, aq më pak kur kemi të bëjmë me objekte të dëmtuara nga tërmeti dhe klasifikohen me shkallë rrezikshmërie.

2.4.1 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

Në Bashkinë Shijak, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizua regjistri i investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit. Nga kjo analizë, është përzgjedhur për auditim në bazë të vlerës së kontratës objekti:

Nr	Objekti	Vlera e kontrates	Kontraktori
1	“Rikonstruksion i tubacionit të dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V = 2000 m ³ Shijak, rrjet shpërndarës fshati Maminas – Kareç- Bilalas – Karpen - Bodinak”	247,129,485.5	BOE “K.K” Shpk & “K.” Shpk
2	“Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për qytetin Shijak”	331,619,838.3	BOE “K.K” Shpk & “K.” Shpk

1. “Rikonstruksion i tubacionit të dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V = 2000 m³ Shijak, rrjet shpërndarës fshati Maminas – Kareç- Bilalas – Karpen - Bodinak”, Bashkia Shijak

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 5086 prot datë 25.08.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Shijak, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z.E.A dhe BOE “K.K” Shpk me përfaqësues Z.V.P, me licencë profesionale NZ 4304/15 & “K.” Shpk me përfaqësues Z.Q.K, me licencë profesionale NZ 4901/13. Vlera e kontratës është 247,129,485.5 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 180 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit. Në dosje rezulton të jenë hartuar amendamenti i kontratës me nr 1943/2 prot, datë 09.05.2022, i cili bën shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 90 ditë nga data e nënshkrimit të amendamentit dhe amendamenti i kontratës me nr 4367 prot, datë 09.08.2022, i cili bën shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 150 ditë nga data e nënshkrimit të amendamentit. Në dosje nuk administrohet asnjë kërkesë apo relacion teknik mbi shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 5086/1 prot, datë 25.08.2021, është lidhur kontrata me BOE “N. E.” Shpk, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh respektivisht MK. 2498/1 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 3,172,729 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, në dosje administrohet kontrata me nr. 2600/4 prot., datë 01.06.2023, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi BOE “K.&C.” Shpk & “M.” Shpk., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3597, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 465,575 lekë me TVSH, me afat të kryerjes së kolaudimit 7 ditë.

Deri në datën e mbajtjes së këtij aktkonstatimi, objekti nuk është kolauduar. Ky mosveprim është në kundërshtim me UKM Nr.3, datë 15.2.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, kreu II, pika 2, sipas të cilës “Kolaudatori ose grupi i kolaudimit caktohet nga investitori, i cili duhet t’ia komunikojë, me shkrim, këtë person apo grup personash, Sekretariatit Teknik të KRRT-së, pranë zyrës dhe seksionit urbanistik përkatës në rreth, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të punimeve” duke ngarkuar me përgjegjësi titullarin e Bashkisë Shijak Z. E.A, si dhe në kundërshtim me kontratën nr. 5086/1 prot, datë 25.08.2021 për kolaudimin e objektit, duke ngarkuar me përgjegjësi kolaudatorin e objektit BOE “K.& C.” Shpk & “M.” Shpk.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje ndërtimi nr. 6480, datë 05.11.2021 dhe Leje Infrastrukturore me nr. 721, datë 05.11.2021. Ky veprim është në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” Neni 39, “Leja e ndërtimit”.

Në dosjen e zbatimit administrohet Oponenca Teknike, në përputhje me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga ing. V.Gj. në vitin 2020 dhe është miratuar nga Bashkia Shijak.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 09.11.2021, dhe kanë përfunduar me datë 09.01.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentet për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

- Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve me nr.8439 prot., datë 14.12.2022, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, është hartuar procesverbali për ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 20,379,774 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 13,465,296 lekë pa TVSH, duke përdorur edhe fondin rezervë në vlerën prej 5,762,366.2 lekë pa TVSH.

Nga verifikimi në terren i objektit, konstatohet se shtresat asfaltike të realizuara për mbulimin e kanalit, përgjithësisht janë të dëmtuara. Për sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstrukcion i tubacionit të dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V = 2000 m3 Shijak, rrjet shpërndarës fshati Maminas – Kareç- Bilalas – Karpen - Bodinak”, Bashkia Shijak				
14.Lidhja e kontratës Nr. 5086 prot datë 25.08.2021	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 247,129,485.5 lekë BOE fitues “K K” Shpk & “K” Shpk		16.Likuiduar deri dt 11.04.2023, 205,000,000 lekë	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 247,129,124.4 lekë -Vlera pa tvsh 205,940,937 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 180 ditë , Zbatuar 427 ditë. Fillimi punimeve: 09.11.2021 Përfundimi punimeve : 09.01.2023		19. Zgjatja e kontratës Amendamenti nr 1943/2 prot, datë 09.05.2022, shtyrje 90 ditë Amendamenti nr 4367 prot, datë 09.08.2022, shtyrje 150 ditë	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “N.E” Shpk	Licenca Nr: MK. 2498/1	Kontrata me nr 5086/1 prot, datë 25.08.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve BOE “K & C” & “M.” Shpk	Licenca Nr: MK 3597	Kontrata nr. 2600/4 prot., datë 01.06.2023	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Nuk ka	23.Akt i marrjes në dorëzim Nuk ka			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **276,320 lekë pa tvsh**.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 276,320 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Titulli i Gjetjes: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstrukcion i tubacionit të dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V =

2000 m³ Shijak, rrjet shpërndarës fshati Maminas – Kareç- Bilalas – Karpen - Bodinak”, Bashkia Shijak, nga zbatuesi i punimeve BOE “K.K” Shpk & “K.” Shpk, për zërat e punimeve 1 dhe 3+4.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Prerje asfalti” dhe “Shtresë binderi 6 cm + Shtresë asfaltobetoni 4 cm”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5086 prot datë 25.08.2021.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5086/1 prot, datë 25.08.2021.

Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Shijak.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

Rëndësia: E ulët

Rekomandime: Nga Bashkia Shijak të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 276,320 lekë pa tvsh nga BOE “K.K” Shpk & “K.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5086 prot datë 25.08.2021, me objekt “Rikonstrukcion i tubacionit të dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V = 2000 m³ Shijak, rrjet shpërndarës fshati Maminas – Kareç- Bilalas – Karpen - Bodinak”, Bashkia Shijak, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** shoqëria “N. E.” shpk nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”

2) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5086/1 prot, datë 25.08.2021.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. N.Gj me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

2. “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për qytetin Shijak”, Bashkia Shijak

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 5878 prot datë 27.07.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Shijak, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z.E.A dhe BOE “K.K” Shpk me përfaqësues z.V.P, me licencë profesionale NZ 4304/15 & “K.” Shpk me përfaqësues Z.Q.K, me licencë profesionale NZ 4901/13. Vlera e kontratës është 331,619,838.3 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 300 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit. Në dosje rezulton të jetë hartuar amendamenti i kontratës me nr. 3064/2 prot, datë 27.05.2021, i cili bën shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 150 ditë nga data e nënshkrimit të amendamentit. Në dosje nuk administrohet asnjë kërkesë apo relacion teknik mbi shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 5878/1 prot, datë 27.07.2020, është lidhur kontrata me OE “G.B C.E” Shpk, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2812/4 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 3,738,628 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, në dosje administrohet kontrata me nr. 2599/3 prot., datë 26.05.2023, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi Ing. M.K PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1200/4, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 466,398 lekë pa TVSH.

Deri në datën e mbajtjes së këtij aktkonstatimi, objekti nuk është kolauduar. Ky mosveprim është në kundërshtim me UKM Nr.3, datë 15.2.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, kreu II, pika 2, sipas të cilës “*Kolaudatori ose grupi i kolaudimit caktohet nga investitori, i cili duhet t’ia komunikojë, me shkrim, këtë person apo grup personash, Sekretariatit Teknik të KRRT-së, pranë zyrës dhe seksionit urbanistik përkatës në rreth, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të punimeve*” duke ngarkuar me përgjegjësi titullarin e Bashkisë Shijak z. E.A, si dhe në kundërshtim me kontratën nr. 2599/3 prot., datë 26.05.2023 për kolaudimin e objektit, duke ngarkuar me përgjegjësi kolaudatorin e objektit ing. M.K PF.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, nuk administrohet në dosje Leje ndërtimi, por vetëm Leje Infrastrukturore me nr. 286, datë 14.07.2020. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” Neni 39, “Leja e ndërtimit” sipas të cilit “*1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.*”, pasi në këtë objekt është i përfshirë edhe ndërtimi i godinës së kapërderdhësit, si ndërtim i ri. Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi investitori, mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi i punimeve.

Në dosjen e zbatimit administrohet Oponenca Teknike, në përputhje me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga projektues ing. V.Gj në vitin 2020 dhe është miratuar nga Bashkia Shijak.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 27.07.2020, dhe kanë përfunduar me datë 15.12.2022.

Në dosjen teknike administrohet shkresa e sipërmarrësit të punimeve, protokolluar me nr. 6291 prot, datë 27.10.2021 “Kërkesë për lirim të sheshit të ndërtimit”, në të cilën evidentohen pengesat në linjën e luginës, nga pik 8 – pik. 37, si dhe në zonat e ndërtimeve të reja dhe kërkohet lrimi i sheshit. Gjithashtu administrohet edhe shkresa e sipërmarrësit, protokolluar me nr. 7203/1, datë 10.11.2022, me anë të të cilës njoftohet rifillimi i punimeve.

- Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve me nr. 4580 prot., datë 27.07.2021, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, është hartuar procesverbali për ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 26,598,609 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 13,465,296 lekë pa TVSH, duke përdorur edhe fondin rezervë në vlerën prej 13,115,866.6 lekë pa TVSH.

- Nga verifikimi i projektpreventivit të azhurnuar, rezulton se është ndryshuar skema e sistemit SCADA, pa miratimin e projektuesit. Ky ndryshim mbart riskun që sistemi i instaluar të jetë më i ekspozuar ndaj avarive dhe të mos ketë funksionim normal. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi i punimeve.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditari të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për qytetin Shijak”, Bashkia Shijak				
14.Lidhja e kontratës Nr. 5878 prot datë 27.07.2020	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 331,619,838.3 lekë BOE fitues “K.K” Shpk & “K.” Shpk		16.Likuiduar deri dt 13.07.2022, 313,973,950 lekë	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 247,129,124.4 lekë -Vlera pa tvsh 205,940,937 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 300 ditë , Zbatuar 502 ditë. Fillimi punimeve: 27.07.2020 Përfundimi punimeve : 15.12.2022		19. Zgjatja e kontratës Amendamenti nr 3064/2 prot, datë 27.05.2021, shtyrje 150 ditë	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “G.B .C.E” Shpk	Licenca Nr: MK. 2812/4	Kontrata me nr 5878/1 prot, datë 27.07.2020	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve Ing. M.K PF	Licenca Nr: MK 3597	Kontrata nr. 2599/3 prot., datë 26.05.2023	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Nuk ka	23.Akt i marrjes në dorëzim Nuk ka		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **606,900 lekë pa tvsh.**

Tabela nr. 1

	Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
								Vol.	Vlera
1	7	Heqje pllaka trotuari	m ²	300	1530	1530	1173	357	107,100
2	8	Shtresë me pllaka granili me bojë 30x30 cm	m ²	1400	1530	1530	1173	357	499,800
Total									606,900

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Rikonstruksion pjesor i tubave të gërmimit

1. Zëri 7. Heqje pllaka trotuari. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 880 m². Në preventivin e rishikuar ky zë pune figuron në sasinë 1530 m². Në situacionin përfundimtar dhe librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1530 m², i detajuar sipas nyjeve në gjatësinë e tubacionit me D50 mm dhe D40 mm, me gjerësi 0.9 m, si dhe 763 ml lidhje familjare me gjerësi 1.5 m. Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se gjerësia e kanalit për lidhjet familjare duhet të ishte marrë me gjerësinë që është marrë për tubat me DN 40 mm dhe DN 50 mm. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 1173 m², ose 357 m² më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e kësaj diference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Zëri 8. Shtresë me pllaka granili me bojë 30x30 cm. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 880 m². Në preventivin e rishikuar ky zë pune figuron në sasinë 1530 m². Në situacionin përfundimtar dhe librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1530 m², i detajuar sipas nyjeve në gjatësinë e tubacionit me D50 mm dhe D40 mm, me gjerësi 0.9 m, si dhe 763 ml lidhje familjare me gjerësi 1.5 m. Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se gjerësia e kanalit për lidhjet familjare duhet të ishte marrë me gjerësinë që është marrë për tubat me DN 40 mm dhe DN 50 mm. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 1173 m², ose 357 m² më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e kësaj diference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 606,900 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Titulli i Gjetjes: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për qytetin Shijak”, Bashkia Shijak, nga zbatuesi i punimeve BOE “K.K” Shpk & “K.” Shpk, për zërat e punimeve 7 dhe 8.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Heqje pllaka trotuar” dhe “Shtresë me pllaka granili me bojë 30x30 cm”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5878 prot datë 27.07.2020.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5878/1 prot, datë 27.07.2020.

Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Shijak.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Shijak të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 606,900 lekë pa tvsh nga BOE “K.K” Shpk & “K.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5086 prot datë 25.08.2021, me objekt “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për qytetin Shijak”, *Bashkia Shijak*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** shoqëria “G.B.C.E” shpk nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

3) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”

4) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5878/1 prot, datë 27.07.2020.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. G.B me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

2.5 Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit me nr. 430/1 prot, datë 19.05.2023, me objekt: “**Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit**”, prej datës 01.01.2022 deri më 31.12.2022, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Dokumentacioni në sistemin “E leje”;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e financës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë juridike;
- Dokumente të tjera nga arkiva, etj

Bashkia Shijak nuk e ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit. Këto dokumenta janë në proces hartimi.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.
2. Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik.
3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.
4. Dhënia e Çertifikatës së Përdorimit.

LEJET E NDËRTIMIT DHE ZHVILLIMIT PËR PERIUDHËN 01.01.2022 - 31.12.2022

Referuar të dhënave të sistemit elektronik *e-lejet* për Bashkinë Shijak, rezulton se për afatin e auditimit **01.01.2022 deri në 31.12.2022**, ka pasur **193 aplikime** në sistem për leje të ndryshme si: leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistues, çertifikata përdorimi, etj., përkatësisht 45 aplikime për leje

zhvillimi, 22 për leje ndërtimi (leje ndërtimi për objekte të reja me sipërfaqe më të madhe ose më të vogël se 250 m², shtesa në objekte ekzistuese me sipërfaqe më të madhe ose më të vogël se 250 m²), 12 çertifikata përdorimi, 13 shtyrje afati të përfundimit të punimeve, 59 deklarata paraprake për kryerje punimesh, 1 leje për ndryshim funksioni, 5 rikonstruksione dhe 4 leje për ndryshim projekti gjatë ndërtimit, të evidentuara në tabelën përmbledhëse në **Aneksin 1**.

Aneksi 1

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Leje zhvillimi	45	26	19
Leje ndërtimi mbi 250m ²	10	8	2
Leje ndërtimi deri 250m ²	9	8	1
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	59	19	40
Rikonstruksion	5	3	2
Çertifikatë përdorimi	12	7	5
Shtesë në objekt ekzistues deri në 250 m ²	1	0	1
Shtesë në objekt ekzistues më e madhe se 250 m ²	2	2	0
Ndryshim projekti gjatë zbatimit	4	4	0
Ndryshim funksioni	1	1	0
Njoftim fillim punimesh	32	27	5
Shtyrje afati leje ndërtimi	13	1	12
Leje infrastructure	0	0	0

Përpunoi: Grupi i auditimit

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPTSHIP e Bashkisë Shijak, leje për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m² janë miratuar **8 leje**, leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m² janë miratuar **2 leje**, leje ndërtimi për ndërtim të ri deri në 250 m² janë miratuar **8 leje**, janë miratuar gjithashtu **7 çertifikata përdorimi**, të pasqyruara në tabelën e mësipërme.

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e mëposhtme të lejeve të ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m², si dhe çertifikatat e përdorimit:

Nr.	Objekti	Zhvilluesi	Data e lëshimit të lejes	Preventivi
1	Godinë industriale 2 kat + godinë industriale 1 + 2 kat + vendroje + kabinë elektrike dhe mur rrethues", me adresë Xhafzotaj, Shijak	z. I.Xh, z. M.Xh , znj. V.Xh, znj. F.N	06.10.2022	311,520,373
2	Leje ndërtimi për objekt 2 kat me funksion zyra për administratë, magazinë e përpunimit të produkteve fruta – perime 1 kat, agrofrigorifer 1 kat dhe mure rrethues, me adresë Koxhaj, Shijak	z. J.A	12.10.2022	83,562,029
3	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe më të madhe se 250 m ² për shtesë anësore	A. shpk	26.08.2022	79,704,211

	1 kat në kaponin ekzistues 1 kat, me adresë Bilalas, Shijak.			
4	Leje ndërtimi për godinë industriale 1 kat, gabinë elektrike dhe vendroje, në Xhafzotaj, Shijak.	Zhvillues: D. Sh, M.Sh, Investitor: SH. T. SH.P.K	15.06.2022	77,180,420
5	Leje ndërtimi për kaponon industrial 1 kat, Xhafzotaj, Shijak	H.S SH.P.K.	28.10.2022	61,783,717.6
6	Çertifikatë përdorimi për struktura banimi 1 kat, Shijak	P. D	12.05.2022	

Në lidhje auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, vërehen parregullsitë si më poshtë:

Titulli i gjetjes 1:	Mosrespektimi i kondicioneve urbane.
Situata:	<p>Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në dy raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, më konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për objektin “Godinë industriale 2 kat + godinë industriale 1 + 2 kat + vendroje + kabinë elektrike dhe mur rrethues”, konstatohet se objekti nuk respekton distancat urbane nga trupi i rrugës së propozuar, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 153, datë 07.04.2000, “Për miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, Neni 25, “Brezat e rezervuar jashtë qendrave të banuara (neni 16 i Kodit Rrugor)”. - Për objektin “Objekt 2 kat me funksion zyra për administratë, magazinë e përpunimit të produkteve fruta – perime 1 kat, agrofrigorifer 1 kat dhe mure rrethues, konstatohet se objekti nuk respekton intensitetin maksimal të lejuar, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 283, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e tipave, rregullave...”, pika 10, kreu II.b, “Rregulla dhe kritere të veçanta”, gjithashtu aksesimi për në pronë është i paqartë, në kundërshtim me Ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 45.
Kriteri:	<p>Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - VKM nr. 153, datë 07.04.2000, Neni 25. - VKM nr. 283, datë 01.04.2015, pika 10, kreu II.b. - Ligji 107/2014, i ndryshuar, Neni 45.
Ndikimi/Efekti:	Mosrespektimi i parametrave urban, si distanca nga trupi i rrugës dhe intensiteti maksimal i lejuar ndikojnë dhe cenojnë zhvillimin e kontrolluar urban, standardet higjeno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPTSHIP Shijak

Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga DPTSHIP dhe Bashkia Shijak të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret mbi të cilat ky institucion funksionon.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. E. A**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Shijak;
- **Znj. J.G**, në funksionin e drejtorit të DPTSHIP;
- **Z.B.T**, në funksionin e specialistit pranë DPTSHIP;
- **Z. R.Sh**, në funksionin e gjeodetit pranë DPTSHIP;
- **Znj. A.B**, në funksionin e juristit pranë DPTSHIP;

Titulli i gjetjes 2:	Plani i rilevimit nuk është i detajuar me të gjitha detajet e nevojshme.
Situata:	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në pesë raste nuk janë respektuar kriteret e hartimit të plani të rilevimit, më konkretisht: <ul style="list-style-type: none"> - Për objektin “Godinë industriale 2 kat + godinë industriale 1 + 2 kat + vendroje + kabinë elektrike dhe mur rrethues”; (nuk jep të dhëna mbi rrugët dhe gjerësitë e tyre). - Për objektin “Objekt 2 kat me funksion zyra për administratë, magazinë e përpunimit të produkteve fruta – perime 1 kat, agrofrigorifer 1 kat dhe mure rrethues”; (nuk jep të dhëna mbi rrugët dhe gjerësitë e tyre). - Për objektin “Shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2 për shtesë anësore 1 kat në kapononin ekzistues 1 kat”; (nuk jep të dhëna mbi kanalën vaditës në lindje). - Për objektin “Godinë industriale 1 kat, gabinë elektrike dhe vendroje”; (nuk jep të dhëna mbi parcelat kufitare). - Për objektin “Kapanon industrial 1 kat”; (nuk jep të dhëna mbi rrugët dhe gjerësitë e tyre).
Kriteri:	Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: <ul style="list-style-type: none"> - VKM nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, Neni 10.
Ndikimi/Efekti:	Mangësitë në dokumentin e rilevimit topografik ndikojnë në moskrijimin e sigurisë së nevojshme se objekti në zhvillim është konform të gjitha kondicioneve ligjore.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPTSHIP Shijak
Rëndësia:	E lartë

Rekomandime:	Nga DPTSHIP Shijak të merren masa për të kërkuar plotësimin e të gjitha kritereve të nevojshme për hartimin e dokumentit të rilevimit topografik, për të gjitha ato raste që do të pajisen me leje ndërtimi / zhvillimi.
---------------------	--

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. E.A.**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Shijak;
- **Znj. J.G.**, në funksionin e drejtorit të DPTSHIP;
- **Z.B.T.**, në funksionin e specialistit pranë DPTSHIP;
- **Z.R.SH.**, në funksionin e gjeodetit pranë DPTSHIP;
- **Znj.A.B.**, në funksionin e juristit pranë DPTSHIP;
- **Z.E.V.**, në funksionin e specialistit pranë DPTSHIP;

Titulli i gjetjes 3:	Nuk është kërkuar mendimi i të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, si dhe nuk është respektuar mendimi i tyre.
Situata:	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në katër raste nuk është kërkuar mendimi i të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit ose nuk është respektuar mendimi i tyre, më konkretisht: <ul style="list-style-type: none"> - Për objektin “Godinë industriale 2 kat + godinë industriale 1 + 2 kat + vendroje + kabinë elektrike dhe mur rrethues”; (nuk është kërkuar mendimi i OST) - Për objektin “Objekt 2 kat me funksion zyra për administratë, magazinë e përpunimit të produkteve fruta – perime 1 kat, agrofrigorifer 1 kat dhe mure rrethues”; (nuk është kërkuar mendimi i OST, si dhe nuk është respektuar mendimi i MBZHR) - Për objektin “Shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2 për shtesë anësore 1 kat në kapononin ekzistues 1 kat”; (nuk është kërkuar mendimi i OST) - Për objektin “Kapanon industrial 1 kat”; (nuk është kërkuar mendimi i OST) Për të gjitha rastet e sipërcituara, nuk është kërkuar mendimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), në një rast nuk është respektuar mendimi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR).
Kriteri:	Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: <ul style="list-style-type: none"> - VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 10/1.
Ndikimi/Efekti:	Miratimi i lejeve të ndërtimit në mungesë të mendimit të të autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, duke mos respektuar mendimin e tyre, krijon kushte të favorshme për një zhvillim të pakontrolluar, duke cenuar zhvillimin e kontrolluar urban, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPTSHIP Shijak
Rëndësia:	E lartë

Rekomandime:	Nga DPTSHIP Shijak të merren të gjitha masat për marrjen dhe respektimin e mendimit dhe vendimeve të të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.
---------------------	--

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z.E.A**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Shijak;
- **Znj. J.G**, në funksionin e drejtorit të DPTSHIP;
- **Z.B.T**, në funksionin e specialistit pranë DPTSHIP;
- **Z.R.Sh**, në funksionin e gjeodetit pranë DPTSHIP;
- **Znj.A.B**, në funksionin e juristit pranë DPTSHIP;

Titulli i gjetjes 4:	Në asnjë rast, objektet e miratuara me leje ndërtimi, nuk janë pajisur me vërtetim për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen.
Situata:	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në asnjë rast, objektet e miratuara me leje ndërtimi, nuk janë pajisur me vërtetim për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 1162, datë 24.12.2020 , “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi”. Në vetëm dy raste, aplikanti dhe subjekti zhvillues kanë dorëzuar studimin sizmik dhe gjeologjik, së bashku me dokumentacionin shoqërues.
Kriteri:	Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: VKM nr. 1162, datë 24.12.2020 , “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi”.
Ndikimi/Efekti:	Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në lidhje me detyrimin e subjekteve zhvilluese për të përpiluar dhe dorëzuar pranë DPTSHIP, nëpërmjet sistemit e-lejet, dokumentacionin e nevojshëm për pajisje me vërtetim risku, ndikon në garantimin e qëndrueshmërisë së strukturës dhe bazamentit ku do të mbështetet.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPTSHIP Shijak
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga DPTSHIP Shijak të merren masa për të kërkuar dokumentacionin e parashikuar në ligj, për të gjitha rastet që ky ligj parashikon, deri në pajisjen e subjekteve me vërtetim risku sipas shtojcave, bashkëlidhur vendimit.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z.E.A**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Shijak;
- **Znj.J.G**, në funksionin e drejtorit të DPTSHIP;
- **Z.B.T**, në funksionin e specialistit pranë DPTSHIP;
- **Z.R.Sh**, në funksionin e gjeodetit pranë DPTSHIP;

- Znj.A.B, në funksionin e juristit pranë DPTSHIP.

Titulli i gjetjes 5:	Projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues.
Situata:	<p>Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 4 rastet e audituara, projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues, më konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për objektin “Godinë industriale 2 kat + godinë industriale 1 + 2 kat + vendroje + kabinë elektrike dhe mur rrethues”: mungon dokumenti i regjistrimit në QKB dhe/ose ekstrakti historik tregtar për të gjithë subjektet që kanë hartuar projektet ndërtimore; mungon projekti i instalimeve të ngrohje – ftohjes. - Për objektin “Objekt 2 kat me funksion zyra për administratë, magazinë e përpunimit të produkteve fruta – perime 1 kat, agrofrigorifer 1 kat dhe mure rrethues”: mungon dokumenti i regjistrimit në QKB dhe/ose ekstrakti historik tregtar për të gjithë subjektet që kanë hartuar projektet ndërtimore(përveç ing. konstruktiv); mungon raporti i VNM-së, studimi sizmik dhe gjeologjik; - Për objektin “Shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2 për shtesë anësore 1 kat në kapononin ekzistues 1 kat”: mungon QKB ose ekstrakti historik (përveç projektit arkitektonik); - Për objektin “Godinë industriale 1 kat, gabinë elektrike dhe vendroje”: mungon QKB ose ekstrakti historik për arkitektin, licenca për studimin gjeologjik, mungon H-VAC.
Kriteri:	<p>Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - VKM nr. 943, datë 28.12.2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 759...”, Neni 25, “Detyrat e subjekteve të licencuara”, pika 1, nënpika ç). - VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 15, pika 1, nënpika e), ë), g); pika 1/1, nënpika iii. - Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011, Neni 7, pika 1. - VKM nr. 1162, datë 24.12.2020, pika 1, shtojca 1.
Ndikimi/Efekti:	Mospërfshirja e vërtetimeve të regjistrimit në sistemin tatimor, për të gjithë subjektet të cilat kanë hartuar projektet ndërtimore, si dhe mangësitë në projektin ndërtimor, ndikojnë në cilësinë dhe garatimin e ndërtimeve sipas standarteve, kushteve higjeno-sanitare dhe të sigurisë, nga subjekte të cilat duhet të plotësojnë kriteret e ushtrimit të profesionit, sipas legjislacionit në fuqi.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPTSHIP Shijak
Rëndësia:	E lartë

Rekomandime:	Nga DPTSHIP Shijak të merren masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi, vërtetimet e regjistrimit në sistemin tatimor të të gjithë hartuesve të projekteve teknike, si dhe të mos miratojnë asnjë leje ndërtimi me mangësi në projektin ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij.
---------------------	---

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z.E.A**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Shijak;
- **Znj.J.G**, në funksionin e drejtorit të DPTSHIP;
- **Z.B.T**, në funksionin e specialistit pranë DPTSHIP;
- **Z.R.Sh**, në funksionin e gjeodetit pranë DPTSHIP;
- **Znj.A.B**, në funksionin e juristit pranë DPTSHIP;

Titulli i gjetjes 6:	Mungojnë vërtetimet se subjektet zhvilluese nuk kanë detyrime të papaguara ndaj OSHEE, UK dhe DTTV.
Situata:	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 2 raste të audituara, mungojnë vërtetimet se subjektet zhvilluese nuk kanë detyrime të papaguara ndaj OSHEE, UK dhe DTTV, më konkretisht: - Për objektin “Godinë industriale 1 kat, gabinë elektrike dhe vendroje”: mungojnë vërtetimet se nuk ka detyrime ndaj OSHEE, UK-Shijak dhe Drejtorisë së Tatim Taksave vendore; - Për objektin “Kapanon industrial 1 kat”: mungojnë vërtetimet se nuk ka detyrime ndaj OSHEE dhe Drejtorisë së Tatim Taksave vendore.
Kriteri:	Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: - VKM nr. 408, datë 13.5.2015 , Neni 26, pika 3, nënpika d) dhe dh).
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e vërtetimeve të detyrimeve të papaguara cenon masat të cilat legjislacioni ka parashikuar, mbi ato subjekte të cilat kanë të drejtën e ushtrimit të aktivitetit.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPTSHIP Shijak
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Bashkia Shijak dhe DPTSHIP të marrë masa të mos miratojnë asnjë leje ndërtimi në mungesë të vërtetimeve që tregojnë se subjektet zhvilluese nuk kanë detyrime të papaguara ndaj OSHEE, UK dhe DTTV.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z.E.A**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Shijak;
- **Znj.J.G**, në funksionin e drejtorit të DPTSHIP;
- **Z.B.T**, në funksionin e specialistit pranë DPTSHIP;
- **Z.R.SH**, në funksionin e gjeodetit pranë DPTSHIP;

- **znj.A.B**, në funksionin e juristit pranë DPTSHIP;
- **z. E.V**, në funksionin e specialistit pranë DPTSHIP;

Titulli i gjetjes 7:	Tipologjia e objektit në zhvillim nuk është në përputhje me zërin kadastral.
Situata:	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 2 raste të audituara, tipologjia e objektit në zhvillim nuk është në përputhje me zërin kadastral, më konkretisht: - Për objektin “Godinë industriale 1 kat, gabinë elektrike dhe vendroje”: zhvillohet objekt industrial në tokë arë; - Për objektin “Kapanon industrial 1 kat”: zhvillohet objekt industrial në tokë arë.
Kriteri:	Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: - VKM nr. 283, datë 01.04.2015 , paragrafi I.
Ndikimi/Efekti:	Zhvillimi i objekteve në zona me përdorim të ndryshëm nga ai i parashikuar, dëmton destinacionin e tokës, si dhe ndikon në zhvillimin e kontrolluar të territorit.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPTSHIP Shijak
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Bashkia Shijak dhe DPTSHIP të marrë masa të mos miratojë asnjë leje ndërtimi, ku zëri kadastral nuk i përshtatet tipologjisë së zhvillimit.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z.E.A**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Shijak;
- **Znj.J.G**, në funksionin e drejtorit të DPTSHIP;
- **Z.B.T**, në funksionin e specialistit pranë DPTSHIP;
- **Z.R.Sh** në funksionin e gjeodetit pranë DPTSHIP;
- **Znj.A.B**, në funksionin e juristit pranë DPTSHIP;
- **Z.E.V**, në funksionin e specialistit pranë DPTSHIP;

Titulli i gjetjes 8:	Dokumentacioni i nevojshëm për pajisje me çertifikatë përdorimi nuk është i plotë.
Situata:	Nga auditimi i procedurave të miratimit të certifikatave të përdorimit u konstatua se në 1 rast, dokumentacioni i nevojshëm për pajisje me çertifikatë përdorimi nuk është i plotë, më konkretisht: - Për objektin “Çertifikatë përdorimi për struktura banimi 1 kat, Shijak”: mungon akti përkatës i menaxhimit të mbetjeve urbane, fotot e objektit të përfunduar nuk janë në të gjitha drejtimet.
Kriteri:	Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

	- VKM nr. 408, datë 01.04.2015 , 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 27/2.
Ndikimi/Efekti:	Mangësitë në dokumentacionin e nevojshëm për pajisje me çertifikatë përdorimi, ndikojnë në mosdhënien e sigurisë së plotë se objekti është ndërtuar sipas kriterëve ligjore, duke cenuar standartet e zhvillimit të kontrolluar, ato të mjedisit, sigurisë dhe higjeno-sanitare.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPTSHIP Shijak
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Bashkia Shijak dhe DPTSHIP të marrë masa të mos miratojë asnjë çertifikatë përdorimi deri në plotësimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z.E.A**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Shijak;
- **Znj.J.G**, në funksionin e drejtorit të DPTSHIP;
- **Z.R.SH**, në funksionin e gjeodetit pranë DPTSHIP;
- **Znj.A.B**, në funksionin e juristit pranë DPTSHIP;
- **Z.E.V**, në funksionin e specialistit pranë DPTSHIP;

Në lidhje me Projektraportin e auditimit të ushtruar në Bashkinë Shijak, dërguar me shkresën nr. 430/4 prot., datë 28.07.2023, me objekt: **“Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit”** prej datës 01.01.2022 deri më 31.12.2022, është observuar nga funksionarët e Bashkisë Shijak me anë të shkresës nr. 3917 prot; datë 29.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 430/5, datë 31.08.2023. Duke qenë se observacionit e projekt-raportit janë të njëjta me ato të akt-konstatimeve, observuar nga Z.E.A dhe funksionarët e DPTSHIP me anë të shkresës nr. 3167 prot., datë 03.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 430/3 prot; datë 04.07.2023, këto observacione nuk janë bërë pjesë e Raportit Përfundimtar të auditimit. Sa sipër, qëndrimi i grupit të auditimit mbetet i pandryshuar.

V. Zbatimi i ligjit dhe procedurës ligjore nga IMTV Bashkia Shijak si dhe shtrirja e efekteve të saj.

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit me Nr. 430/1 Prot., datë 19.05.2023, me objekt: **“Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV), prej datës 01.01.2022 deri më 31.12.2022**, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Auditim mbi plotësimin e kriterëve arsimore për punonjësit e IMTV, sipas përcaktimeve të Nenin 11 të **Ligjit nr. 183/2014 datë 24.12.2014**, *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit në ndërtimet e kundërligjshme”* etj.
- Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.
- Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV, për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.
- Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatimin në terren të kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit

Territorit të Bashkisë etj, sipas dispozitave ligjore në fuqi (Neni 81- *Inspektimi*, pika 3, të **Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009**, “*Për planifikimin e territorit*”, i ndryshuar, etj.).

Titulli i gjetjes 1: Mosplotësimi i kritereve arsimore i punonjësve të IMTV-së.

Situata: Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Shijak, 1 prej punonjësve të IMTV, nuk plotëson kriteret arsimore të parashikuara në Nenin 11 të **Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007**, i ndryshuar. Gjithashtu, e gjithë pjesa tjetër e strukturës së IMTV, ka arsimim në degën e drejtësisë, pra mungojnë punonjës me profil arsimimi teknik si ing. ndërtimi, arkitekturë, urbanistik, teknologjisë së materialeve, etj., si pasqyrohet edhe në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Lloji i Diplomimit	Data e fillimit	Data largimit
1	A.M	K/Inspektor	Drejtësi	12.02.2021	26.12.2022
2	J.K	Inspektor	Ing. agrare	06.07.2020	Në vazhdim
3	E.R	Inspektor	Drejtësi	11.05.2020	Në vazhdim
4	E.D	Inspektor	Drejtësi	01.12.2021	Në vazhdim
5	G.D	Shofer			Në vazhdim

Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007, i ndryshuar, Neni 11, “*Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit*”, ku përcaktohet se:

“Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit”.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e formimit profesional të nevojshëm për pozicionin e punës, ndikon në zbatimin e detyrës si inspektor në Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e Bashkisë Shijak.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga ana e Bashkisë Shijak të merren të gjitha masat për plotësimin e strukturës me inspektor të profileve teknike që kanë lidhje me ndërtimtarinë, sipas parashikimeve ligjore.

ër veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **Z. E.A.**, me detyrë Kryetari i Bashkisë Shijak.

Titulli i gjetjes 2: Mbajtja e procedurave për shkeljet e konstatuara jo – konform legjislacionit në fuqi.

Situata: Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga IMTV Bashkia Shijak, shprehemi se procedurat e mbajtura, ose jo, për konstatimet nga ana e IMTV jo gjithmonë kanë qenë sipas përcaktimeve dhe afateve që ligji përcakton, më konkretisht:

- Mungon proces verbali i konstatimit të kundërvajtjes për Z.R.A.

- Nuk është mbajtur proces verbali i pezullimit të punimeve në 2 raste, për Z.P.N dhe për Z.B.Xh, gjithashtu nuk është marrë vendim për gjobë dhe për prishje të objektit të jashtëligjshëm.

- Nga kontrolli i ushtruar në blloqet e vendimeve të prishjes së objekteve të jashtëligjshëm, rezulton se janë marrë 5 vendime, respektivisht me nr. serie 000181 – 000185, por nuk gjenden proces verbalet e konstatimit, vendimet e pezullimit, si dhe vendimet e masës administrative. Në katër rastet e ngelura të vendimeve të prishjes, në njërin prej tyre, nuk është marrë vendimi i dënimit me gjobë për kundërvajtësin.

Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007, i ndryshuar, Neni 5, pika b), ç), d), Neni 12 dhe 13.

Ndikimi/Efekti: Mosmbajtja e procedurave për konstatimin dhe ndëshkimin e shkeljeve në ndërtim ndikon në lejimin e një zhvillimi të pakontrolluar dhe informal.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e Bashkisë Shijak.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga ana e IMTV Bashkia Shijak të merren masat që për çdo rast, të respektohen procedurat sipas parashikimeve ligjore, në varësi të shkeljes së konstatuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **Z.E.A**, me detyrë Kryetari i Bashkisë Shijak.
 2. **Znj.A.M**, me detyrë kryeinspektore e IMTV, Bashkia Shijak.
 3. **Z.J.K**, me detyrë inspektor.
 4. **Z.E.R**, me detyrë inspektor.
 5. **Znj.E.D**, me detyrë inspektore.
-

Titulli i gjetjes 3: Niveli i ulët i arkëtimit të gjobave të vendosura nga IMTV për shkeljet e konstatuara.

Situata: Për gjobat e vendosura gjatë vitit 2022 dhe që nuk janë paguar brenda afateve ligjore, IMTV nuk ka ndjekur të gjitha procedurat e duhura ligjore me qëllim arkëtimin e tyre. Përkatësisht, IMTV nuk ka ndjekur hapat e parashikuar në ligj si procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit apo vendosje sekuestro mbi pasurinë. Referuar analizimit të të dhënave të paraqitura nga IMTV dhe DFB në Bashkinë Shijak, lidhur me gjobat e vendosura dhe arkëtimin e tyre rezulton se:

Në vitin 2022, janë vendosur në total 23 gjoba me vlerë 7,250,000 lekë nga të cilat janë paguar në mënyrë vullnetare 10 gjoba (1,600,000 lekë), për 9 vendime IMTV i është drejtuar Gjykatës Administrative për të kallëzuar penalisht kundërvajtësit, por në asnjë rast për nxjerrjen e titullit ekzekutiv për vjeljen e gjobës. Në asnjë nga rastet e mësipërme nuk është e dokumentuar vjelja e gjobës nëpërmjet pagës, si një nga mënyrat kur gjobat nuk paguhen vullnetarisht, referuar Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, Kreu V, Neni 31, pika 5. Niveli i arkëtimit të gjobave të vendosura nga IMTV është shumë i ulët, lidhur kjo me faktin se IMTV nuk ka ndërmarrë të gjitha hapat për arkëtimin e këtyre masave. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Kriteri: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, Neni 30, pika 4; Neni 31, pika 5.

Ndikimi/Efekti: Mangësitë në ndërmarrjet e hapave që ligji parashikon për vjeljen e gjobave të pa-arkëtuara, ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Shijak, gjithashtu zvogëlohet efekti ndëshkues ndaj shkelësve të ligjit.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e Bashkisë Shijak.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Shijak dhe IMTV të merren masa për kryerjen e të gjitha procedurave që ligji parashikon, për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha masave administrative të vendosura nga IMTV.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **Z. E.A.**, me detyrë Kryetari i Bashkisë Shijak.

2. **Znj.A.M.**, me detyrë kryeinspektore e IMTV, Bashkia Shijak.

Titulli i gjetjes 4: Mosrespektimi i afateve kohore mbi mbajtjen e procedurave për ndëshkimin e kundërvajtësit.

Situata: Në 8 raste nuk është respektuar afati 10 ditor për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, pasi është mbajtur proces verbal i konstatimit, kjo në kundërshtim me **Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007**, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, Neni 13. Ky veprim ndëshkohet sipas përcaktimeve të Nenit 15, pika 3, të po këtij ligji. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar, Neni 13 dhe Neni 15, pika 3.

Ndikimi/Efekti: Shkelja e afateve kohore për marrjen e vendimeve pasuese të proces verbalit të konstatimit, ndikon në realizimin e detyrave të funksionarëve të inspektoriatit, sipas përcaktimeve ligjore, si dhe ndikon në ndëshkimin në kohë të kundërvajtësve.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e Bashkisë Shijak.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Shijak dhe IMTV të merren masa për respektimin e të gjitha afateve kohore në lidhje me mbajtjen e procedurave përkundrejt kundërvajtësve, sipas përcaktimeve ligjore. Gjithashtu, të ndiqen procedurat ligjore ndaj funksionarëve përgjegjës për shkeljen e afateve të sipërcituara, sipas parashikimeve ligjore.

Lidhur me gjetjet e mësipërme, nuk është observuar nga ana e IMTV dhe Bashkisë Shijak.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **Z.E.A.**, me detyrë Kryetari i Bashkisë Shijak.

2. **Znj.A.M.**, me detyrë kryeinspektore e IMTV, Bashkia Shijak.

Titulli i gjetjes 5: Vendosja e masave administrative jo në përputhshmëri me përcaktimet ligjore.

Situata: Në lidhje me vendosjen e masave administrative dhe ndëshkimin me gjobë të kundërvajtësve të ligjit, konstatohet se në asnjë rast nuk është faktuar se vlera e masës administrative është e barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, si parashikohet në

Ligjin 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 52, “Kundërvajtjet administrative”, pika 1, nënpika e) dhe ë), si dhe pika 2 e po këtij neni, kjo me qëllim maksimizimin e të ardhurave nga vjelja e gjobave. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Kriteri: Ligji 107/2014, i ndryshuar, Neni 52, pika 1, nënpika e) dhe ë), pika 2.

Ndikimi/Efekti: Vendosja e e masave administrative jo në përputhshmëri me përcaktimet ligjore, ndikon në buxhetin e Bashkisë Shijak, nuk ndëshkon në mënyrë përpjestimore kundërvajtësit sipas shkeljeve të kryera, si dhe redukton efektin ndëshkues të këtyre masave.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Shijak dhe IMTV të merren masa për vendosjen e masave administrative në përputhshmëri me vlerën e investimit të kryer pa leje ose në kushtet e jashtëligjshmërisë, në të gjitha rastet kur kjo vlerë është e matshme, sipas përcaktimeve ligjore.

Lidhur me gjetjet e mësipërme, nuk është dërguar observacion nga ana e IMTV dhe Bashkisë Shijak.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj.A.M, me detyrë kryeinspektore e IMTV, Bashkia Shijak.

Titulli i gjetjes 6: Planet mujore të punës, të miratuara nga kryeinspektori, nuk janë hartuar në mënyrë periodike.

Situata: Në lidhje me planet mujore të punës që kryeinspektori duhet të hartojë dhe miratojë, konstatohet se nga auditimi i dokumentave të paraqitura nga IMTV Shijak për periudhën nën auditim, nuk u paraqitën planet mujore të punës së miratuar nga Kryeinspektori, përveç muajve Maj, Qershor, Shtator, Dhjetor, 2022. Planet e punës mujore të mësipërme janë të paprotokolluara.

Kriteri: Vendimi nr. 894, datë 04.11.2015, pika 1, nënpika b.ii).

Ndikimi/Efekti: Miratimi i planeve mujore nga kryeinspektori në mënyrë jo-periodike cenon efektivitetin e kontrollit të territorit nga ndërhyrjet abuzive.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e Bashkisë Shijak.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Shijak dhe IMTV të merren masa për hartimin dhe miratimin e planeve të punës në mënyrë periodike, çdo muaj.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj.A.M, me detyrë kryeinspektore e IMTV, Bashkia Shijak.

Titulli i gjetjes 7: Mungesë bashkëveprimi midis autoriteve vendore të kontrolli dhe mbrojtjes së territorit.

Situata: Në lidhje me bashkëveprimin që autoritet vendore të kontrolli dhe mbrojtjes së territorit duhet të kenë, konstatohet se IMTV dhe DPKZHT nuk kanë bashkëpunuar me njëra-tjetrën, IMTV duhet të kryejë kontrole mbi zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi për të kontrolluar nëse objekti po ndërtohet në përputhje me kërkesat e lejes së zhvillimit/të ndërtimit e të projektit teknik. Për periudhën nën auditim nga IMTV nuk u paraqitën akte kontrolli të miratuara nga Kryeinspektori për kontrollin e ushtruara në objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipër cituara dhe detyrat e Kryeinspektorit dhe inspektorëve të përcaktuara në Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Shijak.

Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar, Neni 12, pika 10; Ligji 107/2014, i ndryshuar, Neni 50, pika 2; Neni 51, pika 3.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e bashkëpunimit midis autoriteteve lokale të mbrojtjes së territorit rrit rrezikun e zhvillimit të ndërhyrjeve jo-të ligjshme dhe abuzive.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Shijak, DPKZHT dhe IMTV të merren masa për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, të informojnë njëra-tjetrën mbi aktivitetin e tyre, si dhe të kërkojnë asistencë në rastet kur vlerësohet e nevojshme.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj. A.M, me detyrë kryeinspektore e IMTV, Bashkia Shijak.

Titulli i gjetjes 8: IMTV nuk ka raportuar në mënyrë periodike çdo tre muaj pranë IKMT.

Situata: Në lidhje me të dhënat statistikore që IMTV duhet t'i japi IKMT-së çdo tre muaj, konstatohet se IMTV Bashkia Shijak nuk e ka përgatitur dhe raportuar këtë informacion. Në zbatim të përcaktimeve të **Ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007** “*Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme*”, i ndryshuar, IMTV Shijak ka për detyrë të raportojë në IKMT në mënyrë periodike mbi aktivitetin e tij, përkatësisht mbi gjobat e vendosura sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, mbi vendimet për pezullimin e punimeve, mbi vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundër-ligjshëm etj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se Kryeinspektori nuk ka përgatitur informacion periodik çdo tre muaj për masat e marra dhe nuk ka raportuar në IKMT në kundërshtim me përcaktimet ligjore sipërcituar.

Kriteri: **Ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007**, i ndryshuar, Neni 5, pika f).

Ndikimi/Efekti: Mungesa e raportimit pranë IKMT në mënyrë periodike çdo tre muaj cenon bashkërendimin ndërinstitucional, nuk respekton detyrimin e raportimit të institucioneve të linjës, si dhe efektivitetin e kontrollit të territorit nga këto struktura.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Shijak dhe IMTV të merren masa për hartimin e raportimeve çdo tre muaj mbi aktivitetin e IMTV, pranë IKMT.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj.A.M, me detyrë kryeinspektore e IMTV, Bashkia Shijak.

Titulli i gjetjes 9: IMTV nuk i ka dokumentuar të gjitha rastet e konstatimeve të shkeljeve dhe prishjeve të objekteve, me dokumentacion fotografik, si pjesë e relacionit përkatës, ku parashtrahet gjendja e konstatuar.

Situata: Në lidhje me dokumentimin fotografik të të gjitha rasteve ku konstatohet shkelje e ligjit dhe prishja e objekteve të jashtëligjshme, si pjesë integrale e relacionit përkatës, ku parashtrahet gjendja e konstatuar, detyrë kjo e inspektorëve të IMTV, parashikuar në Rregulloren e Organizimit dhe Funkcionimit të administratës së Bashkisë Shijak, konstatohet se për vitin 2022, IMTV e ka provuar mbajtjen e kësaj procedure vetëm në pesë raste.

Kriteri: Rregullore për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shijak dhe njërive administrative, Neni 15, pika 15.2.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e dokumentacionit fotografik të të gjitha rasteve ku konstatohet shkelje e ligjit dhe prishja e objekteve të jashtëligjshme, ndikon në plotësimin e dokumentacionit sipas rregullores, si dhe krijon hapsira vakante mbi vërtetësinë e konstatimit në terma afatgjatë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Shijak dhe IMTV të merren masa për krijimin e raporteve përkatëse nga ana e inspektorëve për të gjitha rastet e konstatuara, si dhe të përfshihet në këto raporte dokumentimi fotografik i shkeljes, si pjesë e raportit.

Në lidhje me Projektraportin e auditimit të ushtruar në Bashkinë Shijak, dërguar me shkresën nr. 430/4 prot., datë 28.07.2023, me objekt: “Zbatimi i ligjit dhe procedurës ligjore nga IMTV Bashkia Shijak si dhe shtrirja e efekteve të saj” prej datës 01.01.2022 deri më 31.12.2022, nuk është observuar nga funksionarët e Bashkisë Shijak.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **Z. E.A.**, me detyrë Kryetari i Bashkisë Shijak.
2. **Znj. A.M.**, me detyrë kryeinspektore e IMTV, Bashkia Shijak.
3. **Z. J.K.**, me detyrë inspektor.
4. **Z. E.R.**, me detyrë inspektor.
5. **znj. E.D** me detyrë inspektore.

2.6 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

Objekti i verifikimit është zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin e auditimit të mëparshëm dërguar në Bashkinë Shijak me Nr.260/16 Prot, Datë 05.10.2022.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkia Shijak **Nr. 430/1 Prot., Datë 19.05.2022, “Mbi auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2022– 31.12.2022”**, pika **7** e Programit të Auditimit, “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” rezultoi si më poshtë vijon:

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se janë rekomanduar nga KLSH janë lënë gjithsej **90** rekomandime, të grupuara në:

- **40** masa organizative;
- **4** masa shpërblim dëmi;
- **8** masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike në përputhje me parimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit të fondeve publike;
- **38** masa disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **40** masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, **18** janë zbatuar, **3** janë në proces zbatimi, **8** nuk janë zbatuar dhe 11 janë zbatuar pjesërisht.

-Për shpërblimin e dëmit janë lënë **4** rekomandime, të cilat janë **3** në proces zbatimi dhe **1** nuk është zbatuar.

-Për eliminimin e efekteve negative financiare janë lënë **8** rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht, **3** janë zbatuar, **5** nuk janë zbatuar.

-Për masa disiplinore janë lënë **38** rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat janë zbatuar plotësisht.

DREJTIMET E AUDITIMIT

Nga auditimi u konstatua se :

1. Me shkresën Nr.6249/6 Prot, datë 15.12.2022 “Kthim përgjigje për zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të KLSH, Bashkia Shijak ka respektuar afatin 20 ditor duke dërguar në KLSH, plan veprimin për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit Nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Shkalla e zbatimit: Ky detyrim ligjor është zbatuar në afat.

2. Bashkia Shijak nuk ka respektuar afatin prej 6-muajsh “Kthim përgjigje për zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të KLSH” në kundërshtim me ligjin Nr.154/2014 Datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 30 “Rekomandimet e KLSH dhe ecuria e zbatimit”.

Shkalla e zbatimit: Ky detyrim ligjor nuk është zbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm paraqitet si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë në nivelin “mjaftueshëm”, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si: Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara në sektorë të ndryshëm. Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara si dhe plan-veprimi për monitorimin e Sistemit MFK. E gjithë kjo procedurë është në kundërshtim me ligjin Nr.10296, Datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr.108, Datë 17.11.2016, Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Shijak e miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë, me shkresën Nr. 3989 Prot., Datë 11.11.2019 për vitin 2020 dhe shkresën Nr. 550Prot., Datë 19.09.2021 për vitin 2021.

1.1. Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Shijak, të merren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurohen programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Të hartohen dhe zhvillohen programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Të vendoset një sistem komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e

lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i Bashkisë Shijak për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 me shkresën Nr.873 Prot., Datë 18.12.2022 është miratuar me Urdhër të Titullarit, Nr.49, Datë 18.02.2022 “Ngritja e GMS dhe ekipeve të menaxhimit të programeve” dhe Urdhër i Brendshëm Nr.48, Datë 18.02.2022 “Për delegimin e detyrës së koordinimit të rriskut” me shkresë Nr.872 Prot., Dt.18.02.2022 por nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në Bashki në të gjitha nivelet e saj, pra mungon regjistri i riskut. Janë hartuar dhe zhvilluar programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit dhe nga Titullari me shkresë Nr.874 Prot., Dt.18.02.2022, është miratuar Urdhri Nr.50 Datë 18.02.2022 “Mbi zbatimin e ligjit Nr.10296, Datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, në Bashkinë Shijak” por, mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 është zbatuar pjesërisht.

2. Gjetje nga auditimi: KLSH ka konstatuar se në njësinë e auditimit të brendshëm, asnjë nga audituesit nuk është i çertifikuar dhe nuk ka eksperiencë pune, si dhe mungon trajnimi i tyre. Në dosjet e auditimeve të kryera mungojnë: letrat e punës së audituesve, si dhe vlerësimet e cilësisë. Në raportet e auditimit nuk janë përshkruar në mënyrë të plotë e të qartë gjetjet e konstatuara dhe nuk janë përcaktuar përgjegjësitë si dhe rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe nuk i referohen konkretisht çdo gjetjeje. Nuk janë kryer auditime të thelluara në sektorët me risk të lartë si prokurimet, planifikimi e zhvillimi i territorit, menaxhimi i aseteve, sektori i bujqësisë, burimet njerëzore, etj. Nuk është kontrolluar dhe dokumentuar si funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm në fusha të ndryshme të veprimtarisë së bashkisë dhe në njësitë e varësisë. Nuk ka program angazhimi për ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga auditimi i brendshëm. E gjithë kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, 20, me MAB të miratuar me Urdhërin nr. 100 të MFE, datë 25.10.2016 pika 2.6, nën-pika (c) dhe pika 3.5, kapitulli III, kapitulli IV, pikat 4.1.7 - 4.1.12, kapitulli IV, pika 4.1.1; kapitulli VI, pika 6.1 “Niveli i dokumentimit”; Kapitulli VI, I pika 7.1.1 dhe Dokumentet Standarte.

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve, përcaktimit të përgjegjësive si dhe formulimit konkret të rekomandimeve. Njësia e auditimit të brendshëm të kryejë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik. Të planifikohet dhe realizohet program angazhimi për ndjekjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen e objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i Bashkisë Shijak për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 struktura e Njesisë së AB nuk ka përcaktuar fushat më me risk në këtë institucion dhe nuk janë respektuar të gjitha proceset sipas Manualit të Auditit të Brendshëm. Sektori i Auditimit të

brendshëm gjatë vitit 2022 ka marrë masa për certifikimin dhe trajnimin e audituesve të rinj, për rritjen e aftësisë profesionale të tyre dhe gjithashtu janë në proces certifikimi të specialistëve të AB-së.

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 është zbatuar pjesërisht.

3. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2019, 2020 dhe 2021 referuar VKB-ve, rezulton se buxheti vjetor i çdo viti respektiv, nuk është miratuar me vendim të veçantë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 9 të Kreut I në Udhëzimin Nr.23, Datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore”; Bashkia Shijak nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh për t’i kushtuar rëndësi *programit 042* “Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia” në moszbatim të Ligjit nr. 9385/2005 “Për pyjet dhe kullotat” i ndryshuar me Ligjin nr.57/2020 neni 23 pika 3,5 dhe neni 34 pika 2; *për programet 051* “Menaxhimi i mbetjeve”, *programin 052* “Menaxhimi i ujërave të zeza” dhe *programin 062* “Shërbimi publik vendor” (veçanërisht ai urban), planifikimi në rënie i fondeve nga ana e Bashkisë tregon për një shërbim ku është cenuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj, përcaktuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 23/2,6,10, neni 26/1, neni 27/5 etj.

3.1. Rekomandimi: Në Bashkinë Shijak, Drejtoria Ekonomike dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të marrin masa për të miratuar me Vendim të veçantë në Këshillin Bashkiak Planin vjetor të buxhetit, të analizojnë çdo tregues të mos/realizimit të buxhetit vjetor dhe të tregojnë vëmendje për të planifikuar në buxhet fonde për ato programe që janë pjesë e strategjive kombëtare kryesisht të mjedisit, për të hartuar një plan të buxhetit vjetor dhe afatmesëm sa më real dhe në koherencë me nevojat dhe interesat e komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm rezulton se nga Drejtoria e Ekonomike dhe Grupi Menaxhimit Strategjik nuk ka marrë masa për miratimin me vendim të veçantë të VKB-së Planin Vjetor të Buxhetit.

Zbatimi: Rekomandimi 3.1 nuk është zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: 1. Referuar pasqyrave të realizimit të treguesve të buxhetit për secilin vit referuar akt rakordimeve me thesarin rezulton se niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varion në masën 43% deri 92.1%, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Shijak dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara;

2. Nga pasqyrat e realizimit të shpenzimeve të çdo treguesi buxhetor nga burimi i financimit, rezulton se vlera totale e tij ka ardhur në rritje, ndërsa po t’i referohemi zërave të veçantë, vlerat e tyre ndryshojnë nga viti në vit me trend në rënie. Përjashtim bën vetëm “Fonde të deleguara” që paraqitet në të njëjtat vlera.

3. Referuar pasqyrave të realizimi faktik të buxheteve sipas periudhave ushtrimore, nga auditimi rezultoi se Buxheti është planifikuar: *për vitin 2019* në vlerën 1,055,580 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 622,585 mijë lekë me një diferencë prej 432,995 mijë lekë; *për vitin 2020* është planifikuar në vlerën 2,437,648 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,659,663 mijë lekë me një diferencë prej 777,985 mijë lekë; Në këtë vit rezulton edhe vlera më e lartë e mosrealizimit; *për vitin 2021* është planifikuar në vlerën 2,248,457 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,932,240 mijë

lekë me një diferencë prej 316,217 mijë lekë. Fonde nga financime të huaja nuk ka pasur. Sa më sipër u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit të planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, rezulton se nga të ardhurat e veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2019, 2020 dhe 2021 të ketë mosrealizime;

4. Referuar evidencave dhe tabelave që iu vunë në dispozicion grupit të auditimit, rezulton se nga Bashkia Shijak për vitet 2019, 2020 dhe 2021 nuk është krijuar fond për emergjencat civile, duke mos zbatuar kështu Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 65/1;

5. Realizimi i investimeve të planifikuara paraqitet në nivele të ulëta, ku për vitin 2019 është realizuar me një diferencë prej 359,004 mijë lekë ose 29%; në vitin 2020 me një diferencë më të vogël në vlerë se viti 2019 prej 299,511 mijë lekë ose prej 43%; ndërsa në vitin 2021 me një diferencë më të vogël se dy vitet paraardhëse prej 116,063 mijë lekë ose 76.2%;

6. Referuar të dhënave në tabelën e të ardhurave të vet Bashkisë Shijak, rezulton se: *realizimi i të ardhurave* vjen duke u ulur dhe se *planifikimi i të ardhurave* ka ardhur duke u rritur nga viti në vit: me 4,132 mijë lekë nga 2019 në 2020; me 7,874 mijë lekë nga 2020 në 2021 ose me 52.5% më shumë.

4.1. Rekomandimi: Në Bashkinë Shijak, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk kanë marre masa për hartimin e një buxheti real si dhe nuk kanë kryer analiza në formë periodike mbi realizimet/mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Zbatimi: Rekomandimi 4.1 nuk është zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2020, të ardhurat nga 223,198,000 lekë të planifikuara janë realizuar në shumën prej 156,174,000 lekë ose 69.97 %, pra me një mosrealizim në shumën prej 67,024,000 lekë, i cili është thelluar edhe për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19. Kryesisht, ky mosrealizim përbëhet nga Taksa e ndërtesës - 4,993,000 lekë; Taksa e tokës bujqësore - 7,338,000 lekë; Taksa e ndikimit në infrastrukturë - 45,488,000 lekë; Tarifa e shërbimeve - 10,606,000 lekë.

Për vitin 2021, të ardhurat nga 230,936,000 lekë të planifikuara janë realizuar në shumën prej 159,495,000 lekë ose 69.1%, pra me një mosrealizim në shumën 71,441,000 lekë. Kryesisht, ky mosrealizim përbëhet nga Taksa e tokës bujqësore - 15,530,000 lekë; Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja - 47,105,000 lekë; Taksa e mjeteve të përdorura - 2,214,000 lekë; Tarifa e shërbimeve - 13,892,000 lekë.

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës

fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 54, “Raportimi financiar” nën-pika c, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b.

5.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak nuk ka marrë masa për zbatim të tij duke mos hartuar projekt/plan buxhetin, planifikimin dhe kontabilizimin e të ardhurave.

Zbatimi: Rekomandimi 5.1 nuk është zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Bashkinë Shijak, u konstatua se në lidhje me subjektet, detyrimet tatimore të të cilëve arkëtohen nga agjentët tatimorë, nuk është krijuar një bazë e plotë dhe e saktë të dhënash, ku të përcaktohet numri i subjekteve tatimpagues, lloji i detyrimeve të tyre, periudha e ushtrimit të veprimtarisë, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa subjekte janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, si dhe nuk është bërë asnjëherë rakordim me këta agjentë në lidhje me detyrimet e tyre ndaj Bashkisë Shijak, pavarësisht konfirmimit të arkëtimeve nga dega e Thesarit Shijak.

Sa më sipër, është në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare.

6.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Shijak, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak nuk ka marrë masa për krijimin e të dhënave për subjektet, tarifatat dhe taksat dhe nuk ka krijuar një regjistër për subjektet si dhe nuk ka kryer korrespondencë me institucionet për një proces sa më të saktë të objektit të rekomandimit si më lart.

Zbatimi: Rekomandimi 6.1 nuk është zbatuar.

- 7. Gjetje nga auditimi: 1.** Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Shijak, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF në Bashki, vlera është 3,333,757,720 lekë, ndërsa në totalin e Aktivit në PF në sistemin e Thesarit vlera është 2,992,785,725 lekë, me një diferencë prej 340,971,995 lekë më shumë në PF të Bashkisë Shijak. Në vijim, në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra, në PF në Bashki, vlera është 488,155,972 lekë, ndërsa në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra në PF në sistemin e Thesarit vlera është 172,782,052 lekë, me një diferencë prej 315,373,920 lekë më pak në PF në sistemin e Thesarit. Llogaria 520 “*Disponibilitete në Thesar*”, në PF në subjekt ka vlerën 286,520,157lekë, ndërsa në PF në sistemin e Thesarit ka vlerën 0. Për sa më sipër, këto llogari nuk pasqyrojnë vlerën e vërtetë.
- 2.** Nga auditimi, u konstatua se Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” në Bashkinë Shijak në datën 31.12.2020 përbëhet nga 16 studime e projektme në vlerën 61,651,348 lekë, të cilat i përkasin investimeve nga të ardhurat e veta të Bashkisë Shijak e cila ka prokuruar dhe lidhur kontratat e zbatimit për 6 projekte. Nga dokumentacioni në zyrën e urbanistikës, u konstatua se disponohen gjithsej 139 projekte, një pjesë e të cilave janë trashëguar nga ish komunat e bashkuara me Bashkinë Shijak. Këto projekte janë të painventarizuara dhe të pakontabilizuara.
- 3.** Gjendja e llogarisë 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*” në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 602,126,502 lekë duke u shtuar në vitin ushtrimor për 101,401,121 lekë nga vitit paraardhës. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 192,384,096 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.
- 4.** Gjendja e llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 38,877,609 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 66,311,229 lekë, me një shtesë në vlerën 27,433,620 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 38,238,078 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 28,073,151 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.
- 5.** Gjendja e llogarisë 215 “*Mjete transporti*” në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 45,102,001 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 47,999,056 lekë, me një shtesë në vlerën 2,897,055 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 25,551,223 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 22,447,833 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale. Gjithashtu, nga auditimi i zërave të veçantë të kësaj llogarie, u konstatua se mjetet e punës, si ekskavatorë, skrepa, etj., janë pasqyruar në mënyrë të gabuar në këtë llogari, pasi duhet të ishin pasqyruar në llogarinë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”.
- 6.** Gjendja e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 28,678,471 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 29,019,247 lekë, me një shtesë në vlerën 340,776 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 9,974,016lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 19,045,231 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale. Për sa më sipër, kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale.
- 7.** Nga verifikimi i regjistrave, u konstatua se për llogaritë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” dhe 215 “*Mjete transporti*”, paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit,

vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Shijak, të marrë masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet, saktësimet e gjendjeve të llogarive dhe rakordimet me Degën e Thesarit të jenë në bazë të shifrave reale, mbështetur në llogaritë analitike.

7.2. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

7.3. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”; 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”; 212 “Ndërtime e konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe 215 “Mjete transporti”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës.

7.4. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” duke plotësuar analizën e llogarive, ku të merren në konsideratë edhe vlerat e gjetura gjatë auditimit nga KLSH. Gjithashtu, gjatë vitin ushtrimor në vazhdim, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifatat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit”.

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimet **7.1;** **7.2** dhe **7.4** si më sipër Bashkia Shijak, nuk ka marr masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet, saktësimet e gjendjeve të llogarive, për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë dhe rakordimet me Degën e Thesarit të jenë në bazë të shifrave reale, mbështetur në llogaritë analitike si dhe nuk janë sistemuar të ardhurat e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifatat vendore sipas rekomadimeve lënë nga KLSH.

Ndërsa lidhur me rekomandimin **7.3**, nga Bashkia Shijak janë marr masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot dhe janë inventarizuar sipas llogarive përkatëse nr.210-215.

Zbatimi: Rekomandimi 7.1 nuk është zbatuar;

7.2 nuk është zbatuar;

7.3 është zbatuar pjesërisht;

7.4 nuk është zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumenteve financiare dhe verifikimi në faqen e internetit të QKB-së, u konstatua se Bashkia Shijak, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2021 paraqitet si:

- Aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Shijak Sh.a., me NUIS L.....P e cila është shoqëri aksionare me objekt “*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm...*”. Numri i aksioneve është 100 me vlerë nominale 35,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën **3,500,000 lekë**. Kjo shoqëri është themeluar në datën 07.11.2016.

- Aksionare me 11.6% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.a., me NUIS J.....V e cila është shoqëri aksionare me objekt “*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm...*”. Numri total i aksioneve është 446,968 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 446,968,000 lekë. Kjo shoqëri është themeluar në datën 30.08.2000. Bashkia Shijak zotëron 51848.2880 aksione me të drejtë vote, në vlerën totale **51,848,288 lekë**.

Për sa më sipër, llogaria 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*” nuk paraqet vlerën reale për shumën **55,348,288 lekë** (3,500,000 lekë nga Ujësjetllës Kanalizime Shijak Sh.a. dhe 51,848,288 lekë nga Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.a.), në kundërshtim me UMFE nr. 64 datë 22.07.2014 “*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar*”, me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “*Aktivet afatgjata materiale dhe Aktivet afatgjata jo materiale*” pikat 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “*Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*”.

8.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të shoqërive: **1.** “*Ujësjetllës Kanalizime Shijak Sh.a.*”, me NUIS L.....P, për 100% të aksioneve, në vlerën **3,500,000 lekë**; **2.** “*Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.a.*” Sh.a., me NUIS J61819502V, për 11.6% të aksioneve në vlerën **51,848,288 lekë**, si dhe regjistrimin e kapitalit aksionar të këtyre shoqërive prej **55,348,288 lekë** në debi të llogarisë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm nga Bashkia Shijak janë marrë masa për realizimin e tyre, në këshillin bashkiak është miratuar me vendim Nr.36 Datë 08.08.2022 “*Marrëveshja për krijimin e Shoqërisë Rajonale të Ujësjetllës Kanalizime Durrës*”, por nuk është përfunduar procesi i saktësimit, sistemimit dhe kontabilizimit të tij.

Zbatimi: Rekomandimi 8.1 zbatuar pjesërisht.

9. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 16,256,336 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 30,270,542 lekë ose me rritje në vlerën 14,014,206 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme dhe gjendjen e pullave që janë likuiduar në muajin janar të vitit 2022.

Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Shijak me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në llogarinë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*”, në sistemin e Thesarit vlera është 30,311,342, pra me një diferencë në vlerën 40,800 lekë.

Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të likuiduara plotësisht, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës, pavarësisht se nuk janë marrë të gjitha në dorëzim nga Bashkia Shijak, nuk është bërë zhblllokimi i garancisë dhe

fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuar në degën e Thesarit. Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së garancisë sipas objekteve ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kap II “Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të VKM nr. 3, datë 15.2.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2001 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publike” i ndryshuar pikat 42 – 50 të tij, UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuar.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak nuk janë marrë masa për ngritjen e komisioneve me specialistë të fushës për evidencë të cilësisë së punimeve, likuidimeve dhe marrjes në dorëzim të objekteve të përfunduara.

Zbatimi: Rekomandimi 9.1 nuk është zbatuar.

10. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2019-2021 janë lidhur dhe zbatuar 31 kontrata në vlerën totale 1,162,219,494 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Qeveria, FZHR dhe financime të huaja. Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t’u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizimit të aktivitetit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2020 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”. Për këto investime nuk janë kryer veprimet kontabël sipas fazave të kryerjes së veprimeve ekonomike.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Kreu I, “Të përgjithshme”, pika 8, Kreu II, “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të

mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, “*Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, pika 32.

10.1. Rekomandimi: Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llogarisë 520 “*Disponibilitete në thesar*” dhe në kredi të llogarisë 476 “*Të ardhura të caktuara për t’u përdorur*”.

Me konstatimin e shpenzimit, (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 “*Investime për aktive afatgjata materiale*” dhe në kredi të llogarisë 404 “*Furnitorë për investime*”.

Në momentin e pagesave të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 “*Furnitorë për investime*” dhe në kredi të llogarisë 520 “*Disponibilitete në thesar*”.

Në fund të vitit ushtrimor, për fondet e përdorura për investimet e papërfunduara/në proces, të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 “*Të ardhura të caktuara për t’u përdorur*”, në kredi të llogarisë 720 “*Grant korrent i brendshëm*” dhe në kredi të llogarisë 4342, “*Operacione me shtetin (të drejta)*” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.

Me përfundimin e investimit, të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizmi i aktivitet (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 “*Aktive afatgjata materiale*” dhe në kredi të llogarisë 231 “*Investime për aktive afatgjata materiale*”.

Me kapitalizmin e aktivitet, (për aktivitet e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 “*Të ardhura të caktuara për t’u përdorur*”, në kredi llogarisë 105 “*Grante të brendshme kapitale*” për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 “*Shtesa të fondit bazë*” dhe në debi të llogarisë 105 “*Grante të brendshme kapitale*” për vlerën e aktiveve të blera.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak për kontratat e mësipërme nuk ka kryer kontabilizimin e veprimeve ekonomike dhe të procedurave të tjera si më lart cituar.

Zbatimi: Rekomandimi 10.1 nuk është zbatuar.

11. Gjetje nga auditimi: 1. Në praktikat e Inventarizimit Fizik të aktiveve mungon Raporti përmbyllës hartuar dhe nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të Verifikimit Fizik të Inventarëve, në kundërshtim kjo me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*” Kapitulli IV pika 85/a, b, c;

2. Komisioni i Verifikimit Fizik të Inventarëve (aktiveve) përbëhet nga të njëjtët anëtarë për 2 (dy) vite të njëpasnjëshme, në kundërshtim kjo me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*” Kapitulli IV pika 84;

3. Grupi i Menaxhimit Strategjik funksionon pa hartuar një plan vjetor dhe grafik takimesh ku të përfshihen edhe hartimi e miratimi i strategjive për menaxhimin e aktiveve dhe minimizimin e risqeve të tyre.

11.1. Rekomandimi: Nëpunësi autorizues, Nëpunësi zbatues dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të Bashkisë Shijak të marrin masa për të zbatuar plotësisht procedurat standard të Inventarizimit

të aktiveve të bashkisë me gjithë dokumentacionin e domosdoshëm raportues si dhe në miratimin e strategjive për menaxhimin e risqeve dhe masat konkrete për minimizimin e tyre, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm Grupi i Menaxhimit Strategjik të Bashkisë Shijak ka ndërmarr masa me zbatimin e rekomandimit të lënë nga KLSH duke ngritur grup pune me urdhër të brendshëm për menaxhimin e riskut dhe minimizimin e tyre por jo zbatuar plotësisht pasi nuk ka akoma të miratuar një regjistër risku.

Zbatimi: Rekomandimi 11.1 është zbatuar pjesërisht.

12. Gjetje nga auditimi: 1. Grupi nga Ministria e Brendshme, që ka zhvilluar inspektimin në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 293 datë 08.09.2020, në shkresën bashkëshoqëruese me Titull “*Protokoll Inspektim - Për vlerësimin e veprimtarisë së strukturave të Shërbimit për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi*”, ku përshkruhen në mënyrë të detajuar gjithë hapat e kësaj procedure: baza ligjore, subjektet që do të inspektohen, tematika e inspektimit, metodologjia e inspektimit, nga auditimi rezulton se në përfundim të Inspektimit, nuk ka asnjë raport përfundimtar, ku të përshkruhet situata dhe një vlerësim mbi veprimtarinë dhe performancën e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, duke mos përmbushur misionin, detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara (përcaktuar te paragrafi i fundit i shkresës) si edhe ato të Ligjit nr. 152/2015 “*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*” neni 7, pika 2, neni 25 “*Kriteret për fitimin e gradës*” dhe neni 26 “*Arsimimi dhe trajnimi për fitimin e gradës*”, rezulton të mos ketë përmbushur detyrat funksionale të përcaktuara në ligj.

2. Lidhur me arsimin/llojin e diplomimit e personelit përbërës të Njesisë së IVMT-së, rezulton se personeli i saj nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 11 të ligjit 183/2014 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme*”, si dhe riskon performancën e aktivitetit të saj, referuar edhe përcaktimeve të VKM-së nr. 894 datë 04.11.2015 “*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*”;

3. Nga auditimi mbi fondet e pagave, rezulton se nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik nuk është planifikuar në planet vjetore dhe ato afatmesme “*fond për shpërblime*” mbi vlerësimin e performancës në punë të punonjësve (vlerësimi 6 dhe 12 mujor); gjithashtu për punonjësit me Kod Pune nuk zbatohet VKM nr. 68/2018 “*Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfutur në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore*”.

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa për të zbatuar plotësisht kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të dispozitave ligjore, për emërimin e punonjësve në njësitë e strukturës së Bashkisë, për të realizuar me efektivitet funksionet e saj në dobi të komunitetit;

12.2. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në fazën e përgatitjes së projekt buxheti vjetor dhe PBA-ve, të shikoj mundësinë e krijimit të një fondi në buxhet për shpërblim financiar bazuar në vlerësimin 6 dhe 12 mujor në Formularin e performancës për punonjësit me “*Status civil*” dhe përcaktimeve të VKM nr. 68/2018 për punonjësit me “*Kod pune*”, me qëllim motivimin e punonjësve për realizimin me efektivitet të objektivave institucionale;

12.3/a. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së pranë Ministrisë së Brendshme, të tregojë vëmendjen e duhur në zbatimin e detyrave funksionale për inspektimin, koordinimin, trajnimin dhe logjistikën e shërbimit të MZSH-së, në përmbushje të misionit të saj për inspektim e parandalim, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrjen për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

12.3/b. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së pranë Ministrisë së Brendshme të tregojë vëmendjen e duhur në zbatimin e detyrave funksionale për arsimimin/kualifikimin dhe trajnimin e personelit zjarrfikës për fitimin e gradës, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm **12.1**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Bashkia Shijak ka marr masa për zbatimin e plotësisht të kriterëve të përgjithshëm për emërimet në strukturën e Bashkisë me urdhër Nr.64, Dt.24.02.2022 nga DBNJ. Për rekomandimin **12.2** për mundësinë e krijimit të një fondi në buxhet për shpërblim financiar bazuar në vlerësimin 6 dhe 12 mujor nuk është marr anjë masë për realizim të saj. Ndërsa për rekomandimin **12.3/a** dhe **12.3/b** janë marrë masa për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH ku me shkresë Nr.6249/2 Dt.15.12.2022 është kryer njoftimi mbi rekomandimet e KLSH dhe është zbatuar plotësisht nga Bashkia Shijak.

**Zbatimi: Rekomandimi 12.1 zbatuar;
Rekomandimi 12.2 nuk është zbatuar;
Rekomandimi 12.3/a zbatuar;
Rekomandimi 12.3/b zbatuar.**

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi (01.01.2019-31.12.2021), në drejtim të mënyrës së zhvillimit të procedurave të prokurimit, janë konstatuar shkelje të akteve ligjore/nënligjore, të cilat paraqiten si vijon:

- Asnjë nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit dhe KVO nuk vërtetohet të kenë kryer trajnime të ndryshme;
- Nuk janë inventarizuar dhe numëruar të gjitha dosjet e procedurave të prokurimit dhe nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit;
- Procesverbalet mbi përshkrimin e veprimeve dhe Raportet Përmbledhëse të cilat janë miratuar nga Titullari i AK, nuk janë të detajuara dhe nuk përshkruajnë në mënyrë të plotë të gjithë procedurën, duke mos evidentuar argumentimin e fondit limit;
- Në të gjitha rastet e audituara, konstatohet se procesverbalet dhe DST nuk janë protokolluar në protokollin e Bashkisë Shijak;
- Nuk ka urdhër të Titullarit të AK për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të projekteve/preventivave (të cilat nuk janë bërë hyrje në magazinën e bashkisë), kontratave të punimeve/shërbimeve dhe blerjes së mallrave.
- Personat që kanë përgatitur projektet, relacionet, preventivat dhe grafikët e punimeve nuk janë në të gjitha rastet të liçencuar nga autoritetet teknike përkatëse për kryerjen e projekteve në fusha të caktuara specifike.

Sa më sipër, është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23, “Specifikimet teknike”, neni 24, “Anulimi i një procedure”, neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, neni 52 “Hapja e ofertave”, neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, neni 59, pika 4, “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pikat 1 dhe 2: VKM nr. 914, datë

29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 5, “Kontratat për punë publike”, neni 61, pika 2, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet në zbatim të tij; ligji nr. 9154, datë 06.11.03 “Për Arkivat” dhe aktet ligjore në zbatim të tij, nenet 13 dhe 18 të aktit “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”; UMF nr. 30, datë 27.12.11, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 36 dhe 42 “Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara”: etj.

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e NJHDT dhe KVO, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës dhe të trajnuar.

13.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës me specialistë të fushës për hartimin e fondit limit në përputhje me aktet ligjore/nënligjore, me qëllim planifikimin e saktë të fondit dhe përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të tij.

13.3. Rekomandimi: Sektori i Procedurave të Prokurimit, të marrë masat për inventarizimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit dhe të zbatimit të përfunduara dhe dorëzimin e tyre në Sektorin e Arkivës, Bashkia Shijak.

13.4. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa që e gjitha praktika e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke filluar nga urdhër prokurimi dhe deri në lidhjen e kontratës të protokollohet në protokollin e Bashkisë Shijak dhe jo me protokoll apo regjistër të veçantë.

13.5. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa që asnjë pjesë e projekteve të mos bëhet nga punonjës të pakualifikuar dhe të papajisur me licencat profesionale përkatëse, sipas fushës specifike të profesionit. Në rast se nuk është mundësia për të prokuruar projektet e investimeve, të merren masa për të kontraktuar specialistë të jashtëm, të cilët të kenë kualifikimet e nevojshme për të bërë projektet, sipas rastit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, **13.1/13.2/13.3/13.4** Bashkia Shijak ka ndërmarr masa që në cdo rast në përbërje të njësisë së prokurimit dhe Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ka caktuar minimalisht një specialist fushe në varësi të objektit të prokurimit. Dokumentat e dosjeve të prokurimit publik janë të inventarizuara, të sistemuara sipas rendit kronologjik dhe të gjitha dokumentat pjesë e dosjes së prokurimit publik protokollohen në regjistrin e protokollit të Bashkisë dhe më pas arshivohen. Nërsa rekomandimi **13.5** vërehet se për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 nuk ka patur projekte për investime, për rrjedhojë lihet rekomandim për vitin pasardhës.

Zbatimi: Rekomandimi 13.1;13.2;13.3;13.4 janë zbatuar.

Rekomandimi 13.5 në proces zbatimi.

14. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave me vlera të larta, janë konstatuar shkelje në aplikimin e kriteve, jo në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP, ku kriteret nuk janë në përputhje me natyrën e objektit që prokurohet, si dhe nuk janë argumentuar hollësisht në procesverbalet përkatëse, veprime në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, etj.

Mangësitë kryesore të konstatuara janë si vijon:

- Kërkesa që Bilancet të jenë të shoqëruara me auditimin ligjor është e pambështetur në ligj.
- Përcaktimi që vërtetimi për shlyerjen e energjisë elektrike të jetë brenda 5 ditësh nga kërkesa e OE, është i papërshtatshëm, pasi kjo kërkesë është për furnitorin e energjisë elektrike, i cili e ka detyrim lëshimin e vërtetimit brenda 5 ditëve. AK nuk ka asnjë lidhje me kërkesën e bërë nga OE për këtë vërtetim.
- Kriteri “*Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për një vit të caktuar nga njësitë e qeverisjes vendore ku ka pasur selinë e zhvillimit të aktivitetit*”, nuk i plotëson kërkesat e LPP, pasi nuk është gjithëpërfshirëse dhe shteruese, duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e OE i zhvillojnë punimet për interesa publike jashtë njësite vendore ku kanë të regjistruar selinë.
- Kriteri “*Përvojë e suksesshme në: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës ..., ose Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës ...*”, është në kundërshtim me pikën 6, germa b) të nenit 26 “*Kontratat për punë publike*” të VKM-së nr. 914, datë 27.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar.
- Kriteri “*Mjek, I të punësuar. Kontratë individuale të punës dhe diplomë*”. Kërkesa për mjek është e tepërt, nuk ka lidhje me asnjë nga përcaktimet e kontratës dhe është në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 09.02.2015, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 9.2.2011 “*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*”, pika 1.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike kërkohet paraqitja e dokumenteve që vërtetojnë pronësinë e tyre (fatura tatimore shitje ose dokument/akt zhdoganimi). Kjo kërkesë nuk është e mjaftueshme, pasi, pavarësisht se një OE mund t'i ketë blerë brenda apo jashtë vendit pajisjet dhe makineritë, ai mund t'i ketë shitur sërish ato. Dokumenti i vetëm që vërteton disponimin e automjeteve dhe veglave të punës, është pasqyra e inventarit, pjesë e pasqyrave financiare të Operatorit Ekonomik.
- Kërkesa për “*Specialist, ...i cili përmbush kriteret për të qenë koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve...*”, është e tepërt dhe në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”*”, neni 10 “*Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve*”, pika 5.
- Kërkesa për personel të kualifikuar, kryesisht manovratorë për makineritë teknologjike në një numër më të madh nga numri i makinerive që kërkohen ose për manovratorë të paspecifikuar sipas kodeve dhe listës së profesioneve, është e tepërt dhe e pambështetur në ligj.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike kërkohet paraqitja e dokumenteve që vërtetojnë pronësinë e tyre (fatura tatimore shitje ose dokument/akt zhdoganimi). Kjo kërkesë nuk është e mjaftueshme, pasi, pavarësisht se një OE mund t'i ketë blerë brenda apo jashtë vendit pajisjet dhe makineritë, ai mund t'i ketë shitur sërish ato. Dokumenti i vetëm që vërteton disponimin e automjeteve dhe veglave të punës, është pasqyra e inventarit, pjesë e pasqyrave financiare të Operatorit Ekonomik.
- Kërkesa që në rastin e makinerive të cilat janë marrë me qera, manovratorët “*nuk duhet të jenë të përfshirë në listëpagesat e shoqërisë*” është e papërshtatshme, pasi në kontratat e qerasë specifikohet vetëm marrja me qera e makinerive dhe jo e manovratorëve. Punonjësit nuk janë objekt qeraje dhe rrjedhimisht specifikimi për mënyrën e përdorimit të makinerive me qera e

bën të paqartë mënyrën e realizimit të kontratës.

- Kërkesa që “për mjetet me qira të paraqitet kontrata noteriale e qirasë, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe kohëzgjatja e saj”, është e papërshtatshme dhe nuk është e mbështetur në ligj.

- Kërkesa që “Mjeti autobitumatrice të jetë i pajisur me certifikatë për transport mallrash të rrezikshme” është e papërshtatshme dhe e pambështetur në ligjin nr. 118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, neni 23 “Llojet e mallrave për autorizim”, pika 1.

- Nga AK, në asnjë rast nuk është kërkuar disponimi i të paktën një rimorkiatori, i cili të bëjë transportin e mjeteve të cilat janë të patarguara dhe nuk duhet të qarkullojnë në rrugë, duke mos garantuar mënyrën e disponimit të makinerive teknologjike.

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve, duke dhënë argumente për secilin kriter, të cilat të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit. Njësia e Prokurimit, në hartimin dhe miratimin e kriterëve të kërkesave për kualifikim, pjesë integrale e DST, të argumentojë me hollësi çdo kriter të kërkesave kualifikuese, bazuar mbi natyrën e kontratës, zërat e preventivit, volumet e punimeve, kohëzgjatjen e kontratës, orët e punës për njësi të zërave të preventivit, analizave sipas manualit teknik të çmimeve, numrin e nevojshëm të mjeteve, punonjësve, liçencave, etj, duke i pasqyruar në procesverbalin përkatës, i cili të jetë pjesë e dosjes së prokurimit.

14.2. Rekomandimi: Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit, Bashkia Shijak, të marrë masa për shmangien e kriterëve të tepërta dhe të paargumentuara, të cilat nuk mbështeten në bazën ligjore, por krijojnë pengesë dhe kufizojnë numrin e operatorëve ekonomikë për të konkurruar në procedurat e prokurimit publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm **14.1** dhe **14.2**, Kryetari i Bashkisë Shijak në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor ka marrë masa për ngritjen e grupeve të punës me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës) dhe evidentuar mangësitë në çdo rast por mbetet në proces zbatimi pasi ka akoma kriterë për plotësim si më lart cituar që janë në proces.

**Zbatimi: Rekomandimi 14.1 në proces zbatimi;
Rekomandimi 14.2 në proces zbatimi.**

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se në procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2019-31.12.2021, janë shpallur fitues OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, të miratuara nga AK, si më poshtë:

1. Në 10 procedura, KVO ka kryer vlerësimin e ofertave në tejkallim të afatit prej 15 ditësh, në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.;

2. Nga auditimi, u konstatua se kualifikimi dhe shpallja fitues e OE/BOE është bërë në mospërputhje me kuadrin ligjor për prokurimet dhe DST të miratuara nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shijak, si më poshtë:

- Vlera e xhiros e tejkalon sasinë e kërkuar në DST, në raport me vlerën e fondit limit që prokurohet;

- Bilance të pakonfirmuara me shkresë përcjellëse nga tatimet;

- Nuk janë paraqitur vërtetime për shlyerjen e detyrimeve vendore në të gjitha vendet ku OE kanë ushtruar veprimtari biznesi;
 - Nuk është bërë verifikimi i kodeve të profesioneve në listëpagesa, sipas profesioneve të deklaruara, për të garantuar që puna do të kryhet nga profesionistët e kërkuar në DST;
 - Çertifikatat e trajnimeve profesionale dhe/ose për sigurinë në punë, nuk janë nga institucione të akredituara për certifikimin e punonjësve.
 - Për pajisjet/makineritë/veglat e punës të cilat nuk kanë detyrim pajisjen me targa dhe leje qarkullimi, nuk vërtetohet disponimi, pasi faturat e blerjes janë shumë të vjetra dhe nga KVO nuk është verifikuar disponimi i tyre në listën e inventarit bashkëlidhur bilanceve të depozituara.
 - Dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e APP-së për makineritë teknologjike është në gjuhë të huaj, nuk është i lexueshëm dhe shumica e makinerive nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, çertifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 “*Makinat teknologjike*” dhe neni 113 “*Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike*”;
- Sa më sipër, është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, neni 23, “*Specifikimet teknike*”, neni 24, “*Anulimi i një procedure*”, neni 46, “*Kualifikimi i ofertuesve*”, pika 1, neni 52 “*Hapja e ofertave*”, neni 53, “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 3, neni 59, pika 4, “*Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës*”, pikat 1 dhe 2: VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 26, pika 5, “*Kontratat për punë publike*”, neni 61, pika 2, “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*”, etj.

15.1. Rekomandimi Komisioni i vlerësimit të ofertave në Bashkinë Shijak, të marrë masa që në të gjitha rastet, për vlerësimin e ofertave të respektohet afati prej 15 ditësh nga hapja e tyre. Në rastet kur për shkaqe të ndryshme objektive nuk është e mundur të respektohet afati 15 ditor, të gjitha arsyet që shkaktojnë vonesën të dokumentohen nëpërmjet procesverbaleve përkatës.

15.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për shqyrtimin e shkeljeve të konstatuara, të bëjë vlerësimin nëse ka elemente të përdorimit pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve apo nëse i është shkaktuar dëm buxhetit të Bashkisë për vlerën e kontraktuar apo pjesë të saj, sipas rasteve specifike dhe në rast se rezulton dëm apo përdorim i paligjshëm i fondeve, të ndiqen të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët në ngarkim të personave përgjegjës për procedurat (rast pas rasti dhe në mënyrë të barabartë).

15.3. Rekomandimi: Bashkia Shijak, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të miratuara në DST, pasi operatorët ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit apo shërbimit.

15.4. Rekomandimi: Gjatë kontrollit dhe vlerësimit të ofertave, nga KVO të merret në konsideratë që për makineritë teknologjike vetëlëvizëse në pronësi apo me qera, në të gjitha rastet të kërkohet dokumentacioni i duhur për regjistrimin e tyre, përfshirë lejen e qarkullimit, targimin, siguracionin etj., ndërsa për pajisjet e tjera të kërkohet regjistrimi i tyre në inventaret kontabël, bashkëlidhur bilancit.

15.5. Rekomandimi: Gjatë kontrollit dhe vlerësimit të ofertave, nga KVO të merret në konsideratë që për pajisjet, makineritë dhe veglat e punës, krahas dokumentacionit të blerjes apo zhdoganimit, etj., të kërkohet edhe vënia në dispozicion e pasqyrës së inventarit të aktiveve,

pjesë e pasqyrave financiare të OE, si i vetmi dokument që vërteton dhe garanton disponimin e tyre. Gjithashtu, të verifikohen kodet e profesioneve të punonjësve në listëpagesa dhe çertifikatat/vërtetimet e kualifikimeve të kërkohen nga organe të akredituara posaçërisht për fushat specifike të nevojshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimet e mësipërme, Bashkia Shijak ka marr masa duke proceduar sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH, në lidhje me afatet, me ngritjen e grupeve të specialistëve sipas fushës, masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të miratuara në DST etj, si më lart cituar.

**Zbatimi: Rekomandimi 15.1 është zbatuar;
Rekomandimi 15.2 është zbatuar;
Rekomandimi 15.3 është zbatuar;
Rekomandimi 15.4 është zbatuar;
Rekomandimi 15.5 është zbatuar.**

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për kontratat e lidhura nga Bashkia Shijak, nga vlera totale prej 968,516,245 lekë është mundësuar likuidimi i vlerës prej 581,868,388 lekë ose 60.1% e vlerës së kontratave të lidhura, duke mbetur për pagesë vlera 386,647,857 lekë.

Likuidimi i pjesës tjetër nuk është bërë pasi në Vendimet e KB dhe më pas në kontrata është përcaktuar likuidimi në disa vite buxhetore, e cila ka shkaktuar që kontratat të lidhen në kundërshtim me nenin 70 “*Lidhja e kontratës*” të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014.

Nga auditimi, u konstatua se nga ana e titullarëve të Bashkisë Shijak nuk janë ngritur komisionet për marrjen në dorëzim të punimeve dhe rrjedhimisht punimet nuk janë marrë në dorëzim, duke shkaktuar mosregjistrimin e asetëve në kontabilitet, moskthimin e garancisë së punimeve për objektet e përfunduara dhe a mortizimin e tyre para se të bëhen pjesë e inventarëve të Bashkisë Shijak. Nga intervista me personelin, u konstatua se këto objekte nuk janë marrë në dorëzim kryesisht për shkak të dëmtimeve që kanë pësuar nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe për personelin e Bashkisë Shijak ka qenë e vështirë të përcaktohet se cilat dëme janë shkaktuar nga tërmeti dhe cilat mund të kenë qenë për shkak të mangësive/defekteve dhe problemeve me cilësinë e punimeve.

Për objektet e financuara nga qeveria ose nga institucione të tjera, si AKUM-i, FZHR, etj., likuidimet nuk kanë përfunduar jo për faj të AK, por për mungesën e likuidimeve nga institucionet përkatëse.

Autoriteti Kontraktor, gjatë periudhës së audituar, nuk ka kryer monitorim për zbatimin e kushteve të kontratave të lidhura duke i dokumentuar me procesverbal, njëkohësisht nuk ka përgatitur e hartuar raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e Shijakura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Në të gjitha kontratat e përpiluara dhe të miratuara, nuk ka të përcaktuar personin, ose strukturën organizative përgjegjëse në emër të palës, për të ndjekur realizimin e kushteve të kontratës të lidhura me kontraktorët, veprim në mospërputhje me Kreun IX “*Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës*”, neni 77 “*Mbikëqyrja e kontratës*”, pikat 3 dhe 4 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, si dhe kriteri i parashikuar në kontratën e lidhur me palët, neni përkatës “*Përfaqësimi i palëve*”. ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar dhe aktet në

zbatim të tij; UMF nr. 30, datë 27.12.11, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 36 dhe 42 “Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara”: etj.

16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në të ardhmen, të mos bëhen prokurime pa pasur në dispozicion paraprakisht të gjitha fondet e nevojshme për realizimin e punimeve, si dhe të mos bëhen prokurime të reja pa likuiduar më parë të gjitha faturat dhe situacionet e paraqitura nga OE.

16.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të AK dhe Njësia e Prokurimit në Bashkinë Shijak të marrin masa dhe të analizojnë situatën, me qëllim që në të ardhmen, nga personi ose struktura organizative e caktuar si përgjegjës në emër të Autoritetit Kontraktor, të hartohen raporte të hollësishme për korrektësinë, cilësinë dhe realizimin e suksesshëm të kontratave të lidhura.

16.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të AK, të nxjerrë urdhërat për krijimin e komisioneve/grupeve të punës për monitorimin dhe marrjen në dorëzim të të gjitha objekteve për të cilat kanë përfunduar punimet, duke bërë verifikimet përkatëse për zbatimin e projekt-preventivave dhe specifikimeve teknike të miratuara, si dhe të marrë masa që në ngritjen e grupeve të punës, të përcaktohen qartë detyrimet dhe përgjegjësitë për secilin anëtar, në mënyrë që objektet e ndërtuara me financim nga Bashkia, t’i shërbejnë sa më mirë dhe sa më shpejt komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimet e mësipërme **16.1** dhe **16.3** Bashkia Shijak ka marrë masa gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 mos të kryejë prokurime pa pasur në dispozicion fonde paraprake, për të cilat rezulton të jenë miratuar me VKB si dhe në të gjitha rastet Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e NA ka urdhëruar ngritjen e grupeve të punës, me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara duke caktuar edhe detyrat që do të kryejë grupi i punës. Ndërsa në lidhje me rekomandimin **16.2 Kryetari i Bashkisë** në cilësinë e NA ka përcaktuar personin përgjegjës në emër të Autoritetit Kontraktor por nuk janë hartuar raportet në lidhje me kontratat e lidhura.

**Zbatimi: Rekomandimi 16.1 është zbatuar;
Rekomandimi 16.2 është zbatuar;
Rekomandimi 16.3 është zbatuar pjesërisht.**

17. Gjetje nga auditimi: 1. Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit “Ndërtimi i shkollës 9 vjeçare Adem Sabli, fshati Borakë”, Bashkia Shijak, u konsatuan diferenca në volume, konkretisht për zërat e punës “Punime izolimi tarrace” dhe “Punime dyer dhe dritare”. Janë situacionuar volume punimesh më shumë se gjendja faktike. Vlera e diferencave të konstatuara është 309,349 lekë, e cila përbën **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak, në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1988, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim”, Kreu 2, pika 3; kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3009, datë 26.08.2019 dhe kontratën e mbikëqyrjes nr. 2472, datë 30.07.2019.

Gjetje nga auditimi: 2. Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit “Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare Muharrem Dollaku, Shijak”, Bashkia Shijak, u

konsatuan diferenca në volume, konkretisht për zërat e punës “*Punime dyer dhe dritare*” dhe “*Shtresë me pllakë gres porcelanat 40x40 cm*”. Janë situacionuar volume punimesh më shumë se gjendja faktike. Vlera e diferencave të konstatuara është 302,900 lekë e cila përben **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak, në kundërshtim me bazën ligjore të përmendur më sipër, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3447 datë 27.09.2018 dhe kontratën e mbikëqyrjes nr. 3447/1 datë 27.09.2018.

Gjetje nga auditimi: 3. Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit “*Ndërtimi i rrugëve të brendshme në lagjen e vjetër Shijak*”, Bashkia Shijak, u konsatuan diferenca në volume, konkretisht për zërat e punës “*Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=30 cm e përhapur e ngjeshur me makineri*”, “*Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm me makineri*”, “*Shtresë asfaltobetonit me granil gur kave, 4 cm me makineri*”. Janë situacionuar volume punimesh më shumë se gjendja faktike. Vlera e diferencave të konstatuara është **368,190** lekë e cila përben **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak, në kundërshtim me bazën ligjore të përmendur më sipër, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3453 datë 01.06.2021 dhe kontratën e mbikëqyrjes nr. 3449 datë 01.06.2021.

17.1. Rekomandimi: Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve të merren masa për të zbatuar me përpikmëri kontrollin dhe mbikëqyrjen e punimeve, situacionimin e saktë sipas volumeve të punimeve të kryera në terren në përputhje me legjislacionin e mësipërm dhe kontratës së lidhur mes tij dhe investitorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak ka marr masa për realizimin e kontratave dhe situacioneve sipas rekomandimit të lënë nga KLSH, të cilat janë bashkëngjitur dosjes.

Zbatimi: Rekomandimi 17.1 është zbatuar.

18. Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli i dosjes teknike të ndërtimit të objektit “*Ndërtimi i rrjetit të ujësjellsit për qytetin Shijak*”, Bashkia Shijak, u konstatuan mospërputhje mes projektit, librezës së masave dhe situacionit nr. 4, në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1988, “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim*”, Kreu 2, pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5878 datë 27.07.2020 dhe Kontratën e mbikëqyrjes nr. 5878/1 datë 27.07.2020. Punimet janë ende të papërfunduara.

18.1. Rekomandimi: Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, të merren masa për të bërë rakordimin mes situacionit të radhës, atij përfundimtar me librezat e masave dhe projektit të azhurnuar të përmendur në observacionin e dërguar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak ka marr masa për monitorimin e grupit të punës duke caktuar përgjegjës për ecurinë e zbatimit të kontratës së mbikëqyrjes dhe rakordimet me situacionet e radhës.

Zbatimi: Rekomandimi 18.1 është zbatuar.

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se mungon “*Vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi*” sipas VKM nr. 1162, datë 24.12.2020, “*Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë pajisje me leje zhvillimi/leje ndërtimi*”. VKM nr. 408, datë 13.05.2015, neni 15, pika c, “*Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuesesi dhe Kushtet Teknike të Projektimit KTP*”.

19.1. Rekomandimi: Nga ana e DPT (Drejtoria e Planifikimit të Territorit) Bashkia Shijak të merren masa të pajisin me “Vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi”.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm Bashkia Shijak nuk ka marrë masa për zbatimin e tij gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022.

Zbatimi: Rekomandimi 19.1 nuk është zbatuar.

20. Gjetje nga auditimi: Planvendosja e pranuar nga DPT (Drejtoria e Planifikimit të Territorit) Bashkia Shijak nuk është e detajuar me të gjithë elementet e nevojshëm si numrat e kateve të objekteve përreth, në bazë të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, neni 15, pika c, “Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuesesi dhe Kushtet Teknike të Projektimit KTP”.

20.1. Rekomandimi: Nga ana e DPT (Drejtoria e Planifikimit të Territorit) Bashkia Shijak të merren masa mos të lëshohen leje ndërtimi pa planvendosje të detajuar me të gjithë elementet e nevojshëm që janë: distancat nga kufiri i pronës dhe objektet përreth në të katër orientimet, numrat e kateve të objekteve përreth.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak, Drejtoria e Planifikimit të Territorit ka marrë të gjitha masat të mos lëshohen akte/leje ndërtimi pa planvendosje të detajuar me të gjithë elementet e nevojshëm.

Zbatimi: Rekomandimi 20 është zbatuar.

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit e-leje u konstatua leja e ndërtimit me objekt “Struktura banimi 1 kat”, me zhvillues “D. Sh.”, me adresë Bashkia Shijak. Në këtë praktikë u vu re se janë më shumë se një strukturë banimi. TNI për këtë praktikë është përlogaritur si objekt për përdorim vetjak. Nga ana e grupit të auditimit u kërkua të saktësohej fatura ose të argumentohej mënyra e përlogaritjes.

21.1. Rekomandimi: Mossaktësimi i mënyrës së përlogaritjes së taksës dhe i kategorizimit të saj riskon të kemi vlera të ndryshme ne pagesën që përfituesi i lejes duhet të paguaj për TNI për një leje të caktuar.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak, Drejtoria e Planifikimit të Territorit ka marrë masat që në të ardhmen mos të ketë pasaktësi në përlogaritjen e TNI.

Zbatimi: Rekomandimi 21.1 është zbatuar.

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të IMTV-së Bashkia Shijak, u konstatua se: **Për vitin 2020**, janë mbajtur 13 procesverbale konstatimi dhe në zbatim të tyre janë nxjerrë 13 vendime me gjobë, në vlerën 4,050,000 lekë, nga të cilat 7 gjoba me vlerë 3,500,000 lekë, 5 gjoba me vlerë 500,000 lekë dhe 1 gjobë me vlerë 50,000 lekë, për punime në fasadë jashtë lejes së ndërtimit. Për këtë periudhë, IMTV Shijak ka nxjerrë 38 vendime për prishje objektësh, nga të cilat 31 pallate dhe 7 objekte arsimore, si pasojë e procesit të rindërtimit, me vendime për prishje objektësh, të cilat janë nxjerrë në zbatim të investimeve të ndryshme publike. Nga auditimi i të dhënave për penalitetet e ndryshme të vendosura nga IMTV në Bashkinë Shijak, rezultoi se gjatë periudhës objekt auditimi janë vendosur gjithsej 13 gjoba, për një vlerë totale 4,050,000 lekë.

Për vitin 2021, janë mbajtur 31 procesverbale konstatimi dhe në zbatim të tyre janë nxjerrë 20 vendime me gjobë, në vlerën 5,775,000 lekë, nga të cilat 8 gjoba me vlerë 4,000,000 lekë, 8 gjoba me vlerë 1,550,000 lekë dhe 4 gjoba me vlerë 225,000 lekë, për punime në fasadë jashtë lejes së ndërtimit. Për këtë periudhë, IMTV Shijak ka nxjerrë 3 vendime për prishje objektësh, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, të cilat janë ekzekutuar me procesverbal ekzekutimi. Gjithashtu, po për këtë periudhë, IMTV ka nxjerrë 23 vendime për prishje objektësh, nga të cilat rezultojnë se 20 janë për punime ndërtimi për të cilat nevojitet leje ndërtimi, si dhe 3 vendime për prishje objektësh të cilat janë nxjerrë në zbatim të investimeve të ndryshme publike.

Nga auditimi i të dhënave për penalitetet e ndryshme të vendosura nga IMTV në Bashkinë Shijak, rezultoi se gjatë periudhës objekt auditimi janë vendosur gjithsej 20 gjoba, për një vlerë totale 5,775,000 lekë.

22.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, kryesisht nga ana e K/inspektorit të IMTV-së, të merren masa për përgatitjen e informacionit periodik 3-mujor për IKMT-në, në lidhje me masat e marra. Gjithashtu, K/Inspektori të miratojë aktet e kontrollit për objektet e pajisura me leje Ndërtimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak ka marrë masa për përgatitjen e informacionit për IKMT-në me shkresë Nr.6161 Prot., Dt.30.09.2022 por rezultojnë jo periodik 3 mujor si dhe K/Inspektori nuk ka miratuar aktet e kontrollit për objektet e pajisura me leje ndërtimi.

Zbatimi: Rekomandimi 22.1 është zbatuar pjesërisht.

22.2. Rekomandimi: Drejtoria Juridike, në lidhje me gjobat e pa arkëtuara duhet t'i drejtohet Gjykatës Administrative për kthimin e gjobave në tituj ekzekutivë. Nga Drejtoria Juridike, të kërkohet në Gjykatën Administrative rivendosja në afat e vendimeve me gjobë, të vendosura gjatë viteve të mëparshme. Për personat e dënuar me gjobë, të aplikohet kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë, për mos derdhje në afat të gjobës deri në një muaj.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit ka kryer procedurën ligjore për kthimin e gjobave në tituj ekzekutivë duke ia përcjell Drejtorisë Juridike ku nga kjo e fundit rezultojnë që nuk është vepruar ndjekja juridiko/ligjore pranë Gjykatës Administrative.

Zbatimi: Rekomandimi 22.2 është zbatuar pjesërisht.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat e KLSH”, shkronja (b) dhe (c) dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike Bashkia Shijak, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim

kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi Zbatues të ndiqet procesi me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 1,493,439 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të personelit për njësitë që krahas kritereve bazë, duhet të plotësojnë edhe kritere të veçanta për emërimin e personelit, referuar: Propozimi i Kryetarit të Bashkisë Shijak “*për emërim në detyrë*” me nr. 725 prot., datë 23.03.2016; Urdhër nr. 195 datë 28.04.2016 i Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së “*Për emërim në detyrë si Shef i Sektorit të MZSH-së me gradën “Inspektor”*”; Akt i Emërimit në punë me nr. 1341/1 datë 03.05.2020 nga Kryetari i Bashkisë Shijak ku përshkruhen të gjithë elementët e nevojshëm një akti, emërimin e Z.A.Xh si “*shef i sektorit zjarrfikës dhe emergjencave civile*” me vlerën e pagës bazë dhe datën e fillimit të marrëdhënieve financiare; Urdhërin nr. 99 datë 10.01.2019 i Drejtorit të MZSH pranë Ministrisë së Brendshme “*Për gradimin e punonjësit të shërbimit të MZSH-së z. A.Xh. në funksionin e Shefit të Sektorit të Shërbimit të MZSH-së Bashkia Shijak t’i jepet grada “Inspektor Zjarrfikës”*”, ku përcaktohet baza ligjore/nënligjore referuese (specifikimet e reja sipas Ligjit nr. 152/2016), në zbatim të VKM nr. 895 datë 21.12.2016 “*Për kriteret e ecures dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën*” pika 1, 2 dhe Lidhja 1; VKM nr. 350 datë 19.04.2017 “*Për trajtimin me pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*” Lidhja 1; Me miratimin në Parlament dhe botimin në fletoren zyrtare të Ligjit nr. 152/2016 shërbeu si pikënisje për një interpretim jo të drejtë të tij për trajtimin me pagë të shefit të MZSH-së. Me daljen e VKM nr. 895/2016, ky interpretim i Drejtorisë Juridike dhe asaj Ekonomike u konsiderua “*i drejtë*” dhe vazhdon deri më sot të trajtohet në këtë klasifikim, me nivelin e pagës referuar VKM nr. 350/2017. Nga auditimi i listëpagesave për vitet nënauditim 2019, 2020 dhe 2021, nga Drejtoria e Financës (tani Drejtoria Ekonomike) në Bashkinë Shijak shefi i sektorit të MZSH-së është trajtuar me nivelin e pagës të gradës “*kryeinspektor*”. Ndonëse në strukturë është emëruar në pozicionin e Shefit të Sektorit të MZSH-së, ka gradën “*Inspektor zjarrfikës*”, trajtimi me pagë i tij është bërë në kundërshtim me aktet ligjore të sipërcituara;

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masat për trajtimin me nivelin e pagës sipas akt-emërimeve dhe akteve ligjore si dhe në përlllogaritjen e vlerës së përfituar pa të drejtë të shefit të MZSH-së emëruar në detyrë me gradën inspektor në masën prej 9,000 (nëntë mijë) lekë çdo muaj, nga data e fillimit të përfutimit të pagës (01.01.2018) dhe në vijim, me gradën si “*kryeinspektor zjarrfikës*”, në masën **513,000 lekë** (deri në datën 30.09.2022); gjithashtu, në vijim të trajtohet me nivelin e pagës “*inspektor zjarrfikës*”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se:

Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak ka marr masat për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH ku me shkresë Nr.6249 Prot., D.15.12.2022 Kryetari i Bashkisë Shijak ka marr nismën për të.

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 është zbatuar pjesërisht.

2. Gjetje nga auditimi: Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit “*Ndërtimi i shkollës 9 vjeçare Adem Sabli, fshati Borakë*”, Bashkia Shijak, u konsatuan diferenca në volume konkretisht për zërat e punës, “*Punime dyer dhe dritare*” dhe “*Punime izolimi terrace*”. Janë situacionuar volume punimesh më shumë se gjendja faktike.

Vlera e diferencave të konstatuara është 309,349 lekë, e cila përbën **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak, në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1988, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim”, Kreu 2, pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3009, datë 26.08.2019 dhe Kontratën e mbikëqyrjes nr. 2472, datë 30.07.2019.

2.1. Rekomandimi: Nga ana e sipërmarrësit të punimeve të merren masa për të zhdëmtuar vlerën prej **309,349 lekë**.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak ka marr masat për njoftimin e subjektit mbi detyrimin e konstatuar nga KLSH me shkresë Nr.6249/1 Prot., Dt.15.12.2022 por nga ana e subjektit rezultoi mos të jetë kryer pagesa si më lart, për rrjedhojë lihet rekomandim Drejtorise Juridike të ndjek të gjitha procedurat ligjore deri në likuidim të saj.

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 është zbatuar pjesërisht.

3. Gjetje nga auditimi: Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit “Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare Muharrem Dollaku, Shijak”, Bashkia Shijak, u konsatuan diferenca në volume konkretisht për zërat e punës “Punime dyer dhe dritare” dhe “Punime izolimi terrace”. Janë situacionuar volume punimesh më shumë se gjendja faktike. Vlera e diferencave të konstatuara është 302,900 lekë e cila përbën **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak, në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1988, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim”, Kreu 2, pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3447 datë 27.09.2018 dhe kontratën e mbikëqyrjes nr. 3447/1 datë 27.09.2018.

3.1. Rekomandimi: Nga ana e sipërmarrësit të punimeve të merren masa për të zhdëmtuar vlerën prej **302,900 lekë**.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak ka marr masat për njoftimin e subjektit mbi detyrimin e konstatuar nga KLSH me shkresë Nr.6249/2 Prot., Dt.15.12.2022 por nga ana e subjektit rezultoi mos të jetë kryer pagesa si më lart, për rrjedhojë lihet rekomandim Drejtorise Juridike të ndjek të gjitha procedurat ligjore deri në likuidim të saj si dhe të dërgohet njoftim i dytë lidhur me subjektin pasi shuma e lënë në rekomandim nga KLSH është shuma 302.900 Lekë dhe jo shuma 303.160 Lekë.

Zbatimi: Rekomandimi 3.1 është zbatuar pjesërisht.

4. Gjetje nga auditimi: Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit “Ndërtimi i rrugëve të brendshme në lagjen e vjetër Shijak”, Bashkia Shijak, u konsatuan diferenca në volume, konkretisht për zërat e punës “Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=30 cm e përhapur e ngjeshur me makineri”, “Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm me makineri”, “Shtresë asfaltobetonit me granil gur kave, 4 cm me makineri”. Janë situacionuar volume punimesh më shumë se gjendja faktike. Vlera e diferencave të konstatuara është **368,190** lekë e cila përbën **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak, në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1988, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e

punimeve në ndërtim”, Kreu 2, pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3453 datë 01.06.2021 dhe Kontratën e mbikëqyrjes nr. 3449 datë 01.06.2021.

4.1. Rekomandimi: Nga ana e sipërmarrësit të punimeve të merren masa për të zhdëmtuar vlerën prej **368,190 lekë**.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak ka marr masat për njoftimin e subjektit mbi detyrimin e konstatuar nga KLSH me shkresë Nr.6249/3 Prot., Dt.15.12.2022 por nga ana e subjektit rezultoi mos të jetë kryer pagesa si më lart, për rrjedhojë lihet rekomandim Drejtorise Juridike të ndjek të gjitha procedurat ligjore deri në likuidim të saj.

Zbatimi: Rekomandimi 4.1 është zbatuar pjesërisht.

MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Shijak nuk ka lidhur kontratë me Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Shijak për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësi të mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime.

Nga auditimi i taksës së ndërtesës, u konstatua një vlerë debitore prej **14,849,000 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës deri në datën 31.12.2021.

Nga auditimi i tarifës së pastrimit, u konstatua një vlerë debitore prej **12,872,000 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i tarifës së pastrimit deri në datën 31.12.2021.

Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 4, 5, 6, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, etj., ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kreu VIII “Vlerësimi tatimor”, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, etj.

1.1. Rekomandim: Bashkia Shijak të marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Shijak ShA, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak sipas legjislacionit në fuqi, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

1.2. Rekomandim: Bashkia Shijak të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerave debitore prej **14,849,000 lekë** nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës dhe **12,872,000 lekë** nga mos pagesa e tarifës së pastrimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimet e mesipërme, Bashkia nuk ka marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Shijak ShA për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e rekomandimeve të lëna si dhe ndjekjen e procedurave për arkëtim të vlerës debitoare prej **14,849,000** lekë nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës dhe **12,872,000** lekë nga mos pagesa e tarifës së pastrimit.

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 dhe 1.2 nuk është zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se me ligjin 7501 “Për tokën”, janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 5171 familje për sipërfaqen toke prej 5,452 hektarë, për të cilat është planifikuar pagesa e taksës së tokës. Mesatarisht, për të gjithë periudhën objekt auditimi, taksa e tokës është arkëtuar rreth 41.23 %. Nga 5171 familje të trajtuara me tokë bujqësore, 3,532 familje ose më shumë se gjysma janë debitorë për këtë lloj takse. Shumë pak pagesa bëhen në mënyrë vullnetare, por kryesisht paguajnë familjet të cilat janë paraqitur në zyrat e Bashkisë për probleme të ndryshme administrative dhe u është kërkuar kryerja e pagesës në këmbim të marrjes së shërbimit.

Nga auditimi i taksës së tokës, rezultoi vlera totale debitoare **47,802,000** lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak. Kjo vlerë debitoare është e pakontabilizuar.

Sa më sipër, është në kundërshtim me: ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar; ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, UKM nr.1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, etj.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet tarifit apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj. Të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Shijak, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, et.) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese e të dhënave.

2.2. Rekomandimi: Bashkia Shijak, të ngrëjë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Shijak dhe Qarku Durrës). Për familjet fermerë debitorë të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë kohën e papaguar për vlerën **47,802,000** lekë dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera përkatëse, sipas rastit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak nuk ka marrë masa për krijimin e të dhënave për subjektet, tarifit dhe taksat dhe nuk ka krijuar një regjistër për subjektet si dhe nuk ka kryer korrespondencë me institucionet për një proces sa më të saktë të objektit të rekomandimit si më lart. Bashkia Shijak ska ndjekur procedurat administrative apo penale për shlyerjen e detyrimit në vlerën e konstatuar **47,802,000** lekë.

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 nuk është zbatuar.

Rekomandimi 2.2 nuk është zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë, u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë dhënë 111 leje legalizimi për 25,124 m² ndërtim, me vlerë investimi 479,591,000 lekë, për një vlerë totale detyrimi 3,851,000 lekë, nga e cila nuk është arkëtuar vlera 2,161,311 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Shijak. Kjo vlerë debitoare është e pa kontabilizuar.

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimit dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23, me VKM-në nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, pika 2/1, si dhe me VKB vjetore përkatëse për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Shijak, etj.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak nëpërmjet bashkëpunimit institucional t’i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Durrës, që të mos lëshojë dhe të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Shijak. Drejtoria e planifikimit urban, kontrollit të zhvillimit dhe projekteve, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e vlerës **2,161,311 lekë** nga të gjithë individët e listuar si debitorë në Anekset bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak nuk ka marr masa për bashkëpunim institucional me ASHK Durrës me qëllim evitimin e dhënieve të lejeve të legalizimit pa paguar TNI. Drejtoria e Planifikimit Urban, Kontrollit të Zhvillimit dhe Projekteve, nuk ka ndjekur procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, në arkëtimin e vlerës **2,161,311 lekë** nga të gjithë individët e listuar si debitorë.

Zbatimi: Rekomandimi 3.1 nuk është zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, rezultoi se në Bashkinë Shijak ka 336 subjekte debitorë nga biznesi. Numri i debitorëve nga biznesi si në numër dhe në vlerë (për taksën e ndërtesës, tabelës, hotelit, truallit, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie e kamatëvonesat përkatëse), nga viti në vit ka ardhur duke u ulur, kështu në fund të vitit 2018 numri i debitorëve ishte 549 subjekte në vlerën prej 17,888,557 lekë, ndërsa në fund të vitit 2020 numri i debitorëve ishte 336 subjekte në vlerën prej **47,818,047** lekë. Vlera progresive në fund të vitit 2021 ka qenë **39,179,217 lekë**, e cila përfaqëson taksat dhe tarifat vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Shijak.

Nga auditimi, u konstatua se nuk është llogaritur vlera e gjobës (kamatëvonesës) në masën 0,06% për çdo ditë vonesë, deri në 365 ditë. Sa më sipër, nuk gjen zbatim ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 89 “Njoftimi dhe kërkesa për të paguar”

Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitoare, strukturat tatimore të bashkisë Shijak, nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat

tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë, duke vepruar në mospërputhje ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008. Gjithashtu nga strukturat tatimore të bashkisë Shijak për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar kallëzim penal bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i RSh” me ndryshime neni 181, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3., neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj subjekteve debitorë në vlerën prej **39,217,179 lekë**, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së Financës dhe sektorit juridik të Bashkisë Shijak, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak, Drejtoria e Taksave, Tarifave dhe Kadastrës Fiskale ka marr masa duke ndjekur rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara nga subjektet fizikë/juridikë sic është dërgimi i urdhër bllokimeve për llogaritë në bankat e nivelit të dytë, por nga ana e subjektëve ka mungesë të përgjigjes së detyrimeve si dhe Drejtoria Juridike nuk ka nisur nismën e procedurave për to.

Zbatimi: Rekomandimi 4.1 është zbatuar pjesërisht.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se për periudhën 2019-2021 kanë zhvilluar aktivitet në fushën e ndërtimit dhe janë pajisur me Leje Ndërtimi nga Bashkia Shijak 89 subjekte në vlerën 1,764,610 lekë për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektesh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet të veprimtarive të objekteve, etj ..., nga të cilët kanë paguar detyrimet 9 subjekte në vlerën **623,433 lekë**, duke mbetur pa u arkëtuar

vlera **1,222,997 lekë** për 80 subjekte, **vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Shijak**, sipas listimit në Anekset bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” neni 40, “Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare”, pika 1, neni 43 “Përditësimi i të dhënave të regjistrimit” pika 1/1; ligjin nr. 9723 dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, neni 22, “Detyrimi për regjistrim”, pika 4; ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, VKB, etj.

5.1. Rekomandimi: Sektori i taksave dhe tarifave vendore të saktësojë listat e bizneseve të pajisura me leje ndërtimi, për projektet e investimeve të prokuruar për vitet 2019-2020, pavarësisht nëse kanë selinë kryesore jashtë territorit të Bashkisë Shijak por që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, si dhe të nxjerrin njoftim detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore. Sipas listës aneks nr. **A22 A23 dhe A24**, të ndjekin të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës prej **1,222,997 lekë** nga këto detyrime vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak, Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Kadastrës Fiskale në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Sherbimeve dhe Infrastrukturës e Publike dhe Drejtorinë Juridike kanë saktësuar listat me subjektët privatë që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në territorin e Bashkisë Shijak dhe kanë dërguar njoftimet subjektëve për detyrimet dhe taksat vendore ku ka rezultuar që ka patur disa subjektë që vullnetarisht janë paraqitur për ndjekje procedurash dhe shlyerje detyrimi por kjo nuk është realizuar totalisht.

Zbatimi: Rekomandimi 5.1 është zbatuar pjesërisht.

6. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Shijak ushtrojnë aktivitetin 30 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi, u konstatua se është licencuar 1 subjekt i cili tregëton karburante ndërsa 27 subjektet e tjera nuk janë licencuar, duke ushtruar aktivitetin të papajisur me licencë dhe pa paguar tarifën përkatëse.

Subjekte të licencuar për tregtimin e lëndëve djegëse janë dy, R.G me vendndodhje në Pjezë dhe R.G me vendndodhje në Maminas.

Vlera prej 27,000,000 lekë, e cila nuk është paguar nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Shijak, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak.

6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **27,000,000 lekë**, nga subjekteve që ushtrojnë aktivitet për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, pa u pajisur me autorizim nga Bashkia, sipas Anekseve bashkëlidhur Raportit të Auditimit. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Shijak ka marr masa për njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit subjektet që ushtrojnë aktivitetin në tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, ku ka rezultuar që ka patur disa subjektë që vullnetarisht janë paraqitur për ndjekje procedurash dhe shlyerje detyrimi por kjo nuk është realizuar totalisht.

Zbatimi: Rekomandimi 6.1 është zbatuar pjesërisht.

MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 15, shkronja (c), të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, nenin 58 të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “*Masa Disiplinore*”, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Për problemet e konstatuara në lidhje me menaxhimin financiar dhe auditin e brendshëm:

1. Znj. P.A, me detyrë Drejtor Ekonomik;
2. Znj. S.B, Përgjegjëse e Njesisë së Auditit të Brendshëm;
3. Z. R.H, auditues në Njësinë e Auditit të Brendshëm;
4. Znj. A.R, audituese në Njësinë e Auditit të Brendshëm;
5. Znj. E.SH, me detyrë Drejtore e burimeve njerëzore.

Për problemet e konstatuara në lidhje me kontabilitetin dhe pasqyrat financiare:

6. Znj. P.A, me detyrë Drejtor Ekonomik, nëpunës zbatues;
7. Znj. R.K, me detyrë specialiste finance;
8. Znj. B.O, me detyrë specialiste finance.

Për problematikat e konstatuara në lidhje me të ardhurat, si më poshtë vijon:

9. Znj. S.B, me detyrë Përgjegjëse e sektorit të taksave dhe tarifave vendore;
10. Znj. E.T, me detyrë Specialiste në sektorin e taksave dhe tarifave vendore;

Për problematikat e konstatuara në lidhje me IMTV:

11. Znj. E.O, me detyrë përgjegjëse e sektorit juridik;
12. Znj. A.M, me detyrë Kryeinspektore e IMTV;

Për problematikat e konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e territorit:

13. Znj. J.G, me detyrë Drejtore e DPKTZH;
14. Znj. A.B, me detyrë Specialiste në DPKTZH;
15. Z. B.T, me detyrë Specialist në DPKTZH;
16. Z. R.Sh, me detyrë Topograf në DPKTZH;

Për anëtarët e Njësisë së prokurimit, Komisionit për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si më poshtë vijon:

17. Znj. E.O, me detyrë përgjegjëse e sektorit juridik;
18. Znj. J.G, me detyrë Drejtore e DPKTZH;
19. Z. B.T, me detyrë Specialist në DPKTZH;
20. Z. N.K, me detyrë Nënkyetar i bashkisë;
21. Znj. D.Ç, me detyrë Përgjegjëse e Financës, larguar nga puna;
22. Z. E.V, me detyrë Specialist i Sektorit të PKZHT;
23. Znj.O.M, me detyrë përgjegjëse e sektorit të projekteve, larguar nga puna;
24. Z. E.D, me detyrë ish inxhinier në sektorin e projekteve, larguar nga puna;
25. Z. G.Ç, me detyrë Specialist i Sektorit të Shërbimeve;
26. Znj. D.I, me detyrë Drejtore e Urbanistikës, larguar nga puna;
27. Z. R.Sh, me detyrë Topograf në DPKTZH;
28. Znj. Sh.D, me detyrë Nënkyetare e bashkisë;
29. Znj. A.M, me detyrë Kryeinspektore e IMTV;
30. Z. F.Gj, me detyrë arkitekt në sektorin e projekteve;
31. Z. M.G, me detyrë Drejtor i drejtorisë së bujqësisë;
32. Znj. A.B, me detyrë Specialiste në DPKTZH;
33. Z. H.K, me detyrë Përgjegjës i sektorit të shërbimeve;
34. Znj. S.B, me detyrë Përgjegjëse e sektorit të taksave dhe tarifave vendore;
35. Znj. E.Z, me detyrë specisliste ekonomiste;
36. Znj. E.L, me detyrë supervizore në sektorin e shërbimeve;
37. Z. I.Gj, me detyrë me detyrë Nënkyetar i Bashkisë;
38. Znj. H.Xh, me detyrë supervizore në sektorin e shërbimeve.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e poshtëpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Nga verifikimi rezultoi se:

Lidhur me masat disiplinore si më sipër cituar, Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.2643 Prot., Dt.24.05.2023 ka miratuar Urdhër Nr.153 Dt.24.05.2023 “Për evidentimin e performancës dhe llojit të masave disiplinore për punonjësit në varësi të lëna nga Raport i Përfundimtar i Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën Janar 2019 deri në Dhjetor 2021”, ku me shkresë:

- 1) Nr.2790 Prot., Dt.02.06.2023 procesverbal “Mos fillim ecurie disiplinore”;
- 2) Nr.2791 Prot., Dt.02.06.2023 procesverbal “Mos fillim ecurie disiplinore”;
- 3) Nr.2792 Prot., Dt.02.06.2023 procesverbal “Mos fillim ecurie disiplinore”;
- 4) Nr.2793 Prot., Dt.02.06.2023 procesverbal “Mos fillim ecurie disiplinore”;
- 5) Nr.2794 Prot., Dt.02.06.2023 procesverbal “Mos fillim ecurie disiplinore”;
- 6) Nr.2789 Prot., Dt.02.06.2023 procesverbal “Mos fillim ecurie disiplinore”;
- 7) Nr.2795 Prot., Dt.02.06.2023 procesverbal “Mos fillim ecurie disiplinore”;

- 8) Nr.2796 Prot., Dt.02.06.2023 procesverbal “Mos fillim ecurie disiplinore”;
9) Nr.2818/2789 Prot., Dt.02.06.2023 procesverbal “Mos fillim ecurie disiplinore”
-Ka proceduar me mos fillim ecurie disiplinore për të gjithë nëpunësit si më lartcitur.

Zbatimi: Rekomandimi është zbatuar.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

- Ngritja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm ka mangësi.
- Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin, aktivitetet, planveprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.
- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Rezulton se, nga 3(tre) njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
- Nuk është evidentuar puna e anëtarëve GMS, duke u dokumentuar takimet dhe mbledhjet të për hartimin e planit strategjik dhe PBA.
- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.
- Në Bashkinë Shijak nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut.
- Nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në Bashki në të gjitha nivelet e saj, pra mungon regjistri i riskut. Është ngritur grupi i menaxhimit të riskut dhe i mungesës së veprimtarisë së tij por nuk janë hartuar as planet e veprimit për menaxhimin e riskut. Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.
- Nuk është bërë vlerësimi i riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e Bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.
- Në Rregulloren e Brendshme në Kreun IX “Administrimi, Komunikimi dhe Ruajtja e dokumentacionit” në nenin 25“Të dhëna të përgjithshme” pika 5 “Ruajtja e dokumentacionit”

përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Bashkia Shijak nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Sistemi nuk ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara dhe gjithashtu nuk ka rregulla të shkruara për ruajtjen e aktiveve.

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e Bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Në Bashkinë Shijak mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit (*Më hollësisht trajtuar në pika 2.1 faqe 16-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Shijak, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat:

- Për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij;
- Për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve;
- Hartimin e regjistrit të riskut, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit;
- Të aplikojë programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar;
- Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”;
- Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”;
- Të hartohen programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit nga Bashkia Shijak;
- Të organizojë trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, në Bashkinë Shijak është organizuar dhe ka funksionuar Njësia e Auditimit të Brendshëm e përbërë nga dy specialistë si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit. Nga këta asnjë nga punonjësit nuk janë të pajisur me çertifikatën e auditimit të brendshëm, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, neni 11 dhe të VKM Nr.83, Datë 03/02/2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 3., por u konstatua që janë në proces certifikimi.

- Në të gjitha dosjet e auditimit mungon memo e planifikimit, pra projektdrafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit. Në procesin e planifikimit nuk është vlerësuar si duhet risku, përllogaritja e tij si dhe përcaktimi i materialitetit.

-Në fund të procesit të auditimit mungojnë letrat e punës për secilin auditues, të cilat duhet të përfshijnë regjistrimin e punës së audituesit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemit, dokumentet e punës audituese. Mungon vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë NJAB, i cili kryhet nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik.

-Audituesit e brendshëm në punën e tyre pavarësisht dhënies se rekomandimeve nuk janë treguar këmbëgulës në auditimin e zbatimit të rekomandimeve dhe nuk është bërë në afatin e përcaktuar në konkluzione mbi problematikat e punës si auditues.

- NJAB nuk ka kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, të tilla si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, lejet e ndërtimit, etj..

-Për rekomandimet e lëna nuk është bërë analiza e tyre, pasi nuk është hartuar program i veçantë për shkallën e zbatimit të tyre, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuara në raportet e auditimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 16-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, të merren masa për trajnimin dhe certifikimin e audituesve të rinj, për rritjen e aftësisë profesionale të tyre. Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve, përcaktimit të përgjegjësi si dhe formulimit konkret të rekomandimeve.

NJAB të kryejë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik. Të planifikohet dhe realizohet program angazhimi për ndjekjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Shijak për arkëtim ndaj të tretëve, nuk është pasqyruar saktë, sepse kjo llogari është pasqyruar më pak për vlerën 318,780,035 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, për vlerën prej:

Popullata:

- Taksë ndërtese në vlerën 96,188,924 lekë
- Taksë pastrimi në vlerën 106,950,267 lekë
- Taksë ndriçimi në vlerën 7,025,445 lekë
- Taksë toke në vlerën 134,251,162 lekë
- Taksë trualli në vlerën 809,060 lekë

Biznes:

- Taksë ndërtese në vlerën 51,466,534 lekë
- Taksë trualli në vlerën 7,481,373 lekë
- Taksë tabele në vlerën 2,870,548 lekë
- Taksë pastrimi në vlerën 31,254,192 lekë
- Taksë ndriçimi në vlerën 702,542 lekë

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12 pika 3 shkronjën “ë”, i ndryshuar; rubrika 2.3, paragrafi 21,

shkronja “c” në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 54-73 të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Shijak, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023

4. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i pasqyrave financiare, llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën 33,198,431 lekë. Kjo llogari, nuk duhej paraqitur në pasqyrat financiare, pasi sipas Udhëzimit nr. 5 datë 21.02.2022, “Rregjistrimet e thesarit në llogarinë 486 nuk janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar që prodhohet nga SIQF në nivel njësie shpenzuese, ose njësie publike qendrore ose vendore për efekt rakordimi me këto të fundit”. Ky mosveprim është në kundërshtim me UMF nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e ministrit të financave dhe ekonomisë nr.8 datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 54-73 të Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Shijak, të marrë masa që detyrimet e prapambetura përkatësisht llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe llogaritë 401-408 “Furnitor dhe llogari të lidhura me to” të regjistrohesh me kundërparti në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin të drejta”.

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në Bashkinë Shijak në datën 31.12.2022 përbëhet nga 16 studime e projekte në vlerën 61,651,348 lekë, të cilat i përkasin investimeve nga të ardhurat e veta të Bashkisë Shijak.

Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike, u konstatua se disponohen gjithsej 139 projekte dhe studime, të cilat janë të pakontabilizuara. Këto projekte dhe studime janë hartuar në vite, edhe përpara periudhës së konsolidimit të pushtetit vendor. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Standarti Kombëtar Kontabël nr.5 “Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale” pikat 47-56. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 54-73 të Raportit të Auditimit).

5.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës në Bashkinë Shijak, të marrë masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet të llogarisë 202 “Studime dhe kërkime AAJM” për investimet të cilat kanë mbaruar dhe janë kontabilizuar dhe vlerat e projekteve t’i shtohen vlerës së aktivitetit.

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më shumë për vlerën 8,793,226 lekë, si rrjedhojë e kontabilizimit në këtë llogari të disa makinerive, si 1 eskavator, 2 traktor dhe 1 kamion pastrimi, të cilat janë makineri dhe jo mjete transporti, si dhe duhet të klasifikohen në llogarinë nr.214. Për këto makineri duhet të aplikohet normë tjetër amortizimi (5%) dhe jo (20%). Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme

bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik-instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune – llogaria 7-shifrore 2140240-Paisje dhe makineri për konstruksione (ndërtime); 2140260-Paisje pastrimi për rrugët; 2140320-Mjete dhe paisje të tjera teknike (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 54-73 të Raportit të Auditimit*).

6.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës në Bashkinë Shijak, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”.

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se Aktivet Afatgjata Financiare, në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën 3,500,000 lekë. Kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 242,600 lekë në pasqyrat financiare. Nga auditimi i dokumenteve financiare dhe verifikimi në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit, u konstatua se Bashkia Shijak, në 31.12.2022 paraqitet aksionere edhe në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime Durrës” Sh.a, me NUIS M.....M dhe objekt “*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm...*”, për të cilën nuk ka depozituar kuotat e pjesëmarrjes, si Aksionare me 2.43% të aksioneve. Numri total i aksioneve është 100,000 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 10,000,000 lekë. Kjo shoqëri është themeluar në datën 31.08.2022. Bashkia Shijak zotëron 2,426 aksione me të drejtë vote, në vlerën totale **242,600 lekë**. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*”; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar*”; SKK nr. 5 “*Aktivitet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jomateriale*” pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 “*Investime në Pjesëmarrje*” pika 35, etj. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 54-73 të Raportit të Auditimit*).

7.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shijak, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të regjistruar dhe sistemuar në kontabilitet, në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël llogarinë 26 “*Pjesëmarrje në ka pitalet e veta*”, për vlerën totale 242,600 lekë.

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se gjendja e llogarive 230 “*Investime për aktive afatgjata jo materiale*” dhe 231 “*Investime për aktive afatgjata materiale*” në datën 31.12.2021 paraqitet në vlerën 18,948,027 lekë dhe po aq paraqitet në datën 31.12.2022. Në PF të disponueshme në sistemin e thesarit, vlera totale e investimeve është 18,948,027 lekë, përkatësisht 0 lekë në llogarinë 230 “*Investime për aktive afatgjata jo materiale*” dhe 18,948,027 lekë në llogarinë 231 “*Investime për aktive afatgjata materiale*”. Nga auditimi i investimeve të vitit 2022 për Bashkinë Shijak janë 9 investime në proces të cilat nuk paraqiten në llogarinë 231 “*Investime për aktive afatgjata materiale*” por këto investime janë kontabilizuar në llogaritë e klasës 2 të aktivitetit. Veprime këto në kundërshtim me UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar*”; SKK nr. 5 “*Aktivitet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jomateriale*” pikat 55, 56, 57. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 54-73 të Raportit të Auditimit*).

8.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës në Bashkinë Shijak, të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave

pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerën e plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se në datën 31.12.2022, shuma e llogarive 42 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, të 436 “Sigurime shoqërore”, të cilat janë në vlerë 17,490,591 lekë këto llogari nuk kuadrojnë me kundërpartinë llogarinë 4342 “Operacione me shtetin” e cila është rregjistruar në bilanc në vlerën 16,062,853 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzim nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 54-73 të Raportit të Auditimit).

9.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës në Bashkinë Shijak, të marrë masat e nevojshme për kontabilizim e plotë dhe të saktë të llogarive 42 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, të 436 “Sigurime shoqërore” me kundërpartitë llogarinë nr 4342 “Operacione me shtetin”.

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të likuiduara plotësisht, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës, pavarësisht se nuk janë marrë të gjitha në dorëzim nga Bashkia Shijak, nuk është bërë zhblllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit. Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për zhblllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së garancisë sipas objekteve ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kap II “Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të VKM nr. 3, datë 15.2.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2001 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publike” i ndryshuar pikat 42 – 50 të tij, UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 54-73 të Raportit të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhblllokimin e fondeve të ngurtësuara.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Për llogaritë 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*”, 212 “*Ndërtime e konstruksione*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete vepra ujore*”, nga Bashkia Shijak nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër tokat, trojet dhe terrenet të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike.

Këto llogari janë mbajtur në bilancin kontabël pa pasur një analizë të detajuar, ku të përcaktohet origjina e vlerës së aseteve. Nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës disponohet informacion vetëm për shtesat vjetore të llogarive 210, 211, 212, 213, 214 dhe 215. Fakti që nuk ka një regjistër kontabël për të gjitha AAM, e vështirëson më tej njohjen dhe verifikimin e saktësisë së vlerave kontabël të këtyre llogarive.

Në kontabilizimin e këtyre aktiveve, nuk është marrë në konsideratë “*Njohja fillestare*”, por vetëm “*Vlerësimi i mëparshëm*”, duke mos njohur origjinën e tyre. Mosnjohja e origjinës së aktiveve është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Aneksi 1 “*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*”, Pika 2, Klasa 2, “*Aktivet afatgjata*” (përbërja dhe trajtimi kontabël), në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*”, Kreu VI “*Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme*”, UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 54-73 të Raportit të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëparshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

11.2 Rekomandimi: Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e Urdhërave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “*Toka, troje terrene*”; 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*”; 212 “*Ndërtime e konstruksione*”; 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”; dhe 215 “*Mjete transporti*”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëparshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës.

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e vetë Bashkisë Shijak së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe buxhetit të shtetit, për vitin 2022 kanë diferencë të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2022 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 2,202,808 mijë lekë, ndërsa realizimi vlerën 1,325,130 mijë lekë, ose në masën 60.1%. Në mos realizimin e buxhetit ka ndikuar niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Për

vitin 2022 investimet janë planifikuar në vlerën 1,407,834 mijë lekë, realizuar 292,172 mijë lekë, ose në masën 20.7%. Gjithashtu edhe shpenzimet operative të cilat janë planifikuar në vlerën 241,512 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 153,297 mijë lekë ose në masën 63.4%. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”; UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe VKB përkatëse (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 37-54 të Raportit të Auditimit*).

12.1. Rekomandim: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Shijak, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatohet se Bashkia Shijak në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive në vlerën 7,114,213 lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Por gjatë vitit 2022 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 28,410,631 lekë, duke e çuar në datë 31.12.2022 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 33,198,431 lekë. Peshën kryesore të detyrimeve e zënë ato për investime në vlerën 27,935,303 lekë, ose në masën 84% të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta. Sa sipër, vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022), është rritur me 26,804,219 lekë, ose në masën prej 476%. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 2 dhe 3 pika 3 dhe UMFE Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, pika 153-162 “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 37-54 të Raportit të Auditimit*).

13.1. Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shijak dhe Drejtoria Ekonomike, me qëllim shmangien e problemeve financiare, të marrë masa për menaxhimin sa me efektiv të investimeve dhe të ketë gjithmonë në konsideratë likuiditetin, duke mos të marrë angazhime buxhetore të reja pa shlyer detyrimet e prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e 7 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 3 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator, veprime jo në përputhje me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 2, 39, 40, 82 si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar neni 26, 39, 40. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 73-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

14.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullari të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publike, kriteret e veçanta të

kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit publik për blerje mallrash, në 1 rast procedura duhej të ishte ndarë në lote, konkretisht procedura e vitit 2022 me objekt “*Blerje karburant*” pasi mallrat objekt prokurimi nuk janë të njëjta. Mos ndarja në lote kufizon mundësinë e operatorëve ekonomik për të paraqitur ofertë vetëm për një mall. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 42 “*Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote*” të VKM-në nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 73-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1 Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, për punët/mallrat/shërbimet të cilat është e mundur ndarja e saj në lote, të marrë masa për të realizuar këtë ndarje dhe hartimin e kërkesave të veçanta për secilin lot, pasi diversiteti që vjen nga kontratat e shumta apo lotet mund të përmirësojë konkurrencën dhe të rrisë efikasitetin.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 7 procedurave të prokurimit publik të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022 – 31.12.2022, në 2 raste për kontrata me vlerë 196,900 mijë lekë, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2023, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, neni 2 “*Qëllimi*”, neni 3 “*Parimet të përgjithshme*”, dhe nenin 87 “*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*” pika 3. (*Trajtuar më hollësisht në 2.4 faqe 73-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mos realizimin me sukses të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës me objekt “*Riforcimi i njërive të banimit në ndërtesa (pallat), të pabanueshme, të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019*”, procedurë e llojit e kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit e cila është kryer me 2 faza, KVO në fazën e dytë rezulton se nuk ka shpallur OE fitues, pavarësisht se kanë kaluar 4 muaj nga paraqitja e ofertave, duke shkaktuar një vonesë të paargumentuar në aktivitetin që kryen ky komision, veprim në kundërshtim me pikën 5 të nenit 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, dhe Aktin Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “*Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore*” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 73-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe Komisioni për Vlerësimin e Ofertave, të marrin masa për shmangien dhe mos përsëritjen e vonesave të paargumentuara në fazën e vlerësimit të ofertave, duke tejkaluar afatet ligjore dhe qëllimin mbi të cilin kryhen këto procedura.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në dy raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, sic janë distancat nga trupi i rrugës së propozuar dhe intensitetin maksimal të lejuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 95-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1. Rekomandim: Nga DPTSHIP dhe Bashkia Shijak të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, edhe në rastet kur këto kushte ndikohen nga projektet e institucioneve të tjera.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në katër raste nuk është kërkuar mendimi i të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit ose nuk është respektuar mendimi i tyre (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 95-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1. Rekomandim: Nga DPTSHIP Shijak të merren të gjitha masat për marrjen dhe respektimin e mendimit dhe vendimeve të të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në asnjë rast, objektet e miratuara me leje ndërtimi, nuk janë pajisur me vërtetim për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 95-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

20.1. Rekomandim: Nga DPTSHIP Shijak të merren masa për të kërkuar dokumentacionin e parashikuar në ligj, për të gjitha rastet që ky ligj parashikon, deri në pajisjen e subjekteve me vërtetim risku sipas shtojcave, bashkëlidhur vendimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 4 rastet e audituara, projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues, si projektet që përbëjnë projektin ndërtimor, dokumenti i regjistrimit në QKB dhe/ose ekstrakti historik tregtar, licenca profesionale, rilevimi me mangësi (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 95-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1. Rekomandim: Nga DPTSHIP Shijak të merren masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi, vërtetimet e regjistrimit në sistemin tatimor të të gjithë hartuesve të projekteve teknike, si dhe të mos miratojnë asnjë leje ndërtimi me mangësi në projektin ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 2 raste të audituara, mungojnë vërtetimet se subjektet zhvilluese nuk kanë detyrime të paguara ndaj OSHEE, UK dhe DTTV (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 95-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

22.1. Rekomandim: Bashkia Shijak dhe DPTSHIP të marrë masa të mos miratojnë asnjë leje ndërtimi në mungesë të vërtetimeve që tregojnë se subjektet zhvilluese nuk kanë detyrime të paguara ndaj OSHEE, UK dhe DTTV.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 2 raste të audituara, tipologjia e objektit në zhvillim nuk është në përputhje me zërin kadastral (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 95-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

23.1. Rekomandim: Bashkia Shijak dhe DPTSHIP të marrë masa të mos miratojë asnjë leje ndërtimi, ku zëri kadastral nuk i pershtatet tipologjisë së zhvillimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të certifikatave të përdorimit u konstatua se në 1 rast, dokumentacioni i nevojshëm për pajisje me certifikatë përdorimi nuk është i plotë, si janë akti përkatës i menaxhimit të mbetjeve urbane, fotot e objektit të përfunduar nuk janë në të gjitha drejtimet. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 105 - 129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

24.1. Rekomandim: Bashkia Shijak dhe DPTSHIP të marrë masa të mos miratojë asnjë certifikatë përdorimi deri në plotësimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës organizative të IMTV Bashkia Shijak, konstatohet se arsimimi i inspektorëve nuk është konform përcaktimeve të **Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007**, i ndryshuar, pasi një prej inspektorëve nuk ka arsimimin e parashikuar në ligj, gjithashtu në strukturën e IMTV ka vetëm punonjës me profil arsimimi në drejtësi, pra mungojnë inspektor me arsimim në profile teknike që kanë lidhje me ndërtimtarinë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 95-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

25.1. Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Shijak të merren të gjitha masat për plotësimin e strukturës me inspektor të profileve teknike që kanë lidhje me ndërtimtarinë, sipas parashikimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV, konstatohet se niveli i arkëtimeve është i ulët, IMTV dhe Bashkia Shijak nuk kanë marrë të gjitha masat për arkëtimin e këtyre gjobave, kjo në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, Neni 30, pika 4; Neni 31, pika 5 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 95-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

26.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shijak dhe IMTV të merren masa për kryerjen e të gjitha procedurave që ligji parashikon, për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha masave administrative të vendosura nga IMTV.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me vendosjen e masave administrative kundrejt shkelësve të ligjit, konstatohet se në asnjë rast nuk është faktuar se vlera e masës administrative është e barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, si parashikohet në **Ligjin 107/2014**, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 52, “Kundërvajtjet administrative”, pika 1, nënpika e) dhe ë), si dhe pika 2 e po këtij neni, kjo me qëllim maksimizimin e të ardhurave nga vjelja e gjobave (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 95-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

27.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shijak dhe IMTV të merren masa për të ndëshkuar kundërvajtësit e ligjit me masa administrative në raport proporcional me shkeljen e konstatuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me planet mujore të punës, të miratuara nga kryeinspektori, si dhe raportimi tre mujor drejtuar Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, konstatohet se nuk janë kryer në mënyrë periodike, ose nuk janë kryer fare (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 95-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

28.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shijak dhe IMTV të merren masa për hartuar dhe miratur planet mujore të punës nga kryeinspektori, gjithashtu të hartojë dhe të dërgojë pranë IKMT raportimin tre mujor, sipas afateve të parashikuara në ligj.

Menjëherë dhe në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të mbajtura nga ana e inspektorëve të IMTV për të gjitha rastet ku konstatohet shkelje e ligjit dhe prishja e objekteve të jashtëligjshme, konstatohet se mungon dokumentimi fotografik i shkeljes, si pjesë integrale e relacionit përkatës, ku parashtrahet gjendja e konstatuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 105 - 129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

29.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shijak dhe IMTV të merren masa për krijimin e raporteve përkatëse nga ana e inspektorëve për të gjitha rastet e konstatuara, si dhe të përfshihet në këto raporte dokumentimi fotografik i shkeljes, si pjesë e raportit.

Menjëherë dhe në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i blloqeve të proces verbaleve të konstatimit të IMTV, si dhe vendimeve të pezullimit, të dënimit me gjobë dhe prishjes, konstatohet se jo gjithmonë procedurat janë mbajtur sipas parashikimeve ligjore, më konkretisht, në një rast mungon proces verbali i konstatimit të kundërvajtjes, në 2 raste mungon proces verbali i pezullimit të punimeve, në 5 raste mungojnë procesverbalet e konstatimit, vendimet e pezullimit, si dhe vendimet e masës administrative. Gjithashtu, nuk janë respektuar afatet kohore për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, pasi është mbajtur procesverbali i konstatimit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 105 - 129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

30.1. Rekomandim: Bashkia Shijak të marrë të gjitha masat për mbajtjen e procedurave brenda afateve, si dhe për ndëshkimin e personave përgjegjës për mosrespektimin e afateve kohore për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, pasi është mbajtur procesverbali i konstatimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i zbatimit të punimeve në objektin “Rikonstruksion i tubacionit të dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V = 2000 m³ Shijak, rrjet shpërndarës fshati Maminas – Kareç- Bilalas – Karpen - Bodinak”, Bashkia Shijak, u konstatua se shtresat asfaltike të realizuara për mbulimin e kanalit, përgjithësisht janë të dëmtuara. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 88-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

31.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Shijak të ngrejë një grup pune të specializuar, për përlogaritjen e volumit të punës së shtresave asfaltike të dëmtuara, e cila të bëhet pjesë e

rekomandimit që do ti bëhet sipërmarrësit për riparimin e difekteve, para përfundimit të garancisë së punimeve dhe marrjes përfundimtare në dorëzim të objektit dhe në rast mosrealizimi të bëjë mbajtjen e garancisë së difekteve.

Menjëherë

32. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i zbatimit të punimeve në objektin “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për qytetin Shijak”, u konstatua se ishin situacionuar por nuk ishin vendosur 2 stacione të transmetimit për radio fikse, 4 panele diellore, 1510 matës të ndryshëm uji dhe regjistrimi dhe konfigurimi i tyre. Në observacionin e sjellë nga mbikëqyrësi i punimeve, është bashkëlidhur procesverbali i mbajtur ndërmjet përfaqësuesve të sipërmarrësit dhe UKD (Sektori Shijak), sipas të cilit është bërë realizimi i plotë i këtyre zërave. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 88-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

32.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Shijak të ngrejë një grup pune të specializuar, për verifikimin e kryerjes së këtyre zërave të punimeve në terren, duke mbajtur një procesverbal për realizimin e detajuar të tyre, para përfundimit të garancisë së punimeve dhe marrjes përfundimtare në dorëzim të objektit dhe në rast mosrealizimi të bëjë mbajtjen e garancisë së difekteve dhe të ndjekë të gjitha masat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre.

Menjëherë

33. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, nga objektet inventari të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 1,104,678,085 lekë, objektet nuk janë pajisur plotësisht me titull pronësie, konkretisht sipas llogarive paraqiten si më poshtë: - llog 210 “Toka troje terrene”, elementë në vlerën neto 24,806,885 lekë -llog. 211 “Pyje plantacione”, elementë në vlerën neto 4,830,000 lekë -llog. 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 55 objekte me vlerën neto 1,075,041,200 lekë. -Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 54-73 të Raportit të Auditimit).*

33.1 Rekomandimi: Bashkia Shijak duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Dega Shijak dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të përllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Brenda datës 31.12.2023.

34. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se janë rekomanduar nga KLSH janë lënë gjithsej **90** rekomandime, të grupuara në **40** masa organizative, **4** masa shpërblim dëmi, **8** masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike në përputhje me parimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit të fondeve publike dhe **38** masa disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **40** masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, **18** janë zbatuar, **3** janë në proces zbatimi, **8** nuk janë zbatuar dhe **11** janë zbatuar pjesërisht.

-Për shpërblimin e dëmit janë lënë **4** rekomandime, të cilat janë **3** në proces zbatimi dhe **1** nuk është zbatuar.

-Për eliminimin e efekteve negative financiare janë lënë **8** rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht, **3** janë zbatuar, **5** nuk janë zbatuar.

-Për masa disiplinore janë lënë **38** rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat janë zbatuar plotësisht (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 110-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

34.1. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Shijak kërkohet analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive, shkaqet dhe arsyet e moszbatimit të rekomandimeve, sipas Planit të Miratuar. Për sa më lart, kërkohet fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës që nuk kanë zbatuar rekomandimet e pranuar.

Menjëherë

34.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Shijak hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për shpejtimin e masave në proces zbatimi, si dhe zbatimin e plotë të masave të pazbatuara dhe atyre të zbatuara pjesërisht, si më poshtë:

A. MASAT ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Shijak, të merren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurohen programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Të hartohen dhe zhvillohen programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve realizimit të objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Të vendoset një sistem komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve, përcaktimit të përgjegjësive si dhe formulimit konkret të rekomandimeve. Njësia e auditimit të brendshëm të kryejë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik. Të planifikohet dhe realizohet program angazhimi për ndjekjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen e objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi.

3.1. Rekomandimi: Në Bashkinë Shijak, Drejtoria Ekonomike dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të marrin masa për të miratuar me Vendim të veçantë në Këshillin Bashkiak Planin vjetor të buxhetit, të analizojnë çdo tregues të mos/realizimit të buxhetit vjetor dhe të

tregojnë vëmendje për të planifikuar në buxhet fonde për ato programe që janë pjesë e strategjive kombëtare kryesisht të mjedisit, për të hartuar një plan të buxhetit vjetor dhe afatmesëm sa më real dhe në koherencë me nevojat dhe interesat e komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1. Rekomandimi: Në Bashkinë Shijak, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Shijak, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Shijak, të marrë masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet, saktësimet e gjendjeve të llogarive dhe rakordimet me Degën e Thesarit të jenë në bazë të shifrave reale, mbështetur në llogaritë analitike.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.2. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

7.3. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”; 211 “Pyje,

Kullota, Plantacione”; 212 “*Ndërtime e konstruksione*”; 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”; 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*” dhe 215 “*Mjete transporti*”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës.

7.4. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” duke plotësuar analizën e llogarive, ku të merren në konsideratë edhe vlerat e gjetura gjatë auditimit nga KLSH. Gjithashtu, gjatë vitin ushtrimor në vazhdim, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 “*Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit*”.

Menjëherë

8.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të shoqërive: **1.** “*Ujësjetllës Kanalizime Shijak Sh.a.*”, me NUIS L62401502P, për 100% të aksioneve, në vlerën **3,500,000 lekë**; **2.** “*Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.a.*” Sh.a., me NUIS J61819502V, për 11.6% të aksioneve në vlerën **51,848,288 lekë**, si dhe regjistrimin e kapitalit aksionar të këtyre shoqërive prej **55,348,288 lekë** në debi të llogarisë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Menjëherë

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejohet likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuar.

Në vijimësi

10.1. Rekomandimi: Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llogarisë 520 “*Disponibilitete në thesar*” dhe në kredi të llogarisë 476 “*Të ardhura të caktuara për t’u përdorur*”.

Me konstatimin e shpenzimit, (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 “*Investime për aktive afatgjata materiale*” dhe në kredi të llogarisë 404 “*Furnitorë për investime*”.

Në momentin e pagesave të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 “*Furnitorë për investime*” dhe në kredi të llogarisë 520 “*Disponibilitete në thesar*”.

Në fund të vitit ushtrimor, për fondet e përdorura për investimet e papërfunduara/në proces, të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 “*Të ardhura të caktuara për t’u përdorur*”, në kredi të llogarisë 720 “*Grant korrent i brendshëm*” dhe në kredi të llogarisë 4342, “*Operacione me shtetin (të drejta)*” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit

ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.

Me përfundimin e investimit, të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizmi i aktivitetit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 “*Aktive afatgjata materiale*” dhe në kredi të llogarisë 231 “*Investime për aktive afatgjata materiale*”.

Me kapitalizmin e aktivitetit, (për aktivitetet e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 “*Të ardhura të caktuara për t’u përdorur*”, në kredi llogarisë 105 “*Grante të brendshme kapitale*” për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 “*Shtesa të fondit bazë*” dhe në debi të llogarisë 105 “*Grante të brendshme kapitale*” për vlerën e aktiveve të blera.

Në vijimësi

11.1. Rekomandimi: Nëpunësi autorizues, Nëpunësi zbatues dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të Bashkisë Shijak të marrin masa për të zbatuar plotësisht procedurat standard të Inventarizimit të aktiveve të bashkisë me gjithë dokumentacionin e domosdoshëm raportues si dhe në miratimin e strategjive për menaxhimin e risqeve dhe masat konkrete për minimizimin e tyre, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë

12.2. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në fazën e përgatitjes së projekt buxhetit vjetor dhe PBA-ve, të shikoj mundësinë e krijimit të një fondi në buxhet për shpërbllim financiar bazuar në vlerësimin 6 dhe 12 mujor në Formularin e performancës për punonjësit me “*Status civil*” dhe përcaktimeve të VKM nr. 68/2018 për punonjësit me “*Kod pune*”, me qëllim motivimin e punonjësve për realizimin me efektivitet të objektivave institucionale;

Menjëherë dhe në vijimësi

13.5. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa që asnjë pjesë e projekteve të mos bëhet nga punonjës të pakualifikuar dhe të papajisur me liçencat profesionale përkatëse, sipas fushës specifike të profesionit. Në rast se nuk është mundësia për të prokuruar projektet e investimeve, të merren masa për të kontraktuar specialistë të jashtëm, të cilët të kenë kualifikimet e nevojshme për të bërë projektet, sipas rastit.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve, duke dhënë argumente për secilin kriter, të cilat të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit. Njësia e Prokurimit, në hartimin dhe miratimin e kriterëve të kërkesave për kualifikim, pjesë integrale e DST, të argumentojë me hollësi çdo kriter të kërkesave kualifikuese, bazuar mbi natyrën e kontratës, zërat e preventivit, volumet e punimeve, kohëzgjatjen e kontratës, orët e punës për njësi të zërave të preventivit, analizave sipas manualit teknik të çmimeve, numrin e nevojshëm të mjeteve, punonjësve, liçencave, etj, duke i pasqyruar në procesverbalin përkatës, i cili të jetë pjesë e dosjes së prokurimit.

14.2. Rekomandimi: Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit, Bashkia Shijak, të marrë masa për shmangien e kritereve të tepërta dhe të paargumentuara, të cilat nuk mbështeten në bazën ligjore, por krijojnë pengesë dhe kufizojnë numrin e operatorëve ekonomikë për të konkurruar në procedurat e prokurimit publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të AK, të nxjerrë urdhërat për krijimin e komisioneve/grupeve të punës për monitorimin dhe marrjen në dorëzim të të gjitha objekteve për të cilat kanë përfunduar punimet, duke bërë verifikimet përkatëse për zbatimin e projekt-preventivave dhe specifikimeve teknike të miratuara, si dhe të marrë masa që në ngritjen e grupeve të punës, të përcaktohen qartë detyrimet dhe përgjegjësitë për secilin anëtar, në mënyrë që objektet e ndërtuara me financim nga Bashkia, t'i shërbejnë sa më mirë dhe sa më shpejt komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.1. Rekomandimi: Nga ana e DPT (Drejtoria e Planifikimit të Territorit) Bashkia Shijak të merren masa të pajisin me “Vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi”.

Në vijimësi

22.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, kryesisht nga ana e K/inspektorit të IMTV-së, të merren masa për përgatitjen e informacionit periodik 3-mujor për IKMT-në, në lidhje me masat e marra. Gjithashtu, K/Inspektori të miratojë aktet e kontrollit për objektet e pajisura me leje Ndërtimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

22.2. Rekomandimi: Drejtoria Juridike, në lidhje me gjobat e pa arkëtuara duhet t'i drejtohet Gjykatës Administrative për kthimin e gjobave në tituj ekzekutivë. Nga Drejtoria Juridike, të kërkohet në Gjykatën Administrative rivendosja në afat e vendimeve me gjobë, të vendosura gjatë viteve të mëparshme. Për personat e dënuar me gjobë, të aplikohet kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë, për mos derdhje në afat të gjobës deri në një muaj.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masat për trajtimin me nivelin e pagës sipas akt-emërimeve dhe akteve ligjore si dhe në përlllogaritjen e vlerës së përfituar pa të drejtë të shefit të MZSH-së emëruar në detyrë me gradën inspektor në masën prej 9,000 (nëntë mijë) lekë çdo muaj, nga data e fillimit të përfutimit të pagës (01.01.2018) dhe në vijim, me gradën si “kryeinspektor zjarrfikës”, në masën **513,000 lekë** (deri në datën 30.09.2022); gjithashtu, në vijim të trajtohet me nivelin e pagës “inspektor zjarrfikës”.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1. Rekomandimi: Nga ana e sipërmarrësit të punimeve të merren masa për të zhdëmtuar vlerën prej **309,349 lekë**.

Menjëherë

3.1. Rekomandimi: Nga ana e sipërmarrësit të punimeve të merren masa për të zhdëmtuar vlerën prej **302,900 lekë**.

Menjëherë

4.1. Rekomandimi: Nga ana e sipërmarrësit të punimeve të merren masa për të zhdëmtuar vlerën prej **368,190 lekë**.

Menjëherë

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1. Rekomandim: Bashkia Shijak të marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Shijak ShA, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak sipas legjislacionit në fuqi, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

1.2. Rekomandim: Bashkia Shijak të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerave debitorë prej **14,849,000 lekë** nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës dhe **12,872,000 lekë** nga mos pagesa e tarifës së pastrimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet tarifave apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj. Të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Shijak, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, et.) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese e të dhënave.

2.2. Rekomandimi: Bashkia Shijak, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Shijak dhe Qarku Durrës). Për familjet fermerë debitorë të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë kohën e papaguar për vlerën **47,802,000 lekë** dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera përkatëse, sipas rastit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak nëpërmjet bashkëpunimit institucional t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Durrës, që të mos lëshojë dhe të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Shijak. Drejtoria e planifikimit urban, kontrollit të zhvillimit dhe projekteve, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e vlerës **2,161,311 lekë** nga të gjithë individët e listuar si debitorë në Anekset bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Menjëherë

4.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj subjekteve debitore në vlerën prej **39,217,179 lekë**, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së Financës dhe sektorit juridik të Bashkisë Shijak, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

5.1. Rekomandimi: Sektori i taksave dhe tarifave vendore të saktësojë listat e bizneseve të pajisura me leje ndërtimi, për projektet e investimeve të prokuruar për vitet 2019-2020, pavarësisht nëse kanë selinë kryesore jashtë territorit të Bashkisë Shijak por që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, si dhe të nxjerrin njoftim detyrimet për taksat dhe tarifave vendore. Sipas listës aneks nr. **A22 A23 dhe A24**, të ndjekin të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës prej **1,222,997 lekë** nga këto detyrime vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **27,000,000 lekë**, nga subjekteve që ushtrojnë aktivitet për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, pa u pajisur me autorizim nga Bashkia, sipas *Anekseve bashkëlidhur Raportit të Auditimit*. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **883,220 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt

“Rikonstrukcion i tubacionit të dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V = 2000 m³ Shijak, rrjet shpërndarës fshati Maminas – Kareç- Bilalas – Karpen - Bodinak”, Bashkia Shijak, me vlerë të kontratës 247,129,485.5 lekë pa TVSH, fituar nga BOE “K.K” Shpk & “K.” shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 276,320 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5086 prot datë 25.08.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Shijak dhe BOE “K.K” Shpk & “K” shpk. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 88-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shijak të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **276,320 lekë pa tvsh** nga BOE “K. K” Shpk & “K”shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5086 prot datë 25.08.2021, me objekt “Rikonstrukcion i tubacionit të dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V = 2000 m³ Shijak, rrjet shpërndarës fshati Maminas – Kareç- Bilalas – Karpen - Bodinak”, Bashkia Shijak, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për qytetin Shijak”, Bashkia Shijak, me vlerë të kontratës 331,619,838.3 lekë pa TVSH, fituar nga BOE “K.K” Shpk & “K” shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 606,900 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5878 prot datë 27.07.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Shijak dhe BOE “K.K” Shpk & “K” shpk. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 88-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shijak të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **606,900 lekë pa tvsh** nga BOE “K.K” Shpk & “K” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5878 prot datë 27.07.2020, me objekt “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për qytetin Shijak”, Bashkia Shijak, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat konstatohet se për vitin 2022, të ardhurat nga 319,731,000 lekë të planifikuara janë realizuar në shumën 193,627,000 lekë ose 61%, pra me një mosrealizim në shumën prej 126,104,000 lekë. Kryesisht, ky mosrealizim përbëhet nga deficitin i krijuar nga:

Taksa e ndërtesës:	- 2,100,000 lekë
Taksa e tokës bujqësore:	- 10,069,000 lekë
Taksa e ndikimit në infrastrukturë:	- 75,474,000 lekë
Tarifa e pastrimit:	- 23,443,000 lekë
Totali i mosrealizimit për vitin 2022 është 126,104,000 lekë.	

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të bashkisë Shijak, që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkallimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale, për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve, etj., në dëm të interesave të publikut. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar dhe ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 37-54 të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Bashkia Shijak, gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Shijak nuk ka lidhur kontratë me Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Shijak për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësitë e mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime.

Me VKB nr. 121 datë 24.12.2021, Bashkia Shijak ka miratuar pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura të taksave dhe tarifave vendore. Ky vendim ka pasur si qëllim ndihmën për familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare për pagesën e menjëhershme të këtyre detyrimeve.

Nga grupi i auditimit sipas regjistrave të vendosur në dispozicion nga Bashkia Shijak u nxorën shumëat debitore për taksat e popullatës sipas llojit të tyre.

Vlera prej **96,188.924 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës deri në datën 31.12.2022. Vetëm për vitin 2022 vlera e detyrimeve të pa arkëtuara për taksën e ndërtesës është 16,182,770 lekë Vlera prej **106,950,267 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i tarifës së pastrimit deri në datën 31.12.2022. Vetëm për vitin 2022 vlera e detyrimeve të pa arkëtuara për taksën e pastrimit është 23,984,000 lekë.

Vlera prej **7,025,445lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i tarifës së ndriçimit deri në datën 31.12.2022. Vetëm për vitin 2022 vlera e detyrimeve të pa arkëtuara për taksën e ndriçimit është 472,800 lekë .Vlera prej **809,060 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i tarifës së truallit deri në datën 31.12.2022. Vetëm për vitin 2022 vlera e detyrimeve të pa arkëtuara për taksën e truallit është 235,775 lekë.

Vlera prej **134,251,162 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i taksës së tokës bujqësore deri në datën 31.12.2022. Vetëm për vitin 2022 vlera e detyrimeve të pa arkëtuara për taksën e tokës bujqësore është **14,321,757** lekë.

Vlera e debitorëve biznes për periudhën 2016-2022 është në vlerën **93,775,186 lekë** e cila përfaqëson taksat dhe tarifatat vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Shijak. Vetëm për vitin 2022 vlera e detyrimeve të pa arkëtuara për taksat e biznesit është 27,241,731 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, etj (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 37-54 të Raportit të Auditimit).

2.1.Rekomandim: Bashkia Shijak, Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2022, në **vlerën totale 439,000,044 lekë**, e cila përbëhet nga:

-**96,188,924** lekë detyrime për taksën e ndërtesës

-**106,950,267** lekë detyrime për taksën e pastrimit

-**7,025,445** lekë detyrime për tarifën e ndriçimit

- **809,060** lekë detyrime për tarifën e truallit

-**134,251,162** lekë detyrime për taksën e tokës bujqësore

-**93,775,186** lekë detyrime për taksat dhe tarifatat vendore për bizneset

a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. Drejtoria e të Ardhurave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Shijak, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

2.2 Rekomandimi: Bashkia Shijak, të marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Shijak Sh.a., për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak sipas legjislacionit në fuqi, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

Në vijimësi

3 Gjetje nga auditimi: Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, Bashkia Shijak për vitin 2022 nuk ka korrespondencë shkresore me ish-ALUIZNI-in, Drejtoria Durrës për të dhënat për lejet e legalizimit të përfituara nga individë dhe subjekte private, të disponueshme në Bashkinë Shijak.

Për vitin 2020 shuma 1,643,000 lekë është e pa u faturuar dhe arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Shijak.

Për vitin 2021 shuma 518,000 lekë është e pa u faturuar dhe arkëtuar taksa e ndikimit në

infrastrukturë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Shijak (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 37-54 të Raportit të Auditimit*).

3.1.Rekomandim: Bashkia Shijak, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **2,161,311 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2 Rekomandimi: Bashkia Shijak, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban për personat të cilët nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje, t'i kërkojë Drejtorisë Rajonale ASHK Durrës vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë deri në kryerjen e pagesës së kësaj takse.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.3 Rekomandimi: Bashkia Shijak, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të vazhdojë korrespondencën zyrtare me ASHK Durrës në lidhje me situatën debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për vitin 2022.

Brenda datës 31.12.2023

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se për vitin 2022 kanë zhvilluar aktivitet në fushën e ndërtimit dhe janë pajisur me Leje Ndërtimi nga Bashkia Shijak 27 subjekte. Nga këto, në 11 raste nuk janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastrë-gjelbërim-ndriçimit dhe nuk janë arkëtuar, te ardhurat për vlerën 957,000, lekë duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Shijak.

Për periudhën 2022, rezulton se për 2 subjekte, të shpallur fitues të procedurave të prokurimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi me fondet e buxhetit të shtetit, me fonde të zhvillimit të rajoneve dhe me fonde nga të ardhurat e veta të Bashkisë nuk janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastrë-gjelbërim-ndriçimit dhe nuk janë arkëtuar të ardhurat për vlerën 174,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Shijak. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” neni 40, “Regjistrimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jo tregtare”, pika 1, ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 37-54 të Raportit të Auditimit*).

4.1. Rekomandim: Bashkia Shijak të saktësojë listat e bizneseve të ndërtimit që kanë qenë zbatuese të lejeve të ndërtimit dhe të projekteve të investimeve të prokuruar për vitin 2022, pavarësisht nëse kanë selinë kryesore jashtë territorit të Bashkisë Shijak dhe që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, të nxjerrin njoftim detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për subjektet e listuara në Anekset bashkëlidhur, si dhe të ndjekin të gjitha procedurat administrative deri në arkëtimin e vlerës totale **1,131,000 lekë** nga këto detyrime vendore.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Shijak ushtrojnë aktivitetin 26 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Subjekte të liçencuar për tregtimin e lëndëve djegëse janë dy, “K. Shpk” dhe “I. Shpk”.

Sa më sipër bazuar në Ligjin nr. 8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM-në nr. 970 datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, subjektet që kanë paraqitur kërkesat për marrjen e licencave, i është kërkuar nga ana e komisionit për shqyrtimin e licencave, pranë Bashkisë Shijak, plotësimi i dokumentacionit të plotë dhe të noterizuar brenda afatit 45 (dyzet e pesë) ditor, sipas VKM-së të sipërpërmendur.

Gjithashtu nga Bashkia Shijak është bërë me dije nga zyra juridike Shijak se: “Në rast se personi juridik nuk ri paraqet dokumentacionin e kërkuar, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, autoriteti licencues në përputhje me parashikimet ligjore ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për bllokimin e aktivitetit tregtar, deri në ri paraqitjen e dokumentacionit të plotë nga ana e personit juridik, për pajisjen e tij me licencë për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë”, pika 6.1 Kreu II i VKM-së nr. 970 datë 02.12.2015.

Duke qenë se asnjë nga subjektet që kanë paraqitur kërkesë nuk ka plotësuar brenda afatit, dokumentacionin e nevojshëm, asnjë nga këto subjekte nuk është licencuar, nga ana e Bashkisë Shijak, për mungesë dokumentacioni nga ana e tyre. Për periudhën e auditimit janë dhënë 2 licenca.

Vlera prej 24,000,000 lekë, e cila nuk është paguar nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Shijak, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa “b”, pikat 9, 15.1 dhe 15.2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 37-54 të Raportit të Auditimit*).

5.1. Rekomandim: Bashkia Shijak, nëpërmjet Drejtorisë së Ardhurave Vendore dhe komisionit të ngritur për licensimin e subjekteve të karburanteve të marrë masa që për 24 subjekte debitorë të arkëtojë tarifën e plota, për diferencën debitorë prej 24,000,000 lekë, detyrim ky për paisjen me autorizim/licensa për tregtimin me pakicë të karburanteve dhe gazit të lëngshëm vajrave lubrifikante për automjetet. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për pagesën e tarifës së licencë/autorizimit, Bashkia Shijak në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik Industrial të ndërmarrin veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

E. MASA DISIPLINORE.

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Shijak, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”, në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05/03/2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, nenin

37 të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale për **15 punonjës**, *respektivisht*:

1. Znj. P.A, Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, për problemet e konstatuara në lidhje me kontabilitetin, pasqyrat financiare dhe planifikimin dhe realizimin e buxhetit.

2. Znj. S.B, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Tatim Taksave Vendore, për problemet e konstatuara në lidhje me të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore.

3. Znj. E.T, me detyrë specialiste e Sektorit të Tatim Taksave Vendore, për problemet e konstatuara në lidhje me të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore.

4. Znj. J.G, me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike (DPTSHIP), në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, pesë raste, dhe çertifikatave të përdorimit të miratuara, një rast, siç janë mosrespektimi i kondicioneve urbane, mos-kërkimi dhe mos-respektimi i mendimit të të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, mos-respektimi i përcaktimeve të kërkesave për pajisje me vërtetim për riskun, mangësi në projektin ndërtimor dhe dokumentacionin shoqërues të tij, miratimin e lejeve të ndërtimit për objekte jo-në përputhje me zërin kadastral, si dhe për miratimin e çertifikatave të përdorimit me mangësi në dokumentacionin e detyrueshëm.

- Në cilësinë e antares së KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Riforcimi i njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të pabanueshme, të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019”, pasi edhe pse 2 OE janë kualifikuar për fazën e parë në 24.02.2023, në muajin Qershor 2023 nuk ka përfunduar procesi i vlerësimit.

5. Z. B.T, me detyrë specialist ndërtimi pranë Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike (DPTSHIP), në cilësinë e personit përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, katër raste, siç janë mosrespektimi i kondicioneve urbane, mos-kërkimi dhe mos-respektimi i mendimit të të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, mos-respektimi i përcaktimeve të kërkesave për pajisje me vërtetim për riskun, mangësi në projektin ndërtimor dhe dokumentacionin shoqërues të tij, miratimin e lejeve të ndërtimit për objekte jo-në përputhje me zërin kadastral, si dhe për miratimin e çertifikatave të përdorimit me mangësi në dokumentacionin e detyrueshëm.

6. Z. R.Sh, me detyrë gjeodet pranë Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike (DPTSHIP), në cilësinë e personit përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, pesë raste, dhe çertifikatave të përdorimit, një rast, siç janë mosrespektimi i kondicioneve urbane, mos-kërkimi dhe mos-respektimi i mendimit të të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, mos-respektimi i përcaktimeve të kërkesave për pajisje me vërtetim për riskun, mangësi në projektin ndërtimor dhe dokumentacionin shoqërues të tij, miratimin e lejeve të ndërtimit për objekte jo-në përputhje me zërin kadastral, si dhe për miratimin e çertifikatave të përdorimit me mangësi në dokumentacionin e detyrueshëm.

